


Bassam Saeh

Rizbulimi i Namazit  
**KOMUNIKIMI ME  
ALLAHUN**





**RIZBULIMI I NAMAZIT –  
KOMUNIKIMI ME ALLAHUN**

Bassam Saeh  
*Rizbulimi i Namazit – Komunikimi me Allahun*

Titulli origjinal  
*Rediscovering Prayer – Communicating with Allah*

Copyright © 2018 Bassam Saeh

Botimi i parë në gjuhën shqipe. Copyright © 2019 Center for Advanced Studies, Sarajevo

Ky libër është e drejtë e autorit. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe në dispozitat e marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, asnjë riprodhim i asnjë pjese nuk mund të bëhet pa lejen me shkrim të botuesve.

BOTUES: Furkan ISM

PËRKTHIMI: Osman Osmani

REDAKTOR: Agim Abazi

FAQOSJA DHE DIZAJNI: Suhejb Xhemaili

SHTYPI: Furkan ISM, Shkup

---

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

28

SAEH, Bassam

Rizbulimi i namazit - komunikimi me Allahun / Bassam Saeh ;  
[përkthimi Osman Osmani]. - Shkup : Furkan ISM, 2019. - 156 стр. ; 24 см

Превод на делото: Rediscovering prayer - communicating with Allah. -  
Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-216-179-2

а) Намаз - Ислам  
COBISS.MK-ID 111040010

---

Bassam Saeh

RIZBULIMI I NAMAZIT –  
KOMUNIKIMI ME ALLAHUN



Shkup, 2019



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



## Përmbajtja

LUTJE.....	9
KAPITULLI 1 / TAKIM ME ZOTIN.....	11
KAPITULLI 2 / “DHE KY, NË TË VËRTETË, ËSHTË NJË AKT I VËSHITIRË...”: POR PSE? .....	17
Përse namazi?.....	17
KAPITULLI 3 / NGA DETYRA NË PRIVILEGJ.....	19
Detyrat përballë të drejtave.....	22
KAPITULLI 4 / KËNAQËSIA E TË ZGJUARIT HERËT PËR NAMAZ .....	24
KAPITULLI 5 / ZBUKURIMI ME DURIM KËMBËNGULËS.....	28
Namazi, shkolla e durimit; durimi, shkolla e qytetërimit .....	30
KAPITULLI 6 / PËRSE FALEMI? .....	33
Namazi na riprogramon.....	34
KAPITULLI 7 / RITMI I NAMAZIT DHE RITMI I JETËS.....	42
KAPITULLI 8 / SHUMËLLOJSHMËRIA: LEKSIONI I PARË DREJT QYTETËRIMIT.....	45
Rëndësia e shumëllojshmërisë për nderimin e përgjithshëm.....	49
Përse kaq shumë pozita dhe lëvizje të ndryshme?.....	50
KAPITULLI 9 / THIRRJA PËR NAMAZ DHE DHJETË MREKULLITË E SAJ .....	53

KAPITULLI 10 / DY LARJET RITUALE.....	61
KAPITULLI 11 / NAMAZI I PËRBASHKËT (ME XHEMAT): ÇELËSI DREJT PËRPARIMIT DHE QYTETËRIMIT .....	66
KAPITULLI 12 / PREDIKIMI I XHUMASË: KURS DREJT ZHVILLIMIT .....	76
Këtu fillojmë .....	81
KAPITULLI 13 / PESË LINJAT E NAMAZIT .....	87
KAPITULLI 14 / NR. 1: “ALLAHU ËSHTË MË I MADH” <i>ALLAHU EKBER</i> .....	95
KAPITULLI 15 / LEXIMI, RECITIMIT DHE KËNDIMI .....	98
KAPITULLI 16 / GJUHA E RE E KUR’ANIT.....	101
KAPITULLI 17 / GJUHA E HAPUR DHE “HAPËSIRAT FERTILE” .....	103
KAPITULLI 18 / ROLI I <i>FATIHA-S</i> .....	107
Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tani dhe përgjithmonë ( <i>Bismilahi Er-Rahmani Er-Rahim</i> ) .....	109
Er-Rahman Er-Rahim:	
“ <i>Mëshiruesi, Mëshirëbërësi, tani dhe përgjithmonë</i> ” .....	114
KAPITULLI 19 / NR. 2: “VETËM TY TË ADHUROJMË DHE VETËM PREJ TEJE NDIHMË KËRKOJMË” - <i>IJAKE NA’BUDU VE IJAKE NESTE’IN</i> .....	117
Udhëzона (përforcona) në rrugën e drejtë.....	120
Zgjatimi i zanores “madd” në <i>Fatiha</i> .....	124
KAPITULLI 20 / CENTRALITETI I RUKUSË DHE SEXHDES .....	126
KAPITULLI 21 / NR. 3: “PËRSHËNDETJET I TAKOJNË ALLAHUT, SI DHE LUTJET DHE FJALËT E MIRA” <i>ËT-TEHIJATU LILAHU VE SALAVATU VE TAJIBATU</i> .....	131
KAPITULLI 22 / NR. 4: “PAQJA QOFTË MBI NE...” <i>ËS-SELAMU ALEJNA VE ALA IBADILAH ES-SALIHIN</i> .....	135
KAPITULLI 23 / SESION PËR LUTJEN DHE ADHURIMIN E FSHEHTË.....	138
KAPITULLI 24 / PËRLOGARITJA E PËRFITIMEVE DHE HUMBJEVE.....	141
Margaritarët që keni mbledhur përmes namazit .....	144
Margaritarët që keni humbur përmes namazit .....	147
KAPITULLI 25 / LE TË JETË E GJITHË JETA JUAJ NAMAZ .....	149
PËRFUNDIM.....	156



*Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit*

Libri që lexon, kënaqësinë e Allahut, të Plotfuqishmit Zot synon. Prandaj, autori mirësjellshëm kërkon nga lexuesi që të jetë bujar me komentet, idetë, mendimet dhe korrigjimet e tij, ashtu që ribotimet e ardhshme, në çfarëdo gjuhe, të jenë më të pasura, më të sakta dhe më të plota. Për këtë qëllim, lexuesi inkurajohet t'i adresohet autorit përmes emailit: [bassamsaeh@hotmail.com](mailto:bassamsaeh@hotmail.com). Në ndryshimet ose shtesat eventuale të ribotimeve synuese, meritat do t'i atribuohen propozuesve ashtu që edhe ata të mund ta gëzojnë një hisë në këtë dhuratë rrjedhëse e vazhduese.







## Lutje

O Zot, Ti je Dëshmitar se derisa përcillja mendimet që shfaqen në këto faqe libri, gjithçka që kam synuar është kënaqësia Jote në të Përtejmen. Nëse të kam lutur me fjalët e gjuhës sime të kufizuara dhe të dobëta të një njeriu, kjo është ngase qenia ime njerëzore e zakonshme që u adresohet qenieve njerëzore të zakonshme, ka këto fjalë gjithçka që ka, megjithëse ato janë joadekuate për ta pasqyruar Lavdinë Tënde e për ta kuptuar Madhësitinë Tënde. Prandaj, nëse mjete im rrugëtues do të pengohet në rrugë e sipër, duke më gremisur e përmbysur përtokë, të paktën u përpoqa në rrugën time për tek Ti. E nëse kam gabuar ose gjuha më ka lajthitur, Ti e di mirë se që nga fillimi e deri në fund, dëshira ime e vetme ishte arritja e së vërtetës së asaj që Ti e dëshiron. Si vallë jemi në gjendje ne të vdekshmit t'i kuptojmë thellësitë e qëllimeve Tua ose misteret që ia ke shpallur Profetit tënd [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në ngritjen e tij gjatë Natës, kur ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mori udhëzimet e Tua Hyjnore për t'i institucionalizuar pesë namazet e përditshme, thesaret dhe fshehtësitë e çmueshme të të cilit, i ndau ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] me ne tokësorët?

O Zot, nëse e kam pikatur shënjestrën, më shpërble me mirësinë me të cilën i shpërblen robërit e Tu të drejtë. E nëse, në

mendimin, vlerësimin, interpretimin ose shprehjen time, e kam huq shënjestrimin e tillë; nëse nga zelli për ta përcjellë madhësinë Tënde, kam folur me nguti ose pena më ka çuar në lajthitje, larg nga rruga e urtësisë Tënde, të lutem më shpërble bazuar në atë që di. Lartësuar qofsh, më udhëzo që të iluminohem vetëm me udhëzimin Tënd dhe të pijë nga burimet e dashurisë Sate. Ti je dhe do të mbetesh përgjithmonë, më Falësi, më Falënderuesi, më i Dashuri dhe Bujari, më i Mëshirshmi Mëshirues.

*Nga ai që kërkon strehim në mirësinë Tënde,  
Bassam Saeh  
E premte, 15 Xhumada el-Ula, 1436 Hixhri  
6 Mars, 2015*



## KAPITULLI 1

# Takim me Zotin

“Menaxhimi i namazit?!” - pyeti ai me habi. - “Vallë ‘menaxhohet’ namazi?” - vazhdoi. Iu përgjigja: “Merr shembullin e studiuesve të menaxhimit të biznesit dhe financave. Këtë veprojnë ata, ashtu që me mençuri të bëjnë investime të mira materiale, për t’i realizuar normat më të larta të kthimit, edhe pse fitimet janë të përkohshme që pushojnë me pushimin e kohëzgjatjes së jetës së tyre. Pra, pse mos t’i menaxhojmë çështjet tona shpirtërore në të njëjtën mënyrë e t’i bëjmë investimet më të mira në këtë jetë, për t’i korur fitimet më të mëdha në të Përtejmen, veçanërisht kur jemi të vetëdijshëm për shpërblimet e botës tjetër: të përjetshme që s’shterojnë kurrë? Ka diçka më të denjë për investim d25he menaxhim të duhur sesa aktiviteti i veçantë i namazit, lutja që synon t’i shërbejë të mirës së kësaj bote dhe të Përtejmes?”

Një ditë gjatë muajit të Ramazanit, Klubi i Studentëve Saudit në Oksford më nderuan me ftesën e një ligjërimi pak para iftarit. Pa një pa dy, pranova dhe vendosa të flas për temën “Menaxhimi i namazit”. Në kohë, vajta në sallën e predikimit. Në dorë mbaja

një copëz letre në të cilën kisha shënuar dy ajete kur'anore dhe dy thënie profetike mbi namazin. Pas përshëndetjes së ngrohtë e të zakonshme, shpaloja letrën dhe lexova me nxitim përmbajtjen e saj; aq shpejt e lexova sakaq audienca mezi i kapi fjalët që i thashë. Brenda një minute mbarova gjithçka që kisha për të thënë dhe ia mësyva portës. Në ecje e sipër, nxjerrja fjalë pa dashje: “Më falni për nxitimin, por kam një takim me njerëz shumë më të rëndësishëm se ju. Mirupafshim!” Ndërsa po ecja drejt portës, vështroja me bisht-syri dhe ç'të shihja, fytyrat e dëgjuesve gjuhë-lidhur që pasqyronin një përzirje të protestimit, hutimit, mosbesimit, dhe mbase, fyerjes dhe mosmiratimit.

Një reagim i kuptueshëm spontan njerëzor, duke pasur parasysh sjelljen time të pahijshme ndaj atyre me të cilët isha dakorduar të takohesha. Po, si do të ishte reagimi nëse do silllesh në të njëjtën mënyrë ndaj Allahut?

Disa çaste më vonë, u ktheva dhe me kërkim-ndjesë, studentëve, për sjelljen time të pahijshme, iu drejtova: “Jeni zemëruar gjë me mua? Epo, u silla në këtë mënyrë ndaj jush vetëm një herë, dhe tani erdha përsëri për të kërkuar falje. Fatkeqësia është se sillemi kështu me Allahun mesatarisht pesë herë në ditë, madje as pa edhe një brejtje të vetme ndërgjegjeje; pa një sëmbim e pa një fjalë të vetme apologjie!”

Ç'mundësi e mrekullueshme! Ç'takim i ëmbël që na mungon, kur bëhemi koprracë në kohën që ia kushtojmë Allahut dhe falim namazin me nxitim, pikërisht ashtu siç unë iu adresova studentëve - nëse është kështu, atëherë nuk meriton të quhet “namaz” aspak.

Veç kësaj, në vend se t'i këndoja ajetet kur'anore dhe thënie profetike nga kujtesa, thjesht i lexova nga një copëz letre. Më thoni, cila do të kishte ndikim më të madh tek dëgjuesit - leximi nga një copëz letre apo të thënë ato njëkohësisht? Zakonisht i qasemi namazit njëjtë, domethënë sikur po lexojmë nga një copëz letre dhe si të tilla, fjalët na dalin nga gjuhët, por jo edhe nga zemrat.

Zoti i Plotfuqishëm na ka prezantuar me një dhuratë të jashtëzakonshme, një projekt të madh investimi të shërbyer në një pjatë ari, por e hedhim poshtë atë, në përbuzje. Si rezultat, përfundojmë me asgjë, përveç asaj që mund të presim në mënyrë të arsyeshme, domethënë, refuzimit dhe mbase edhe penalizimit për përgjigje ndaj dhuratës së Allahut me një mosmirënjohje të tillë.

Duhet ta kuptojmë nga brenda vlerën e kësaj dhurate dhe t'ua përcjellim atë edhe fëmijëve tanë. Domethënë, nëse duam që fëmijët tanë të shkojnë përtej memorizimit dhe imitimit, dhe të bashkohen me mendimtarët dhe novatorët e vërtetë, duhet ta rizbulojmë, si veten tonë ashtu edhe format tona të adhurimit. Pastaj, duhet t'ua mësojmë atyre një mënyrë të menduarit që do t'i ndihmonte të rizbulonin gjithçka rreth tyre, duke përfshirë grupin e shpikjeve të frikshme që kanë në dispozicion.

Mbaj mend një herë në fund të viteve 1940, si një kalama shtatë ose tetë vjeçar, ime më që sapo ishte kthyer nga një vizitë e një familje të krishtere në Lattakia, më tregoi për një "radio" mahnitëse që biri i tyre e kishte sjellë nga Franca pas përfundimit të studimeve. Kjo "radio" për të cilën ajo më njoftoi, kishte një dritare në pjesën e përparme, përmes së cilës mund të shihej personi që fliste! Të them të drejtën, atë natë nuk munda të fle gjumë nga emocionet, imagjinata ime e një kalamaji duke menduar për folësin e gjorë të radios - që unë e paramendoja - të ngujuar në kutinë e vogël. Vrisja mendjen si kishin arritur ta fusnin brenda kutisë? Me siguri, duhet ta kenë gjetur dikë me një trup të vogël të përshtatshëm për aty. Por pastaj, mendja ime kalamanjoze hamendësonte, si vallë do të dilte ai që aty për të shkuar në tualet? Pikëpyetjet e këtij lloji më ndoqën gjithë natën. Vite më vonë, kuptova natyrisht se pajisja për të cilën ime ëmë më kishte folur ishte vetë televizori!

Fëmijët tanë sot, vijnë në këtë jetë në një botë të mbushur me televizorë, radio, telefona të zgjuar, kompjuterë, iPads (tableta), CD, satelitë, aeroplanë, makina dhe pajisje të tjera mahnitëse. Si

rrjedhojë, rrallëherë mendojnë për rëndësinë e këtyre shpikjeve. As nuk mendojnë për madhësinë e individëve që i kanë shpikur dhe zhvilluar ato ose emocionin që duhet t'i ketë shoqëruar ata paraqitja e tyre e parë në jetën e njerëzve. Duhet t'i stërvitim të vegjlit të jenë të vetëdijshëm për madhësinë e të tillave gjëra, pasi kjo do t'i ndihmojë ata të rizbulojnë madhësinë e krijimit, si brenda vetes dhe rreth tyre, ashtu edhe madhësinë e Allahut në veprën e krijimit. Kjo nga ana tjetër, do t'i shpie ata drejt rizbulimit të fesë së tyre dhe formave të adhurimit. Në vend që t'i lënë ato të varrosura nën një shtresë të zhurmshe të familjaritetit, zakonisht dhe përsëritjes, do të mësojnë t'i çmojnë ato përsëri sikur t'i njihnin për herë të parë. Shumë ajete kur'anore na e mësojnë artin e rizbulimit:

*Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje? Mandej, herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet te ti i përulur dhe i molisur. (El-Mulk: 3-4)*

*A nuk i shikuan ata shpezët përmbi ta krahëhapur dhe kur krahët i palojnë, ato nuk i mban kush në ajër pos Fuqplotit. Ai është që çdo send e sheh dhe e di. (El-Mulk: 19)*

*Thuaj: "Më tregoni, nëse uji juaj humbet në thellësi, kush do t'ju sjell ujë mbitokësor (burimor)?" (El-Mulk: 30)*

Njerëzit e edukuar me një qëndrim frikë-nderimi dhe habie, të frymëzuar nga qasja kur'anore në botë, do ta gjejnë veten në një gjendje të pafundme të "rizbulimit", si për veten ashtu edhe për mjedisin. Si pasojë, ata dhe shoqëria do të gëzojnë një gjendje të vazhdueshme ngritjeje dhe zhvillimi kulturor e shpirtëror. Çdo mëngjes jemi të inkurajuar ta vështrojmë veten dhe botën rreth nesh përmes syve të rinj, sikur ta shohim atë për herë të parë. Pasi ta bëjmë këtë, do ta kuptojmë sa më pranë Allahut jemi.

Shkollat, institutet dhe departamentet tona universitare janë dëshmitarë të përhapjes së shpejtë të disiplinave dhe kurrikulave që merren me studimin e mjeteve më të mira të menaxhimit të

projekteve industriale, komerciale, bujqësore, ndërtimore dhe investimit të gjithçkaje që ka potencialin e arritjes së përfitimit në jetën tonë, si publike ashtu edhe private. Por kujt i ka shkuar ndërmend ndonjëherë të futë një disiplinë ose kurs studimi që merret me menaxhimin dhe investimin e diçkaje më të vlefshme, më të dobishme, më të qëndrueshme dhe më të garantuar për të dhënë rezultate si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën; për të dhënë rezultate më të frytshme sesa japin të gjitha ndërmarrjet e lartpërmendura të kombinuara, domethënë, format tona të ndryshme të adhurimit, dhe para së gjithash, namazin, që në thelb është një takim me Allahun? Në fakt, një fushë e tillë e studimit do të kontribuonte në suksesin e ndërmarrjeve tona të përkohshme tokësore.

Namazi është një takim që zë vendin e parë në mesin e formave të ndryshme të adhurimit islamik, të cilat mund të mendohen si investime të kësaj bote dhe asaj bote. Për këtë arsye, nuk duhet të na vijë befasi aspak që të mësojmë se namazi (falja e namazeve gjatë periudhave të tyre të caktuara) merr vendin e parë, përpara urdhrit për t'i nderuar madje edhe prindërit:

Abdullah Ibn Mes'udi transmeton: "E pyeta një herë të Dërguarin e Zotit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: "Cila, nga të gjitha veprimet, është më e dashur për Zotin?" E bukura krijesë [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tha: "*Falja e namazeve në kohën e tyre të caktuar.*" "Pastaj çfarë?" - pyeta. "*Respektimi (nderimi) i prindërve.*" "Pastaj çfarë?" - pyeta përsëri. "*Angazhimi në luftë (xhihad) për hir të Zotit.*"<sup>1</sup>

Ç'hadith i mrekullueshëm, edhe pse shumica prej nesh kalojnë përmes tij pa soditur fare. Gjykuar nga afër, klasifikimi i namazit para nderimit të prindërve dhe xhihadit jo vetëm që e ilustron vlerën e madhe të namazit, por gjithashtu e shpërfaqë rëndësinë e besnikërisë sonë dhe marrëdhënieve me prindërit, shoqëritë dhe në fakt gjithë botën. Duhet ta nderojmë botën dhe

1 Transmeton Muslimi.



ta bëjmë një vend më të mirë përmes luftës (xhihadit) për drejtësinë dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë, termi “ethos” etikë dhe fisnikëri, tragjikisht në bashkëkohoren është përdhosur dhe keqpërdorur, rrëmbyer dhe falsifikuar nga grupe të caktuara politike dhe fetare për t’i justifikuar veprimet e tyre të egra të terrorizmit dhe vrasjes, në një kohë kur Profeti i Islamit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u dërgua si mëshirë për të gjithë botën. Që namazi ta tejkalojë edhe xhihadin në rëndësi, virtyt dhe shpërblim është diçka që vërtet kërkon reflektim. Është përshkruar edhe nga Zoti i Plotfuqishëm si “diçka e vështirë” (*kebira*) për të gjithë, përveç atyre që janë “të përlulur shpirtërisht” (*el-hashi’un*). Për individë të tillë, namazi nuk paraqet ndonjë barrë ose vështirësi, sepse ata, për shkak të respektit të përlulur e gjejnë namazin një burim kënaqësie, qetësie dhe paqeje të mendjes, si dhe një dallgëpritëse dhe ledh-mbrojtëse në jetën e tyre. Në fakt, duke pasur një zotim për respekt të përlulur dhe për vetëdije dhe durim në këndimet, lëvizjet, reflektimet dhe imagjinatën e tij, namazi shërben si një shkollë shpirtërore që e trajnon besimtarin drejt durimit këmbëngulës, përqendrimit mendor, vëmendjes, modestisë, pranimit të të tjerëve dhe aftësisë për t’i dëgjuar ata, nerva-qetësisë, kujdesit, marrjes së qëllimshme të vendimeve, moderimit në qëndrime, shmangies së paragjykimeve të nxituara, të pamatura ose ekstreme dhe urtësisë në ndërveprim me njerëzit e tjerë dhe situatat e jetës. Prandaj, nuk duhet befasuar që në më shumë se një pasazh të Kur’anit, Allahu i Plotfuqishëm lidh namazin me durimin dhe qëndrueshmërinë:

*Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtet, ajo është e madhe (vështirë), por jo edhe për ata që kanë frikë (Zotin). (El-Bekare: 45)*

*Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë. (Ta Ha: 132)*



## KAPITULLI 2

# “Dhe ky, në të vërtetë, është një akt i vështirë...”: Por Pse?

### PËRSE NAMAZI?

Pse duhet t'i anulojmë takimet e planet tona, ta lëmë mënjanë punën në proces, ta ndërpresim biznesin dhe ta lëmë çdo gjë tjetër në jetën tonë të përditshme në modalitetin e pritjes, sado e rëndësishme, ashtu që t'i kthehemi namazit? Pse i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e identifikoi namazin si faktor determinues e dallues mes besimtarit dhe jobesimtarit? Pse ishte namazi një veçori për të cilën Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përkujtoi komunitetin e tij madje edhe në shtratin e vdekjes, duke thënë: *“Për Zotin, mos e braktisni namazin!”*

Vallë, qe detyruar namazi në jetën e muslimanëve si dënim apo si shpërblim? Cilat aspekte të tij janë të vështira dhe cilat janë të këndshme, nëse ne, në fakt, gjejmë kënaqësi në të? Pse

urdhërohemi të falim namaz në kohë të veçanta, me lëvizje të veçanta dhe me numër të veçantë rekatesh e përluljesh? Pse duhet të shprehim fjalë të veçanta dhe të bëjmë këndime të veçanta? Pse namazi gjendet në të gjitha fetë? Pse Zoti dhe i Dërguari i Tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i kushtojnë namazit rëndësi më të madhe sesa xhihadit?

Më duhet të rrëfej se jam falur për pesëdhjetë vjet të plota para se ta kuptoja se me namaz, Allahu i Plotfuqishëm, ma kishte dhuruar ndërmarrjen më të madhe tregtare që dikush mund të shpresonte e posedonte. Po zgjedha mençurisht si ta menaxhoj dhe drejtoj këtë ndërmarrje, do ta gëzoj korrijen më të pasur dhe do ta përjetoj kënaqësinë më të plotë ëndërrimtare.

Supozoni se jeni dëshmitarë të një beteje mes dy grupeve të milingonave mbi një kokrrë sheqeri: Një milingonë hidhet mbi shpinën e kundërshtarit, një tjetër gërmon me kthetrat e saj të vogla nën këmbët e armikut për ta penguar atë të ngjitet në kokërr, derisa një tjetër akuzon këtë ose atë anëtar të kampit armiqësor. Mbase jeni duke u nënqeshur nga kjo betejë e veçantë mes dy ushtrive minore. Dhe për çfarë? Për një kokërr sheqeri që, në terma njerëzorë, nuk do të konsiderohej aspak e vlefshme.

Tani supozoni se e keni falur një namaz të caktuar, vërtet përsosmërisht; një që ju la të ndjeheni sikur të ishit ngritur nga sfera tokësore drejt Fronit të Allahut. Nëse nga lart do vështronit poshtë botën, do të shihnit gjithçka në të, pavarësisht madhësisë e vëllimit, madje edhe ato që vështirë se shihen me sy të lirë. Do të shihni se kokrra e sheqerit të mjerë për të cilën milingonat luftonin nuk është asgjë tjetër përveçse jeta jonë e vockël boshe në Tokë dhe se milingonat e vockla të pamend në luftimin e vdekshëm mbi një kokrrë sheqeri, ju përfaqësojnë ju dhe çfarëdo grupi njerëzish që janë në mosmarrëveshje me pjesën tjetër të sheqerit.



### KAPITULLI 3

## Nga detyra në privilegj

Në të vërtetë, namazi në traditën islamike mund të fillojë si detyrë. Siç Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] transmetohet të ketë thënë, se fëmijët duhet inkurajuar pozitivisht për namaz-falje kur t'i kenë mbushur të dhjetat.<sup>2</sup> Po ashtu, Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thoshte: *“Asgjë nuk qëndron ndërmjet njeriut dhe mosbesimit, përveç neglizhimit të namazit.”*<sup>3</sup> Idealisht, megjithatë, kur fëmijët ta kenë arritur moshën e dallimit (të gjërave) dhe ta kenë kuptuar natyrën dhe dinamikën e namazit, atëherë do ta zbulojnë rëndësinë e kësaj linje direkte me Zotin, dhe koncepti i “detyrës” gradualisht do të zëvendësohet me atë të “privilegjit” ose “të drejtës”.

Në vegjëli, fëmijët i detyrojmë t'i marrin medikamentet mjekësore. E derisa ata maturohen, i perceptojnë medikamentet si bezdisje që duhet duruar vetëm sa për t'i akceptuar më vonë si një e drejtë për t'u shijuar ose vlerësuar, pasi tashmë janë të vetëdijshëm se medikamentet kontribuojnë në zhvillim shëndetësor dhe madje edhe shpëtojnë jetë.

---

2 Transmeton Ahmedin nën autoritetin e Amr Ibn Shu'ajbit, e ky nën autoritetin e babait të tij, të cilit i ishte transmetuar nga babai i tij.

3 Transmeton Muslimi nën autoritetin Xhabir ibn Abdullahut.

Imagjinoni sikur jeni gati ta nënshkruani qira-marrjen e një shtëpie madhështore. Magjepseni nga bukuria, hapësira, lokacioni dhe orenditë e saj elegante. Por, derisa e negocioni qiranë me pronarin, befasoheni kur nga buzët e tij dëgjoni fjalët: “Në vend të qirasë, kërkoj t’i shijosh pesë ushqime të këndshme ditore, të gjitha në llogari të shpenzimeve të mia. Kjo është ajo që kërkoj - as më shumë e as më pak.”

Ç’ofertë se! Dhe në të vërtetë, kjo është oferta që e kemi pranuar nga Allahu i Plotfuqishëm në këmbim të të jetuarit në Tokën e Tij, duke i shijuar begatitë e Tij të pafundme dhe duke u ndihmuar për ta populluar dhe ndërtuar jetën tokësore. Duke qenë kështu, vallë a nuk i bëjmë padrejtësi veteve tona duke mos ia kushtuar kohën dhe vëmendjen “ushqimeve” namazore të përditshme, ashtu siç ia kushtojmë ushqimeve trupore? Pse e privojmë në kohë ushqimin shpirtëror derisa ushqimit fizik ia ofrojmë gjithë kohën e botës? Cila mendoni se është më e denjë?

Keni dëgjuar ndonjëherë për një çmim të madh, dhuruesi i të cilit përcakton se para dorëzimit të çmimit, fituesi fillimisht duhet ta pranojë një çmim tjetër më madhor? Ç’lloj shpërblimi mund të jetë ky? Ky çmim ka një referencë, është vetë namazi. Nuk kemi për ta pranuar shpërblimin e madh nga Allahu, nëse fillimisht nuk e pranojmë shpërblimin e mrekullueshëm shpirtëror, dhuratën e Allahut (namazin), duke e shijuar praktikimin e tij si një e drejtë dhe privilegj para durimit të tij si një detyrë ose barrë.

*“Në qoftë se një rob i Allahut ngrihet për të falë namaz, të gjitha mëkatet i vendosen mbi supe dhe, ndërsa ai përkulet në ruku dhe përulet në sexhde, i bien mëkatet.”<sup>4</sup> Po kështu: “Çdo musliman që merr abdes përsosmërisht, pastaj vendos të falet, duke qenë i vetëdijshëm për atë që thotë, do të kthehet ne qenien e tij po aq i pastër sa ishte në ditën e ardhjes së tij në këtë botë.”<sup>5</sup> Pra, kur*

4 Transmetuar nën autoritetin e Ibn Omerit. E saktësoi Muhamed Nasir el-Din el-Albani në librin e tij *Silsilat el-Hadith el-Sahihah*.

5 Transmetuar nën autoritetin e Ukbe Ibn Amirit. E saktësoi Albani në *Sahih el-Targhib el-Tarhib*.

e filloni namazin me fjalët: “Allahu është më i madh! (*Allahu Ekber*)” përfytyroni Engjëjt duke ua sjellë të gjitha mëkatet e akumuluar, për të cilat vetë ju jeni përgjegjës, dhe duke i vendosur ato mbi supet tuaja në mënyrë që, kur të përuleni ose përuleni, t’u bien prej supeve; të liroheni nga ligësitë njëherë e mirë.

Eh sa lehtësisht një e drejtë mund të ndjehet si detyrë, mbase edhe barrë nga e cila duam të lirohemi sa më parë! Kjo është përvoja e atyre që ndihen sikur “humbin” ose “harxhojnë” kohën e çmuar të kaluar në faljen e ca rekateve namaz. Detyra është ajo që e shoqërojmë me barrën pafundësisht në mendjet tona, diçka që peshon mbi ne. Si të tillë, atë e shohim si diçka që na varfëron dhe jo që na pasuron, pasi na privon nga koha ose nga pushimi të cilën e konsiderojmë të drejtë për vetet tona. Me këtë perceptim fillon shtrembërimi dhe për shumë njerëz, namazi fillon të transformohet në një barrë nga e cila ata, brengë kanë çlirimin. Përkundrazi, i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e portretizoi namazin si pushim-sjellës dhe qetësues zemrash. A nuk thoshte ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “*Na qetëso me namaz, o Bilal!*”<sup>6</sup>

Pra, në vend se të hamendësojmë: “Jam falur apo jo?” - sado kritike kjo pyetje mund të jetë, le ta pyesim veten: “Kur e fala namazin, e mora dot çmimin që ishte menduar për mua? E shijova vërtet atë, ndërsa po meditoja për bekimet tokësore që m’i sjell ai? Po mendimin për pasurinë akumuluese për jetën e Përtetjeje, e shijova dot?”

Le të jetë namazi, një biletë falas për një udhëtim të këndshëm, jo thjesht në botën tokësore, por gjithandej universit, mado edhe atje ku mund të fitoni qasje te Mbreti dhe Sundimtari Absolut i kozmosit.

6 Transmeton Iraku nën autoritetin e Bilal Ibn Rebias.

## DETYRAT PËRBALLË TË DREJTAVE

Detyrat në jetën tonë shpesh përzihen me të drejtat, deri në atë masë ku nuk dimë se ku përfundon njëra dhe ku fillon tjetra. Për shembull, haxhi ose pelegrinazhi në Mekë, është detyrë që kërkon vendosmëri, udhëtim, shpenzim të energjisë dhe shpenzim monetar. Madje mund të përfshijë edhe rreziqe. Por, kur mendojmë për shpërblimin që na pret për çdo hap që hapërojmë, ndjenja e detyrës do të nisë të avullohet dhe do të zëvendësohet me një vetëdije për pelegrinazhin si një e drejtë dhe privilegj.

Po ashtu, lëmosha është një detyrë që përfshin përpjekje dhe shpenzime. Por, kur e perceptojmë atë me zemër të gatshme dhe ndërgjegjësimit për shpërblimin që mund ta parashohim së bashku me lumturinë që ua kemi dhuruar të ndihmuarve, do të përshkohemi nga paqja dhe qetësia. Kjo pasi e kemi kënaqur Zotin dhe u kemi ofruar mbrojtje, ngrohtësi dhe siguri nevojtarëve.

Edhe agjërimi është detyrë, obligim që kërkon durim karshi urisë dhe etjes, këmbëngulje e vetëkontroll. Por, pas çdo çasti kalues, parashohim gëzimin e shpërblimit të premtuar nga Allahu dhe kënaqësinë e t'i afruarit Atij, derisa u bindemi urdhrave të Tij dhe i kushtojmë vëmendje ndalesave të Tij. Shpërblimi nuk është i kufizuar thjesht në çastin e çeljes së iftarit që pason pas një dite të gjatë urie dhe etje. Përkundrazi, ajo përfshin kënaqësinë e triumfit në një betejë me dëshirat e egos dhe shtimin e shpërblimit hyjnor në magazinimin tonë të përhershëm.

I njëjti p a rim zbatohet për kategoritë islame të lejuara (*hallall*) dhe të ndaluara (*haram*). Zoti i Plotfuqishëm ndalon gjëra vetëm për ta mbrojtur robin nga ndonjë dëm, pavarësisht nëse e ai e kupton natyrën e dëmit të involvuar. Njëjtë, kur Allahu shpall diçka të lejueshme për ne ose na urdhëron të kryejmë një veprim të caktuar, kjo është për hir të disa dobive. Prandaj, mund të flasim për *hallallin* dhe *haramin* si “të dobishëm” dhe “të dëmshëm” respektivisht, qoftë në sferën e ekonomisë, psikologjisë, mjekësisë ose çfarëdo sferë tjetër.

Eh sa e lehtë është që të drejtat që i gëzojmë të kthehen në detyra! Megjithatë, po aq e lehtë është që edhe detyrat të kthehen në të drejta. Po ta fitonim një çmim të madh monetar nga një institucion dhe të na kërkohej të udhëtonim diku larg për ta pranuar shpërblimin, a nuk do të nxitonim lumturisht, duke sakrifikuar kohën dhe përpjekjet, dhe duke e përkthyer në lehtësi çfarëdo vështirësie në rrugë e sipër? Nëse po, atëherë a nuk është çmimi i namazit më me vlerë se kjo? Përfundimisht, si mund të krahasohet vlera e namazit me një shpërblim që buron në këtë fushë tokësore kalimtare, sado peshërëndë qoftë ai?

Allahu është Ai që i furnizon zogjtë. Por, prapëseprapë zogjtë duhet t'i shtrijnë krahët dhe të fluturojnë drejt furnizimit. Si mund ta njohim shijen e një fruti nëse nuk arrijmë ta këpusim atë nga pema? Si mund të gjejmë gjumë të rehatshëm, nëse nuk e sigurojmë një dyshek të përshtatshëm, një batanije të mjaftueshme dhe një atmosferë të qetë në një dhomë të pazhurmshme dhe me ndriçim?





## KAPITULLI 4

# Kënaqësia e të zgjuarit herët për namaz

Si një kalama, më duhej të ngrihesha për namazin e sabahut “në mes të natës” - ose kështu më dukej mua – vrisja mendjen pse duhej të ngriheshim në atë kohë të caktuar. Para së gjithash, mendoja, nëse Allahu kërkon që t’i falim pesë namaze gjatë ditës, atëherë pse e caktoi njërin prej tyre në një kohë kaq të vështirë dhe pastaj kërkon që të zgjohemi sapo të jemi duke i shijuar ëndrrat e ëmbla? Ç’të keqe do të kishte sikur ta falnim namazin e sabahut në ora shtatë ose tetë të mëngjesit apo edhe në dhjetë? Fundja, a nuk është namazi namaz pavarësisht se në ç’kohë falet? A nuk është këndimi që bëjmë gjatë një namazi të vonshëm kohor i njëjtë si ai i kënduar në një namaz më të hershëm kohor? Dhe nëse qëllimi i namazit është ruajtja e komunikimit tonë me Zotin dhe zbrapsja e Shejtanit, atëherë ç’dëm mund të na bëjë Shejtani kur bëjmë gjumë? Pse duhet të shqetësohemi për humbjen e kontaktit me Zotin dhe të ngjuarit në kurthin e Shejtanit, në një kohë kur nuk mund të mendojmë për asnjë lloj kontakti ose mungese të tij me Allahun ose këdo tjetër, apo të planifikojmë veprime, qoftë për të mirë apo për të keq?

Pyetjet si këto mund të sorollaten jo vetëm në mendjen e një fëmije, por edhe në mendjen e një të rrituri. Megjithatë, të rriturit do ta kuptojnë se namazi nuk është thjesht një çështje e komunikimit periodik me Zotin e Plotfuqishëm, por një mënyrë jetese. Kushdo që e ka përjetuar ëmbëlsinë e zgjimit para agimit dhe shkuarjen në xhami, pastaj të larguarit nga xhamia para lindjes së diellit për të rinisur jetën e tij të përditshme, do ta njohë vlerën e të qenit një zog i hershëm; do ta përjetojë velën e frymëmarrjes në puhinë e paprishur, të pacenuar dhe origjinale të agimit; do ta njohë shijen qetësisë së orëve të hershme të mëngjesit dhe afërsinë që njeriu ndjen me Zotin në atë kohë.

Kush pra e bën këtë, dëshmon për rizgjimin e jetës pas dremitjes. Ndërsa nata i jep rrugë ditës, fillimet e para të agimit përvidhen, to ka dhe qielli lëshojnë një shkëlqim të veçantë dhe pemët e lulet shpërfaqen nën dritën e hershme të agimit. Një skenë si kjo është një rikthim në miniaturën e ditës së parë të krijimit, pasi shenjat e jetës bëhen të dukshme gjithandej. Ata që e gëzojnë privilegjin e të përjetuarit këtë orë unike të ditës, do t'i ndjejnë të gjitha aftësitë e tyre hapëse e lulëzuese, të cilat ngjallin dëshirën për të prodhuar e dhënë. Të zgjuarit e këtyre çasteve, do ta akumulojnë një fluks të fuqisë, pasurisë dhe kreativitetit sikur të ishin rijetësuar, rinuar.

Agimi e gëzon njeriun me një sy të ri, përmes të cilit ai mund t'i shohim misteret e universit dhe t'i rizbulojë mrekullitë e krijimit në një formë që është e mbyllur për ne në kohë të tjera të ditës. Kushdo që është përpjekur të zgjohet dhe të punojë gjatë orëve të hershme të ditës, do të gjejë se dy ose tre orë punë në këtë kohë janë më produktive sesa orët e gjata të mundimeve në të gjitha orët tjera të ditës ose të natës. Dhe gjithçka që na pengon të përfitojmë nga kjo kohë e veçantë është djalli i përtacisë sonë. Nëse ia dalim mbanë të rezistojmë dhe ta kapërcejmë atë për një ditë, pasuar nga një ditë e dytë, pasuar nga një periudhë disa-ditore gjatë së cilës angazhohemi në këtë model të ri ashtu

siç angazhohet njeriu të agjërojë gjatë ditëve të para të vështira të Ramazanit, do të na bëhet zakon i ngulitur në trup dhe mendje, dhe një pjesë e tillë e këndshme e programit tonë të përditshëm pa të cilën nuk duam të mbesim asnjëherë.

Ndërsa i hapim sytë derisa akoma jemi në shtrat, Shejtani tërheq kokën drejt jastëkut duke thënë: “Mbylli sytë dhe kthehu në gjumë. Këto orë të hershme të mëngjesit janë koha më e mirë për t’u çlodhur e qetësuar. Pra, pse të nguteni?” Si mund t’i rezistojmë argu menteve të përsëritura e ngulmuese të Shejtanit, pëshpëritjeve të tij joshëse? Kjo është ajo për të cilën na mësoi i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]:

*Kur ndonjëri prej jush shkon për të fjetur gjumë, Shejtani lidh tre nyje rreth qafës së tij. Pastaj e shtrëngon secilën nga nyjat, duke pëshpëritur: “Ke një natë të gjatë para, ndaj pusho!” Nëse robi zgjohet dhe e kujton Zotin, njëra prej nyjave i zgjidhet. E nëse merr abdes, i zgjidhet edhe nyja e dytë. E nëse fal namaz, të gjitha nyjat do t’i zgjidhen dhe do ta rinisë ditën energjikisht dhe me një frymë të mirë. Përndryshe - domethënë, nëse nuk ngrihet për t’u falur - do ta rinisë ditën i amullt dhe në një gjendje të keqe.<sup>7</sup>*

I keni vështruar ndonjëherë për së afërmi fytyrat e atyre që shkojnë herët në shtrat dhe ngrihen në agim për t’u falur? I keni krahasuar ato me fytyrat e atyre që qëndrojnë deri vonë dhe pastaj flenë gjumë në kohën e namazit të sabahut? Po t’i vështrojnë, do t’i zbulonit disa nga sekretet e kësaj makine të shquar të njohur si “qenia njeri”, e cila është programuar në mënyrë të atillë që koha më e mirë për të rifilluar është para dhe jo pas lindjes së diellit. Kështu, Formësuesi ynë na krijoi për një qëllim të urtë – një qëllim të cilin mund ose nuk mund të ta kuptojmë. Sidoqoftë, kush do t’i njihnte sekretet e kësaj makine njerëzore më mirë se Ai që e krijoi?

---

7 Transmeton Buhariu nën autoritetin e Ebu Hurejres.

*A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë. (El-Mulk: 14)*

Natyrë buron nga shtrati në dritën e parë të agimit, ashtu siç Krijuesi i saj e ka programuar, ashtu që t'i iluminojë për ne të gjitha mrekullitë e jetës. Prandaj, agimi nuk është kohë për të fjetur, por për ngritje, punë, prodhim dhe përparim. Kini kujdes nga nënvle rësimi i kësaj dhurate hyjnore e mos ta humbisni energjinë që Allahu ua ka dhënë juve dhe krijesave të tjera rreth e rrotull për t'ua mundësuar ta rinisni ditën e re. Lulet që i mbyllin qepallat me perëndim të diellit, i hapin ato me dritën e parë të agimit, ndërsa zogjtë zgjohen herët, duke cicëruar dhe fluturuar në qiell në ndjekje të furnizimit të tyre të përditshëm. Lopët, delet, dhitë, pulat dhe të gjitha gjërat e gjalla që Allahu i ka vendosur në Tokë, takojnë ditën e re në orët më të hershme për të filluar ciklin e jetës përsëri.

Pra, mbani ritmin me jetën dhe korrni frytet e saj para se të jetë tepër vonë.



## KAPITULLI 5

### Zbukurimi me durim këmbëngulës

Kur marrim rrugë drejt vendit të punës ose gjetiu, shqetësimi ynë kryesor për gjithësisht është arritja në destinacion, bile atë me shpejtësinë më të puthitur të lejuar (të cilën ndonjëherë mbase edhe e tejkalojmë). Rrjedhimisht, arrijmë me mendje të nevrikosura dhe nerva të lodhura.

Por çfarë nëse e trajtojmë makinën tonë sikur të ishte një e drejtë për t'u përjetuar? Do të dilnim nga shtëpia pak më herët se zakonisht, ashtu që të kemi kohë të mjaftueshme për të vozitur ngadalë dhe me kujdes. Si rezultat, do ta kishim mundësinë e përjetimit të peizazhit glamuroz përgjatë rrugës; do t'i vërenim gjërat që nuk i kishim vënë re në udhëtimet e mëparshme dhe do të kënaqeshim me aktin e ngasjes dhe përsiatjes mbi mjedisin, në vend se të shqetësoheshim se sa vaji ora ose ç'distancë duhet të mbulonim për të arritur në destinacion.

Kur merrni një udhëtim rrugor, vallë nuk rezervoni ca kohë shtesë që udhëtimi të jetë më i këndshëm për ju dhe bashkuudhëtarët? A nuk e shihni udhëtimin si një privilegj satisfaksioni në vend të një detyre të vështirë për ju dhe miqtë e juaj udhëtarë? Ky është qëndrimi që duhet ta adoptojmë edhe ndaj namazit.

Në thelb, hapi i parë joni është nënshkrimi i një marrëveshje të shkurtër armëpushimi me Kohën. Brenda kuadrit të kësaj marrëveshje, duhet të jemi në gjendje të ushtrojmë durim më të madh. Në fakt, mund ta shndërrojmë vetë durimin në një burim kënaqësie. Mund ta përjetojmë kënaqësinë e ushtrimit të durimit gjatë orëve të ditës së Ramazanit; ta përjetojmë kënaqësinë e të mësuarit që ta tolerojmë parehatinë deri sa të rehatohemi e qetësohemi; ta durojmë sëmundjen derisa të shërohemi; të presim mirësjellshëm në radhë për të blerë një biletë teatroje ose salle festi mi; të vetë-disiplinohemi për të studiuar që të kemi sukses akademikisht.

Mund ta përjetojmë kënaqësinë e vetë-privimit nga ajo në të cilën do të mund të involvoheshim. Për shembull, mund të përmbahemi nga blerja e një çokollate, një bluze ose një makine të re dhe në përputhje me disa parime, besnikërisht e me modesti të shfaqim solidaritet me ata që nuk mund ta përballojnë një blerje të tillë. Kjo është ajo që dua të them me përjetimin e durimit këmbëngulës, i cili hyn në lojë edhe në praktikën e namazit. Siç Allahu e urdhëroi Profetin e Islamit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]:

*Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë.*

(Ta Ha: 132)

Këmbëngulësia në durim gjatë faljes së namazit (lutjes kanonike) nuk nënkupton që namazi është një vuajtje, sprovë ose ndëshkim nga Allahu. Përkundrazi, nënkupton ushtrimin e vendosmërisë dhe determinimit të pacenuar për ta fituar ndjenjën e kënaqësisë që shpresojmë ta arrijmë. Sa më e madhe kënaqësia potenciale dhe satisfaksioni, aq më i lartë çmimi dhe aq më e madhe kërkesa e këmbëngulësisë në durim. A mund të ketë vallë kënaqësi më të madhe se t'ia besuarit mendimet dhe hallet private Krijuesit dhe t'i flakurit brought dhe dhimbjet, dhe pastaj të dalim nga ky takim intim duke u ndjerë të pastruar nga mëkatet dhe të rilindur përsëri?

## NAMAZI, SHKOLLA E DURIMIT; DURIMI, SHKOLLA E QYTETËRIMIT

Çuditë me avullimin e tërësishëm të diskutimit mbi virtytin e durimit nga literatura perëndimore. Vështirë se gjendet përmendja e durimit në diskursin perëndimor krahas virtyteve themelore njerëzore. Ky fenomen është konfirmuar nga ata që lexojnë më shumë se unë. Ka diskutime për guximin, ndershmërinë, vendosmërinë, dashurinë, bujarinë, kalorësinë, bashkëpunimin, integritetin, përkushtimin e sinqertë, drejtësinë, barazinë, lirinë, demokracinë, pë rulinë, gatishmërinë për t'i ndihmuar të ardhurit dhe të varfrit dhe shumë virtyte të tjera të lavdërueshme. Por, për habinë time, duket se ka fare pak ose aspak diskutime mbi virtytin e durimit edhe pse durimi është thelbësor për të gjitha virtytet e tjera morale. Kur, nga ana tjetër, kalkuloval numrin e fjalëve arabe për durimin, *Sabr*-in, dhe derivateve të tij që ndodhen në Kur'an, zbulova se ato ishin jo më pak se njëqind e tre, për të mos përmendur qindra shfaqje të tij në hadithet profetike.

Them, “për habinë time”, sepse është qytetërimi perëndimor ai që ka përparuar jashtëzakonisht në fushat e zbulimeve dhe shpikjeve shkencore! Të gjithë e dimë se durimi është virtyti që ia mundëson zbuluesit ose shpikësit të punojë pa u lodhur ditë e natë në laborator, të angazhohet në eksperimente të një lloji ose një tjetri dhe të kërkojë njohuri dhe aplikacione të reja. Si mund që këta individë ta kenë arritur përparimin që e gëzojnë pa durim, këmbëngulje dhe determinim? Duke pasur parasysh zbulimet shkencore të shquara që të tillët kanë bërë dhe suksesin e tyre në udhëheqjen e botës në aspektin akademik dhe në fusha të tjera, mund të themi pa mëdyshje se virtytet e durimit, këmbënguljes dhe ngulmimit janë rrënjëzuar thellësisht e fortë në karakterin e tyre sa që nuk shohin dot më nevojë për t'i përmendur ato në shkrimet e tyre.

Nëse u qasemi tri formave kryesore të adhurimit në Islam - namazit, agjërimit dhe haxhit në Mekë - gjejmë se secila prej tyre

është një s hqollë e krijuar posaçërisht për të na trajnuar në durimin këmbëngulës. Mund të vrisni mendjen: Është e qartë se si agjërimi dhe haxhi na e mësojnë durimin këmbëngulës. Por ç'relevancë ka durimi me namazin? Nëse, siç na mësoi Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], namazi është thjesht një namaz i vërtetë, nëse kryhet me nderim të përlur dhe me praninë e ndërgegjishme, atëherë qartë, durimi është një element jetësor në praktikën e tij.

Sa e lehtë, por sa e padobishme është një ndërmarrje si kjo: të nxitojmë në namaz deri në masën sa nuk jemi të vetëdijshëm për atë që e themi! Në të kundërtën, sa ndërmarrje fitimprurëse, por e vështirë: kur kemi angazhime të panumërta dhe detyra që presin në derë, ndërsa çdo këndimi (në namaz) i qasemi me vetëdije dhe prani. Që ta shprehim një frazë të hapur si "Allahu është më i madh (*Allahu Ekber*)" dhe pastaj madje edhe me biznesin e kësaj bote të ndalojmë së plotësuari hapësirën hipotetike mendore që e pason atë (Allahu është më i madh se çfarë?) është një sfidë që kërkon durim.

Po ashtu, që të shprehim shprehje glorifikuese të hapura (si *Subhane Rabbije el-Adhim* – I Dëllirë është Zoti im më Madhështor; *Subhane Rabbije el-A'la* – I Dëllirë është Zoti im më i Lartë) dhe pastaj, madje edhe me përgjegjësitë që peshojnë mbi ne të ndalojmë së së plotësuari hapësirën hipotetike mendore që i pason ato (Madhështor mbi kë? ose çfarë?) është një sfidë që kërkon durim.

Që të nxjerrim çdo fjalë në frazën *Bismilah er-Rahman, er-Rahim* (Në Emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tani dhe për çdo kohë) siç vepronte dhe Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ashtu që të reflektojmë mbi kuptimet përçuese mbi Karakterin Hyjnor, është një sfidë që kërkon durim.

Lipset durim për të pauzuar pas frazave: "Përshëndetjet i takojnë Allahut (*et-tehijatu lilah*)" dhe "si dhe lutjet dhe fjalët e mira (*ves-salavatu vet-tajibate*)" ashtu që, edhe përkundër të gjitha angazhimeve në pritje në jetën tonë, ta përjetojmë kënaqësinë



e marrjes së përgjigjes së Allahut. Lipse durim për të pauzuar pas përshe në detjes së Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ashtu që ta presim përsheendetjen e tij në këmbim; lipset durim për pauzuar edhe pas përsheendetjes së “robërve të mirë të Allahut (*ibadilahi es-salihin*)” ashtu që t’i japim vetes kohë për ta pranuar shpërblimin për përsheendetjen e të gjithë individëve.

Së fundi, dhe siç do të japim detaje më poshtë, lipset durim i mirë për të pauzuar midis çdo lëvizjeje të namazit dhe tjetrës, midis çdo këndimi dhe tjetrit, midis çdo ajeti kur’anor dhe tjetrit, ashtu që t’ia japim secilit prej tyre vëmendjen dhe respektin e merituar në mes të një orari të zënë.

Nëse reflektoni mbi të gjitha sukseset në jetë, të gjitha arritjet dhe të gjitha virtytet, do të gjeni se ajo që qëndron prapa tyre është praktika e durimit dhe vendosmërisë. Në anën tjetër, nëse reflektoni mbi dështimet, humbjet, mëkatet dhe gabimet, do të gjeni se ajo që iu shpiu tek to ishte mungesa e durimit. Eh ç’shkollë e mrekullueshme e suksesit dhe e shpëtimit është durimi, dhe ç’shkollë e mrekullueshme e durimit është namazi!

Profeti ynë i lavdishëm [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njëherë tha: “*Gjëja e parë që do të hiqet nga ky komunitet (bashkësia islamike) është nderimi i përrulur.*” Kur nderimi i përrulur mungon nga namazet tona, mungon edhe durimi, dhe kur mungon durimi, bie qytetërimi musliman. Në fund të fundit, Zoti i Plotfuqishëm ka afirmuar lidhjen midis suksesit dhe begatisë sonë tokësore, dhe bashkimit nderues me mbretërinë e Qiellit, duke thënë:

*Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përrulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit. (El-Mu’minun: 1-2)*

Pra, pas secilës prej pesë namazeve të përditshme, pyesni veten: “Sa “fuqi-durimi” kam fituar nëpërmjet namazit që sapo e mbarova?”



## KAPITULLI 6

### Përse falemi?

Përse falemi? Thjesht për ta mësuar durimin, apo...? Pse duhet të humbim një ose dy orë çdo ditë duke kryer lëvizje të çuditshme dhe duke përsëritur fraza të cilat i kemi shqiptuar qindra herë më parë? A nuk do të ishte më mirë që ta kalonim këtë kohë duke i ndihmuar të tjerët? Apo të bënim ndonjë punë tjetër bamirëse e humanitare? Po sikur namazi të mos ekzistonte fare?

Imagjinoni se ç'do të ndodhte nëse, papritur, të gjitha komunikimet me tel dhe pa tel të ndërpriteshin, stacionet satelitore të pushonin së funksionuari, linjat tokësore dhe rrjetet e internetit të kapitullonin dhe të gjitha rrugët tokësore, detare dhe ajrore të mbylleshin. Meditoni mbi anarkinë, frustrimin dhe kolapsin ekonomik, social, politik dhe kulturor që do të pasonte.

Një rol i ngjashëm luhet edhe në jetën tonë, përmes komunikimit me Krijuesin. Pra, a do të ishim në gjendje t'ia dilnim mbanë pa një komunikim të tillë qoftë edhe për një ditë të vetme? Çfarë do të ndodhte nëse linja komunikuese mes nesh dhe Allahut do të shkëputej? Nëse do të ndodhte kjo, do të duhej të shpiknim ndonjë mjet tjetër për të qëndruar në komunikim me Të. Por, vras

mendjen, a do të ishim në gjendje të gjenim ndonjë gjë më të mirë se sa “recetën përshkruese” të formuluar shkëlqyeshëm që e disponojmë, d.m.th. namazin, me fjalë të zgjedhura kujdesshëm dhe me veçori dalluese e lëvizje ekspresive?

## NAMAZI NA RIPROGRAMON

Ashtu siç valët e detit i shpërbëjnë gurët përgjatë bregdetit me kalimin e ditëve dhe të viteve, ashtu edhe jeta, në sajë të kalimit të kohës, familjaritetit, përsëritjes dhe zakonit, largohet nga forca shpirtërore, ekuilibri dhe pastërtia e brendshme që kemi arritur nëpërmjet namazit. Orë pas ore, ditë pas dite dhe vit pas viti, bota tokësore punon për të na programuar në përputhje me fantazitë dhe trillet e saj. Procesi ndodh aq gradualisht sa që tentojmë të mos jemi të vetëdijshëm se kemi ndryshuar. Në të vërtetë, megjithatë, jemi shmangur prej kursit të caktuar nga busulla e brendshme e dhuruar nga Allahu, dhe nuk jemi më në akord me programin origjinal hyjnor, “pa viruse” siç qemë instaluar në fillim. Siç deklaroi vetë i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]:

*“Besimi brenda jush do të vjetërsohet dhe do të lekoset ashtu siç lekosen rrobat tuaja. Lutjuni, pra, Zotit të Plotfuqishëm që t’ua ripërtërijë besimin në zemra.”<sup>8</sup>*

Me mirësinë e Allahut dhe në dallueshmëri nga pasuesit e feve të tjera, ne mbetemi në zotërim të “kompakt disk-ut” origjinal, që është një CD-ROM që përfshin programin për besimin tonë. Rrjedhimisht, mund t’i referohemi përsëri atij, ta përshtatim veten në bazë të tij dhe të riformatohe mi duke larguar çfarëdo “viruse” që janë ngjethur në sjelljen e shtrembërimit dhe sëmundjeve.

8 Transmetuar nën autoritetin e Abdullah Ibn Amrit. E saktësoi Albani në *Sahih el-Xhami el-Saghir ve Zijadatuh*.

Fjala-për-fjalë, narrative të vërtetuara në bazë të burimeve të shumta dhe të transmetuara nga transmetuesit e shumë të kanë përcjellë mostrën origjinale për namazin, ashtu siç ishte thënë dhe praktikuar nga vetë Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili tha thjeshtësisht: *“Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur.”*<sup>9</sup> Tani, nëse nuk do të kishte namaz, a do të ishim në gjendje të “shpiknim” një namaz që do të na vinte në kontakt me Madhështorin, Sundimtarin e Lartësuar të universit?

Nëse i hulumtojmë Shkrimet Hebraike (Dhiatën e Vjetër) dhe Ungjillin (Dhiatën e Re) në format ekzistuese që janë tani, nuk do të gjejmë detaje rreth natyrës së namazeve të praktikuar nga Musai ose nga Isai (Jezusi) [alejhimus-selam], i cili do të shërben-te si një model për t’u emuluar nga ndjekësit e tyre. Prandaj, është e natyrshme që ndjekësit e feve hebraike dhe të krishtera të shpiknin rituale namazore për veten e tyre dhe t’i kalojnë ato nga një brez në tjetrin. Sidoqoftë, ata që i praktikojnë këto namaze nuk e përjetojnë kënaqësinë e përjetuar nga adhuruesit muslimanë, bazuar në të kuptuarit se këta të fundit e përsërisin një namaz që Profeti i tyre [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e ka pranuar dikur nga Zoti i Plotfuqishëm.

Siç kemi vërejtur, as Dhiata e Vjetër e as Dhiata e Re nuk përmbajnë ndonjë përshkrim të hollësishëm të namazeve të praktikuar nga këta dy profetë të mëdhenj, në të cilin përshkrim pasuesit e tyre do të mund t’i përngjasonin lutjet e namazet e tyre. Në Dhiatën e Re, për shembull, kemi një pasazh që përshkruan se si një nga dishepujt e Isait (Jezusit) [alejhis-selam] i tha atij:

*Zot, na mëso të falemi ashtu siç i mësoi Gjoni dishepujt e vet. Dhe ai u tha atyre: “Kur të faleni, thuani...” (Lluka 11: 2-4)*

Sipas tregimit në Ungjillin e Lukës, namazi që Isai (Jezusi) [alejhis-selam] ua mësoi dishepujve të tij përbëhej nga tridhjetë e

9 Transmetuar nën autoritetin e Malik Ibn Huvejrith el-Lejthit. E saktësoi Albani në *Sahih el-Xhami*.

katër fjalë, ndërsa Ungjilli i Mateut (Mateu 6: 9-13) përmban një version të përbërë nga pesëdhjetë e tre fjalë. Një situatë e ngjashme ndodh me agjërimin. Çdo emërues propozon kushtet dhe rregullat e veta për agjërim, duke specifikuar cilat ushqime lejohen dhe cilat nuk lejohen, kur dhe për sa kohë duhet agjëruar etj. Për më tepër, rregullat dhe dispozitat e tilla ndryshojnë nga një epokë në tjetrën dhe nga një vend në një tjetrin.

Muslimanët, shpesh përfshihen në argumentime e polemika të nxehta rreth detajeve të vogla që kanë të bëjnë me namazin. A duhet t'i ngritim duart, për shembull, sa herë që shqiptojmë frazën, *Allahu Ekber* (Allahu është më i madh)? A duhet t'i ngritim ato vetëm në disa raste të caktuara? Apo duhet t'i ngritim vetëm në hapjen e namazit? Ku duhet t'i vendosim duart gjatë faljes së namazit? A duhet t'i mbajmë në kërkthizë? Mbi kërkthizë? Pak më lart se aty? Të njëjtat lloje polemikash ndodhin mbi detajet e tjera të namazit, që shpesh çojnë në grindje dhe tjetërsim. Kur vërej konflikte të tilla, ndiej, besoni ose jo, një lloj kënaqësie gazmore! Kjo sepse forma e namazit që na është transmetuar nga Profeti ynë i dashur [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nëpërmjet shokëve të tij besnikë është kaq e hollësishme dhe e plotë në përshkrimet e saj; është e bazuar në hadithe të shumta me zinxhirë të shumtë të transmetuesve, sa është e mundur që mosmarrëveshjet e tilla të ngrihen. Të gjitha vendimet që kemi në Islam, zbritën nga Qielli në Tokë, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me namazin. Në lidhje me këtë praktikë të fundit, Zoti i botëve zgjodhi që Lajmëtarin e Tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] të ngjitej në Mbretërinë Qiellore për ta pranuar atë drejtpërdrejt prej Tij në formën e tij origjinale, të frymëzuar në mënyrë hyjnore dhe për t'u kthyer me të pastaj në Tokë si një dhuratë për komunitetin musliman.

Ç'Profet besnik që kemi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]! Ai që na e solli dhuratën e namazit ashtu siç e kishte pranuar vetë nga Zoti i tij, dhe i cili u kujdes në përcjelljen e detajeve të sakta e të lehta; ai që në e përcolli mjetin më të lehtë dhe më të shquar të

transportit në historinë njerëzore: mjet që na transporton në praninë e Allahut! Vallë, nuk e kuptojmë se ç'gjë e çmuar është posedimi i një panorame të plotë dhe të kristalizuar të namazit, pikërisht ashtu siç është pranuar nga Profeti ynë [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] prej Zotit të tij gjatë udhëtimit të mrekullueshëm në qiell; një panoramë me përmasa të gjera dhe madje disa, detajet minore të të cilave janë dakorduar nga të gjitha vlerat muslimane?

Për më tepër, a e kuptojmë rëndësinë e të paturit Sunetin, i cili mbulon detajet e gjithçkaje në jetën tonë nëpërmjet përshkrimit të pothuajse të gjitha gjërave që Profeti ynë [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë dhe ka vepruar? Askush nuk do ta kuptojë rëndësinë e Sunetit pos atyre që e kuptojnë se ç'privim gëzojnë fetë e tjera që vuajnë nga mungesa e tij. Çuditërisht dhe njëkohësisht ndiej keqardhje për ata që, pa dijeni dhe të ndikuar nga fetë e tjera, i bëjnë thirrje bashkësisë muslimane që të heqin dorë nga Suneti dhe të mos kënaqen me asgjë tjetër përveç Kur'anit!

Ç'thesar, ç'dallim, ç'burim mbrojtjeje dhe udhëzimi është Suneti, të cilin të tillët duan ta zhveshin nga Islami! Allahu i Plotfuqishëm e bëri Sunetin referencë ndaj shumë ajeteve në Kur'an. I Madhërishmi na fton ta pasojmë, t'i nënshtrohemi dhe ta imitojmë të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili e solli atë duke thënë:

*Çka t'ju japë Pejgamberi, atë merrnie, e çka t'ju ndalojë, përmbanjeni.*  
(El-Hashr: 7)

Dhe:

*Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit.* (El-Ma'ide: 92)

Vërtet, bindja ndaj të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është, në thelb, bindje ndaj Allahut:

*Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut. (En-Nisa: 80)*

Në mënyrë të ngjashme, Allahu pohon rëndësinë dhe relevancën e Sunetit për jetën dhe përvojën tonë duke e quajtur atë si

*shembullin më të lartë. (El-Ahzab: 21)*

Këtu qëndron rëndësia e Sunetit, e cila sqaron natyrën kritike të namazit dhe domosdoshmërinë e faljes së tij me të gjitha lëvizjet, këndimet dhe detajet e tjera. Është një kopje origjinale e një “programi softuerik” të plotë, intensiv, të frymëzuar në mënyrë hyjnore, i cili vepron për të riprogramuar shpirtat tanë pesë herë në ditë. Ky numër i përsëritjeve është i majftueshëm për të eliminuar çfarëdo “virusi” që mund të depërtojë në “kompjuterin” e jetës sonë gjatë orëve të natës ose ditës. Namazi na furnizon me një proteksion mbrojtës kundër ndikimeve që kërcënojnë të na largojnë nga vetja jonë e vërtetë dhe rruga që Allahu ka caktuar për ne. Në të njëjtën kohë, nxjerr flakët e mëkateve dhe pikëllimit që kanë tendencë të shpërthejnë në çdo cep të jetës sonë tokësore.

*Jeni në zjarr, jeni në zjarr [nga keqbërja]! Por, nëse e falni namazin e sabahut, sabahu ua tjetërson flakët. Përsëri jeni në zjarr. Por nëse e falni namazin e drekës, flakët u shuhen. Prapë ju kap zjarri, por nëse e falni namazin e ikindisë, flakët veniten edhe njëherë. Ende jeni në zjarr, por kur e falni namazin e akshamit, flakët zhbëhen. Edhe një herë ju kap zjarri, por nëse e falni namazin e jacisë, ajo i fikë flakët. Pastaj shkoni për të bërë gjumë, dhe asgjë nuk regjistrohet kundër jush deri sa të zgjoheni.<sup>10</sup>*

Një mjeke japoneze moshëre më pyeti njëherë: “Është e vërtetë që muslimanët falen pesë herë në ditë?” “Po.” - iu përgjigja. Në një ton të habitshëm që kufizonte indinjatën, pyeti ajo prapë: “Si

10 Transmetuar nën autoritetin e Abdullah Ibn Mes’udit. E saktësoi Albani në *Sahih el-Targhib*.

mund ta bëni këtë? A nuk është e mundimshme kaq shpesh?” “Ti je një mjeke,” - i thashë, - “dhe gjatë orarit të punës, takon dhe trajton një numër të konsiderueshëm pacientësh, bile atë në baza ditore. Më thuaj, sa herë në ditë i dezinfekton duart?” “Diku midis tridhjetë e pesëdhjetë,” - u përgjigj ajo. Më shikoi, dhe nga shikimi në sytë e saj mund të shihja se ajo e kuptoi atë që doja t’ia thosha, para se ta thosha.

*“Ngrihuni dhe faluni, sepse në namaz ka shërim.”*<sup>11</sup> Jeta që na rrethon është e mbushur me “virese” - tundime, joshje mashtruese, dobësi njerëzore, perversione dhe impulse të këqija. I vetmi dezinfektor që mund të na pastrojë nga ndikimet e tilla nuk është uji, por namazi. Uji pastron trupin nga papastërtitë e jashtme, ndërsa namazi është mjeti me të cilin mund të pastroni veten së brendshmi. Nëse, pas faljes së namazit, ndjeheni në të njëjtën mënyrë siç ndiheshit para faljes së tij, nëse nuk e keni ndjesinë se diçka keni ndryshuar, se jeni çliruar nga disa papastërti dhe mëkate që ju kishin rënduar më parë, se jeni rilindur disi, atëherë kjo implikon se nuk e keni përdorur mirë “CD-ROM-in” namazor për riprogramim, dhe se do të ktheheni në të menduarit dhe të silleni pas faljes së namazit në të njëjtën mënyrë siç ishit para tij.

Nëse e krahasojmë jetën e namazfalësve të rregullt me jetën e atyre që nuk falen, do të ndiejmë keqardhje për këta të fundit, pasi u mungon një armë vitale për t’i luftuar vështirësitë e jetës dhe për t’i duruar sprovat dhe vuajtjet e saj. Do të mrekullohemi me ata që falin namaz në kuptimin e vërtetë të fjalës, pasi fytyrat e tyre mbeten plot dritë pa marrë parasysh se sa e errët është rruga përpara, ndërsa sytë e tyre shkëlqejnë me dashuri, përlësi dhe zemërbutësi edhe përkundër ashpërsisë së sprovave. Mund ta dallojmë pothuajse në një shikim të rrufeshëm se kush falet me të vërtetë dhe kush jo. Kur’ani i referohet këtij fenomeni kur flet për ata që i shihni:

11 Transmeton Ibn Maxhe nën autoritetin e Ebu Hurejres.



*... kah përkulen (në ruku), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde), e kërkojnë prej Allahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes [ether el-suxhud]. (El-Fet'h: 29)*

Fraza “*ether el-suxhud*” është përkthyer si “gjurmë e sexhdes”, duke aluduar që fraza “*shenja... në fytyrat e tyre*” i referohet pikës së errët e të ngrysur që shihet në ballin e disa prej atyre që kalojnë kohë të gjatë në sexhde. Megjithatë, sikur kjo të ishte e nënkuptuara nga fraza e lartpërmendur, a nuk do të lexohej më mirë ajeti si: “*shenja... mbi ballin e tyre*”? Në të kuptuarit tim mbi këtë frazë, ajo i referohet shkëlqimit që vërehet në fytyrat e të tillëve dhe atmosferës së mirësisë dhe zemërgjerësisë që buron prej tyre. Cilësitë e tilla, të cilat ekspozohen vetëm nga ata që falen, nuk kalojnë pa u vënë re asnjëherë nga bashkëbesimtarët.

Në thelb, të gjitha aktet e adhurimit të kërkuara nga muslimanët janë thjesht mjete për të riprogramuar shpirtat e tyre, edhe pse ato ndryshojnë në funksionet specifike dhe kohëzgjatja e përkohshme. Agjërimi i Ramazanit, për shembull, është një program që kërkon shumë kohë për t’u “shkarkuar” mbi shpirtat tanë. Megjithatë, ai prapëseprapë ka efekte afatgjata. Megjithëse “shkarkimi” merr një muaj të tërë kohë, dobitë e tij zgjasin për një vit të tërë. Duke agjëruar, “riformatojmë” mallëngjimin për dëshirat tokësore që ishin intensifikuar nga “viruset” gjatë rrjedhës së vitit të kaluar. Riprogramojmë vizionin tonë, i cili pashmangshmërisht është komprometuar me kalimin e kohës nga dobësia njerëzore përballë joshjeve të Shejtanit. Në mënyrë të ngjashme, i riprogramojmë gjuhët të cilat, me kalimin e muajve, kanë kanalizuar një përzierje të së drejtës dhe të kotës, të lejuarës dhe të ndaluarës, të mirës dhe të keqes, të vërtetës dhe të rremës. I riprogramojmë shpirtat tanë, të cilët gjatë rrjedhës së vitit janë infiltruar nga sëmundje të ndryshme të dëmshme që kanë vrarë gati farën e mëshirës, të së vërtetës, drejtësisë, vullnetit të mirë, kënaqësisë,

përlësisë, durimit, drejtësisë, mirësisë, falënderimit, besimit dhe diskursit udhëzues e konstruktiv.

Një funksion i ngjashëm kryhet nga haxhi ose pelegrinazhi në Mekë, edhe pse në një rrafsh më të thellë dhe më të qëndrueshëm.

Pelegrinazhi i pranueshëm nga Allahu shpërblehet me Xhenet, dhe kryerësit e tij, ashtu siç i Dërguari Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka premtuar, do të restaurohen në shpirtin e pastërtisë, të cilin e gëzonin ditën kur erdhën në këtë botë. Vini re se si namazi zhvillohet gradualisht më shpesh derisa dita progreson, dhe derisa sulmet e dëmshme të jetës për ne fillojnë të përshkallëzohen. Pas faljes së namazit të sabahut (*Salat el-Fexhr*), presim gati një gjysmë dite përpara se ta falim namazin e drekës (*Salat el-Dhuhr*). Sidoqoftë, koha që kalon mes namazit të drekës dhe atij që e pason është më e shkurtër, me gjysmën e dytë të ditës duke u nënvizuar nga namazi i ikindisë (*Salat el-Asr*), namazi i akshamit (*Salat el-Magrib*) dhe, pak më shumë se një orë më vonë, namazi i jacisë (*Salat el-Isha*).

Namazi është projektuar për ta pastruar dhe riprogramuar individin që falet. Kjo, pra, është një nga arsyet për praktikimin e tij përsëritshëm gjatë gjithë ditës. Dhe, vras mendjen: Ku, në cilën fabrikë të armëve moderne në botë, mund ta gjeni një armë kaq të efektshme, të saktë në qëllimin e saj, kaq të sigurt për ta guditur cakun, dhe sigurisht për të garantuar fitore dhe për të arritur rezultate të dëshiruara?



## KAPITULLI 7

### Ritmi i namazit dhe ritmi i jetës

Në dimër kërkojmë ngrohtësi e në verë, freski. Në sëmundje kërkojmë shërim e në uri ushqim; në etje ujë e në trazirë qetësi dhe trankuilitet. Në frikë kërkojmë siguri. Kur rrotat e jetës marrin një ritëm të përshpejtuar, të cilin ato me siguri e performojnë në epokën tonë mekanike dhe elektronike, nëse namazi do të ishte streha jonë e cila i pengon ato të na shtypin midis dhëmbëzorëve të tyre të mprehtë e të hekurt, atëherë është e logjikshme që kundërforca e namazit ta na e ofrojë shkallën më të madhe të mundshme të relaksimit dhe qetësisë.

E keni imagjinuar ndonjëherë se ç'do të ndodhte sikur namazi të lëvizte në të njëjtin ritëm të trazuar siç shënohen aktivitetet tona të përditshme? Po të ndodhte kjo, namazi do të shndërrohej në një barrë tjetër, shtuar një të gjate "liste obligimesh". Ajo që na peshon, e ha kohën tonë, na e zvogëlon energjinë dhe e intensifikon presionin mbi trupat dhe mendjet tona tashmë të shtyra. Dhe pikërisht kjo ngjan te shumë individë. Si rezultat, përpiqemi t'u japim fund namazeve sa më shpejt që është e mundur, siç veprojme

dhe me gjërat e tjera rutinore të mundimshme. Në fakt, duke i pasur parasysh rezultatet dekurajuese që vrojtojmë nga namazi, mund të tundohejmë të heqim dorë nga kjo “detyrë” mekanike krejtësisht! Dhe kjo është, në të vërtetë, ajo që ndodh me shumë muslimanë, në jetën e të cilëve nuk ka vend ndonjë gjë tjetër pos këtij lloji të aktivitetit të tërbuar.

E di mirë se ky ndryshim do të jetë i vështirë për ne fillimisht. Në fund të fundit, si vallë të mendohet ngadalësimi në namaz kur një mijë e një detyra, përgjegjësi, takime, programe i bëjnë thirrje vëmendjes tonë? Nga ana tjetër, nëse kjo është mënyra se si mendojmë ndërsa përgatitemi për t’u ngjitur në sferat e larta të namazit, anija jonë kozmike asnjëherë nuk do të dalë jashtë atmosferës së tokës në hapësirën e jashtme. Ose, akoma më keq, anija kozmike do të marrë flakë para se të largohet ndonjëherë nga toka. Do të jemi si muslimani të cilit Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i tha dikur: *“Kthehu dhe falu përsëri. Ende s’je falur.”*<sup>12</sup> Pra, siç kemi sugjeruar, namazi duhet të shërbejë si një kundërpeshë ndaj ritmit të ngutshëm të jetës e rutinës së përditshme. Për këtë arsye, ritmi ka kuptim të përsosur për namazet që përfshijnë këndim të heshtur, siç është namazi i drekës, për shembull, ashtu që ai të lidhet në mënyrë të anasjelltë me tonin e jetës në atë kohë të trazuar e të potershme të ditës: një kohë e ngutjes dhe nxitimit të zhurmshëm kur dielli është në zenit dhe temperaturat janë në rritje e sipër, dhe në mes të stuhisë së ditës së aktivitetit derisa njerëzit nxitojnë urgjentisht për t’i përmbushur detyrat e tyre dhe për të arritur përfitime materiale.

Sa i përket namazit të akshamit, i cili zakonisht shoqërohet me këndime të dëgjueshme, ai mban një lidhje të pandryshueshme, inverse e të përshtatshme me heshtjen dhe qetësinë e natës kur njerëzit tërhiqen nga përpjekjet për të fituar furnizimin e tyre të

12 Transmeton Buhariu nën autoritetin e Ebu Hurejres.

përditshëm dhe lejojnë që mulliri i jetës të kthehet në një ritëm më të butë dhe më të qetë. Këndimi i dëgjueshëm shërben për ta mbushur një pjesë të hapësirës së lënë bosh pas ritmit të ngadalshëm të jetës dhe e rikthen ekuilibrin në jetën tonë të brendshme duke rivendosur një harmoni të zërit, imazhit dhe lëvizjes.

E përfundojmë ditën me namazin përfundimtar, atë të jacisë, i cili shënohet nga gjatësia dhe shumëllojshmëria. Falim katër rekate, dy prej të cilave shoqërohen me këndime të dëgjueshme që i kundërvihen heshtjes dhe qetësisë së natës, duke e mbushur kështu hapësirën që na është lënë nga tërheqja e orëve të dritës e duke i ngritur zërat tanë drejt Zotit. Namazi përfundimtar i mbrëmjes pasohet nga dy rekate të bazuara në Sunet, të cilat pasohen nga ana e Vitrit: një, tre, pesë ose një numër tjetër tek i rekateve. Ky numër i hapur, që është karakteristikë e shumë ritualeve islame të adhurimit, siguron një fleksibilitet që na lejon ta zgjasim namazin nëse ndihemi veçanërisht të rënduar nga ngarkesat e ditës, të komprometuar nga ngjarjet dhe mendimet e ditës ose kur kemi nevojë për mbrojtje nga sulmet shpirtërore, tundimet ose përpjekjet që parashohim gjatë orëve të natës.

Vini re se në përgjithësi, sa më i madh numri i rekateve të namazeve të detyrueshme në një kohë të caktuar ditore, aq më i madh numri i rekateve bazë të Sunetit (d.m.th. rekateve të namazit që nuk janë të detyrueshme, por që kryhen në emulimin e praktikës e Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]). Ky fakt tregon nevojën për numrin e rekateve të namazit në çdo namaz për të pasqyruar ndryshimet që ndodhin në kushtet e jetës sonë nga një kohë e ditës ose nga një natë në tjetrën.



## KAPITULLI 8

# Shumëllojshmëria: leksioni i parë drejt qytetërimit

E keni pyetur veten ndonjëherë, siç e kam pyetur unë: Përse pesë namazet e përditshme në Islam janë me gjatësi të ndryshme, shifra të ndryshme rekatesh, lëvizjesh, këndimesh dhe përse i falim në kohë të ndryshme? Përse nuk e marrin të gjitha formën e njëjtë dhe të zgjatojnë për të njëjtin interval kohor siç ndodh me ritualet e feve tjera? Përse kjo shumëllojshmëri, kjo pangjashmëri, këto “komplikime”, këto “vështirësi”, këto “konfuzione”? Përse falim rekate të ndryshme në namazin e sabahut, në namazin e drekës, në namazin e ikindisë, në namazin e akshamit dhe në namazin e jacisë? Përse disa namaze janë të detyrueshme ndërsa të tjerat thjesht Sunet (një emulim vullnetar i praktikës së Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem])? Përse disa përmbajnë numër tek të rekateve ndërsa të tjerat çift? Përse disa rekate të bazuara në Sunet vijnë para namazeve të detyrueshme ndërsa të tjerat pas? Përse disa namaze të bazuara në Sunet përmenden si “shumë të theksuara” (*mu’ekkede*), por jo edhe të tjerat? (Praktikat që përshkruhen si

“shumë të theksuara” në Islam janë ato në të cilat Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është angazhuar në mënyrë strikte e të rregullt.) Përse disa falen gjatë ditës ndërsa të tjerat gjatë natës? Përse disa këndime duhet të bëhen në heshtje ndërsa të tjerat të zëshme? Përse disa namaze kryhen individualisht ndërsa të tjerat në xhemat? Kjo që trajtuam, të lë përshtypjen sikur po marrim një kurs akademik të vështirë dhe të nivelit të lartë, i cili kërkon që adhuruesi të zotërojë një sasi vëllimore të materialit dhe të përfundojë gjithë kursin përpara se ai ose ajo të dijë të falet. A nuk i bën kjo gjërat padrejtësisht e tepër të vështira për fëmijët, të miturit dhe të paarsimuarit? Për më tepër, a ka kuptim kjo duke e pasur parasysh faktin se Islami i është shpallur një kombi “analfabet”, pjesëtarët e të cilin nuk dinin as shkrim e as lexim?

Mendja jonë e kufizuar njerëzore, asnjëherë nuk do të jetë në gjendje ta perceptojë plotësisht urtësinë hyjnore që i nënshtrohet këtyre çështjeve; prandaj, nuk mund t'i arrijmë përgjigjet e pyetjeve të tilla vetë. Megjithatë, si muslimanë, jemi urdhëruar të përsiatim, ta përdorim arsyen dhe t'i shqyrtojmë qëllimet e urta hyjnore të Zotit rreth asaj që Ai dëshiron për ne me shpresën se, megjithëse nuk mund t'i kuptojmë plotësisht, të paktën, mund t'i kuptojmë pjesërisht.

Ka qenë një burim habie për shumë, përfshirë muslimanët, se si me një shpejtësi edhe më të madhe se ajo e dëshmuar nga revolucioni kompjuterik në kohën tonë, Islami i shndërroi arabët nga një komb në të cilin, nëse dikush do ta pranonte një mesazh të shkruar, do t'i duhej të udhëtonte diku tjetër për të gjetur dikë që t'ia lexojë; në një shoqëri që, në hapësirën e më pak se dy ose tre dekadave, krijoi dhe zhvilloi disiplinat e gjuhësisë me fokus në: gramatikë dhe sintaksë, fjalorë-shkrime, retorikë, kritikë letrare, interpretimi kur'anor, lexim të varianteve të Kur'anit, shkenca të hadithit, jurisprudencë, biografi profetike, kritere me të cilat vlerësohet besueshmëria e transmetuesve të hadithit si transmetues të traditës islame dhe narrativeve të saj,

gjeologji, histori, gjeografi, filozofi, logjikë, mjekësi, astronomi, matematikë dhe fusha të tjera akademike.

Namazi islam luajti një rol të rëndësishëm, me një shpejtësi të jashtëzakonshme në krijimin e qytetërimit islam; një histori shpejtësie që nuk ishte dëshmuar para asaj kohe dhe që nuk është dëshmuar që atëherë. Shumëllojshmëria sfiduese e karakterizon namazin në aspektin e lëvizjeve fizike dhe këndimeve, mënyrave në të cilat shqiptohen këndimet, kohëve në të cilat duhet të falen namazet dhe numrit të ndryshëm të cikleve të namazeve ose rekateve si shkolla në të cilën truri i fëmijës musliman së pari përgatitet për të menduar, për të nxënë përmendësh, për të analizuar dhe për të qenë inovator dhe krijues. Aktivitetet e përfshira në namaz zgjerojnë fuqinë e qelizave të trurit të fëmijëve, duke i ndihmuar ata t'i organizojnë mendimet e tyre, të degëzojnë pyetje dhe problematike, të kategorizojnë tema dhe të analizojnë të dhëna, duke krijuar themelet e njohurive dhe duke përgatitur rrugën për eksplorimin e horizonteve të reja kulturore. Me anë të këtij mekanizmi pedagogjik, Islami ishte në gjendje ta transformonte një racë njerëzish të paargumentuar në atë që ne do të quajmë, jo një perandori - pasi shumë prej tyre janë perandori që nuk kanë njohur asgjë tjetër veçse pushtimit, gjakderdhjes dhe luftës siç ishin mongolët dhe tatarët - por, në një qytetërim plotësisht të rumbullakosur që përfshin nivelet e larta të intelektit, kulturës, shkencave dhe moralit.

Është e zakonshme në Perëndim që një fëmijë të fillojë shkollën në moshën pesë vjeçare. Në shumicën e vendeve arabe dhe islamike, fëmijët fillojnë mësimin shkollor në moshën gjashtë vjeçare. Megjithatë, shkollimi islamik fillon në moshën shtatë vjeçare, pasi kjo është koha në të cilën jemi urdhëruar t'i mësojmë fëmijët ta falin namazin. Duke pasur parasysh natyrën e harmonizuar të namazit, çdo musliman pritet të hyjë në shkollën e dijes, mendimit, kulturës dhe qytetërimit duke ndërtuar në këtë moshë të re - me gjithë atë që termi "shkollë" nënkupton



nëpërmjet përgjegjësisë, kuptimit, memorizimit, përgatitjes dhe planifikimit - aftësinë për sukses përmes përsosmërisë, inventivitetit dhe krijimtarisë. Prandaj, nuk duhet të ketë më analfabetizëm, jo as injorancë, as hidhërim, neglizhencë ose kapitullim ndaj injorancës që kalon nga brezat e mëparshëm. Jeni muslimanë, prandaj jeni të arsimuar. Jeni muslimanë, prandaj jeni të civilizuar.

Kursi i parë që njeriu pritët ta mësojë dhe ta praktikojë në shkollën e Islamit është ai i namazit. Aty memorizon numrin dhe emrat e pesë namazeve të përditshme, llojet e tyre (të detyrueshme, dhe me bazë në Sunet etj.), periudhat e tyre kohore, këndimet e tyre, detyrimet e tyre dhe veprimet ose lëvizjet e ndërlydhura që janë të lejueshme dhe të palejueshme. Pastaj, në mënyrë që ai të jetë musliman i vërtetë, duhet të fillojë ta vendosë këtë dituri në praktikë. Nuk është e pranueshme, që pasi njeriu të ketë “diplomuar” nga shkolla e Islamit, ta harrojë atë që e ka mësuar, pasi shpesh ndodh në shoqëri kur, pasi një student e përfundon shkollën e mesme ose universitetin, pothuajse asgjë që ai ose ajo ka studiuar dhe memorizuar nuk është evidente në jetën e tij / saj, meqë diploma që ai ose ajo mban tani nuk është gjë tjetër veçse një mënyrë për ta fituar një pozitë pune ose për të jetuar.

Kur namazi bashkohet me memorizimin dhe këndimin e Kur’anit, zbatimin e mësimëve kur’anore në rrethanat e jetës dhe memorizimin e gjërave që Profeti [sal-lallahu alejhi ve sellem] bëri dhe tha, muslimanët e rinj do të tentojnë natyrshëm të studiojnë dhe të absorbojnë atë që kanë nevojë nga shkencat tjera relevante islame, të cilat do t’ua mundësojnë të marrin një kuptim më të thellë të disiplinave të tjera akademike.

Në jetën e muslimanit, namazi mishëron njohuri dhe kulturë; rrjedhimisht mishëron qytetërimin. Si ndryshe mund të shpjegohet fakti se në shumë raste, studentët e edukuar për të falur namazin shkëlqejnë mbi ata që janë rritur në familje ku namazi nuk është falur asnjëherë?

Megjithatë, përveç mbjelljes së farave të dijës dhe kulturës në adhuruesin, shumëllojshmëria e pandarë në namaz kryen edhe një funksion tjetër të rëndësishëm, dhe ajo është rrënjosja e një qëndrimi të nderimit të përlulur.

## RËNDËSIA E SHUMËLLOJSHMËRISË PËR NDERIMIN E PËRLULUR

Çdo gjë përsëritëse, monotone ose mekanike, do të na bëjë ta humbim përqendrimin mendor, i cili rrjedhimisht çon në shpërqendrim dhe mbase edhe na bën të bëjmë gjumë. E keni vënë re ndonjëherë se kur vozisni drejt për një periudhë të gjatë kohore në autostradë, ku rrallëherë ndryshoni shpejtësinë, ju kap mërzia dhe mendja ju hutohet? Armiku numër një i nderimit të përlulur dhe aftësisë për t'u zhytur në namaz dhe për të soditur kuptimet e tij ashtu që t'i afrohem Allahut, është kapitullimi në familjaritet mekanik dhe zakonor. Dhe kjo ndodh sepse nuk arrijmë ta përdorim mirë shumëllojshmërinë e lejuar në namaz. Ne këmbëngulin në marrjen e autostradës kryesore, në vend se t'i eksplorojnë rrugët anësore gjarpëruese e pështjelluese me peizazhet e tyre, vazhdimisht në ndryshim.

Shumëllojshmëria e ofruar në namaz në formën e numrave të cikleve të namazit në secilën prej pesë vakteve, kohëve të ndryshme në të cilat ato falen, formave të ndryshme të këndimit, pozicioneve të ndryshme trupore, lëvizjeve trungore dhe gjymtyrëve gjatë namazit, mënyrës në të cilën çdo lloj këndimi është i lidhur me pozicione të ndryshme dhe lëvizje trupore, ndihmon në reduktimin e mundësisë së të qenit të hutuar nga ajo që bëjmë ose themi kur falemi dhe njëherit na kursen nga ndjenja monotone dhe dështimi. Si pasojë, këto karakteristika të namazit mund të na bëjnë më të vetëdijshëm për veten tonë, veprimet dhe fjalët tona;

na bëjnë më nderues dhe më të harmonizuar me lidhjen tonë me Zotin ndërsa kryejmë këtë rit të thelbësor të adhurimit të përditshëm. Përveç kësaj, namazi është një formë e shkëlqyer e trajnimit praktik për trurin, i cili e përgatit atë për të absorbuar mësimet e tjera, të cilat gjithmonë kanë qenë dhe duhet të mbeten themeli mbi të cilin ndërtojmë qytetërimin njerëzor.

Mësimet që duhet të përmbliidhen pak nga pak nga namazi nuk janë të lehta. Por, kur vallë ka qenë detyrë e lehtë të ndërtohen qytetërimet njerëzore dhe të krijohen shtete e qeveri? Arritjet e tilla asnjëherë nuk mund të realizohen pa një shpirt vendosmërie dhe angazhimi. Mbase është pikërisht për shkak të shumëllojshmërisë që shënon shtylla e dytë e Islamit dhe mësimet e vështira, arsyeja që fëmijëve muslimanë lipset t'u mësohet që në fillim të moshës shtatë vjeçare se Mbështetësi i Universitetit zgjodhi ta thërrasë Profetin tonë të madh [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në praninë e Tij në Qiellin e Shtatë, në mënyrë që Vetë t'ia japë këtë mësim kritik në vend se, ashtu siç bëri me aspektet e tjera të Islamit, t'ia komunikonte përmes Engjëllit Xhibril [alejhis-selam].

Diversiteti është mjet i të nxënimit të fleksibilitetit dhe pranimit të të tjerëve. Mëshira e njerëzimit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përçoi mësimet e paçmueshme dhe të paharrueshme për fleksibilitetin dhe shumëllojshmërinë, qoftë përmes namazit ose mjeteve të tjera, dhe veçanërisht përmes namazeve vullnetare ose me bazë në Sunet. Ky fleksibilitet konspekton frymën e tolerancës dhe Islamin mesatar, i cili përshtatet lehtë në epoka dhe mjedise të ndryshme dhe në rrethana të ndryshme shoqërore e individuale.

## PËRSE KAQ SHUMË POZITA DHE LËVIZJE TË NDRYSHME?

Pozicionet e ndryshme trupore që detyrohen nga namazi nuk janë arbitrare. Përndryshe, thjesht do të mund të këndonim gjithçka në

namaz ndërsa ulemi, qëndrojmë në këmbë, shtrihemi në shpinë ose para, në vend se të jemi të detyruar të përfshihemi në lëvizjen fizike.

Përveç rolit që luhet nga lëvizjet fizike në namazin e ndihmës në shmangie të rreziqeve të përsëritjes, monotonisë dhe hutisë, mund të hamendësojmë: Përse këndimet e ndryshme në namaz janë të shoqëruara nga ndryshimet në pozitat trupore? Përse fraza “*Subhane Rabbije el-Adhim* – I Dëlirë është Zoti im më Madhështor”, shqiptohet në ruku, për shembull, në vend se të thuhet në sexhdes, gjatë së cilës shqiptojmë fjalët, “*Subhane Rabbije el-A’la* – I Dëlirë është Zoti im më i Lartë”? Përse vetëm derisa qëndrojmë në këmbë këndojmë ajete kur’anore, ndërkohë që vetëm kur qëndrojmë ulur themi fraza në bazë të teksteve jo-kur’anore? Dhe “përse-të” vazhdojnë.

Pozicionet ndryshuese që adoptojmë gjatë namazit, siç e kemi parë, mund të na ndihmojnë të mbetemi të zgjuar dhe vigjilentë, duke i kushtuar vëmendje të plotë Atij të Cilit i drejtohem. Derisa pozicionet tona të ndryshme trupore lidhen me këndimet tona, përmes namazit stërvitemi si ta përvetësojmë e mishërojmë përmbajtjen e asaj që po e këndojmë, ndërsa lëvizjet tona trupore janë një pohim i fjalëve që rrjedhin poshtë gjuhëve. Si të tilla, ato mbështesin lidhjen e ngushtë mes fjalës dhe veprimeve tona dhe besimit e konfidencialitetit tonë të plotë në atë që e themi dhe e këndojmë. Pavarësisht se si i interpretojmë pozitat trupore të namazit, ato megjithatë harmonizohen me fjalët që shprehim dhe kjo harmoni pasqyron dëshirën tonë për t’u afruar tek Ai të Cilit ia adresohemi.

I denjë për theksim në namaz është edhe angazhimi i adhuruesve për t’u kthyer kah kibla dhe për t’i mbajtur sytë në vendin ku balli puthë dyshemenë gjatë sexhdes; edhe këmbëngulja e tyre strikte për të mos shikuar as në të djathtë e as në të majtë, ose përmbajtja nga të shikuarit këdo që u flet gjatë namazit për çfarëdo arsye dhe të trajtuarit hapësirën midis tyre dhe kibles si

“hapësirë e shenjtë” përmes së cilës askush nuk lejohet të kalojë. Të gjitha këto praktika i vënë të tjerët përballë vërejtjes se kur falet, muslimani hyn në një gjendje të posaçme të “ndarjes e veçimit”, në të cilën nuk duhet lejuar që shqetësimet e kësaj bote të ndërhyjnë assesi.



## KAPITULLI 9

# Thirrja për namaz dhe dhjetë mrekullitë e saj

*Allahu Ekber, Allahu Ekber! Allahu Ekber, Allahu Ekber!  
Esh-hedu en la ilahe ila-Allah! Esh-hedu en la ilahe ila-Allah!  
Esh-hedu enne Muhammeden resul Allah! Esh-hedu enne Muhum-  
meden resul Allah!  
Haja el zekah, haja el zekah!  
Allahu është më i madh! Allahu është më i madh! Allahu është më  
i madh! Allahu është më i madh!  
Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut.  
Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut!  
Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Dëshmoj se Mu-  
hamedi është i Dërguari i Allahut.  
Ejani në zekat, ejani në zekat!*

E keni dëgjuar ndonjëherë një thirrje si kjo? As unë! Epo, e sajova në përpjekje për ta lëkundur veten time dhe juve nga zhurma e shushatja e familjarizimit që na privon nga aftësia për ta dëgjuar e kënduar tekstin e ezanit ose thirrjes për namaz, ashtu siç është

dëgjuar dhe kënduar nga Bilal Ibn Rabahu [radijallahu anhu], muezini i parë i Islamit, herën e parë që e bëri thirrjen për namaz, shumë kohë më parë.

Si ezani ashtu edhe ikameti ose njoftimi që namazi në kongregacion është gati të fillojë, i kanë vuajtur ndikimet e mbi-familjaritetit, zakonit dhe tendencës për të na grabitur nga vlera e thesareve shpirtërore që i disponojmë. Megjithatë, përmbajtja dhe formulimi i këtyre dy këndimeve si dhe roli unik i luajtur nga secila, mbartin mrekulli mahnitëse. Në atë që pason, do të përpiqem t'i identifikoj dhjetë prej këtyre mrekullive, nuk ka dyshim se janë edhe shumë të tjera që unë, me kapacitetet e mia njerëzore të kufizuara, ende nuk i kam zbuluar.

*E PARA:* Keni vrarë mendjen pse nga të pesë shtyllat e Islamit, vetëm namazi paraprihet nga një “njoftim” i veçantë? Ezani është një ftesë publike për t'u angazhuar në këtë shtyllë jetësore të fesë sonë. Pra, pse nuk lëshojmë një thirrje të ngjashme publike për fillimin e agjërimit të Ramazanit? Dhe përse shpallim përmes ikametit se jemi gati të fillojmë namazin e përbashkët me xhemat, ndërsa nuk lëshojmë asnjë të tillë përpara fillimit të agjërimit të muajit të Ramazanit ose shpërndarjes së zekatit, si ezani imagjinar i cituar më lart?

Na mungon aftësia që, përmes depërtimit e mendjemprehtësisë njerëzore, ta kuptojmë urtësinë hyjnore që e veçon namazin për këto dy “hyrje”: ezanin dhe ikametin. Megjithatë, mund ta dallojmë rëndësinë semantike të ezanit, i cili i kujton muslimanët - dhe sa lehtë harrohet - se obligimi për ta falur namazin nuk është çështje private, individuale, që e kryejmë të vetëm dhe në mënyrë të pavarur nga të tjerët. Përkundrazi, është, para së gjithash, një veprim shoqëror dhe i përbashkët. Ezani është një pohim i natyrës shoqërore të namazit dhe një ftesë për anëtarët e komunitetit që të tubohen dhe të falen së bashku, në të njëjtën kohë, në të njëjtin vend dhe pas një udhëheqësi të vetëm namazi. Ezani shërben për të theksuar se roli i namazit nuk është i kufizuar në marrëdhënien

midis individit dhe Zotit të tij, por përfshin aktin e takimit me të tjerët, afrimin me të tjerët, bashkëpunimin me ta, qëndrimin (në kuptimin e mirëfilltë) supe-më-supe me ta dhe nxitjes së mirëkuptimit dhe dashurisë së ndërsjellë midis robit individual të Zotit dhe pjesëtarëve të tjerë të komunitetit besimtar të Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Kjo është arsyeja pse namazet vullnetare, të cilat zakonisht falen individualisht, nuk duhet të paraprihen nga ezani ose ikameti.

Kjo, pra, është një nga aspektet e shumta kulturore të namazit për të cilat do të flasim më hollësisht në vijim në seksionin e titulluar: “Namazi me xhemat: Çelësi drejt përparimit dhe qytetërimit.”

*E DYTA:* Historia se si ezani dhe ikameti erdhën në ekzistencë ka një aspekt të mrekullueshëm sakaq mund të thuhet se i ngre ato pothuajse në statusin e vetë zbulësës hyjnore. Përmbajtja e tyre verbale që komunikuar përmes ëndrrave, jo nga vetë Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], por nga dy shokët e tij. Të dy burrat panë të njëjtën ëndërr, në të njëjtën natë, duke përfshirë saktësisht të njëjtat fjalë dhe detaje. Megjithatë, ende më e rëndësishme dhe më emocionuese është fakti se një nga dy shokët e përfshirë ishte vetë Omer ibn el-Hatabi [radijallahu anhu], i dyti nga katër kalifët me udhëzim të drejtë.

Mënyra e veçantë në të cilën ezani që “lindur” përputhet me mënyrën në të cilën vetë namazi u foshnjëzua, e fundit prej të cilave e sjellë edhe më lehtësisht veçantinë e ezanit dhe mënyrën se si ai erdhi tek ne. Me përjashtim të namazit, përmbajtja e gjithë Kur’anit u kumtua nëpërmjet frymëzimit hyjnor. Në rastin e namazit, i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mori një ftesë të mbinatyrshme në Mbretërinë Qiellore për ta pranuar këtë rit me të gjitha detajet e tij nga Vetë Zoti i botëve, i Cili, siç e kemi theksuar, e dorëzoi ezanin tek Profeti i Tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përmes ëndrrës që iu dha në të njëjtën kohë dy nga shokëve të tij besnikë.

*E TRETA:* Në strukturë dhe kuptim, ezani, në thelb, është një namaz i shkurtër hyrës që e përgatitë besimtarin për namazin më



të gjatë që pason. E dimë nga shembulli i caktuar prej Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] që njeriu duhet t'ia këndojë ezanin në vesh të porsalindurit sikur ta përgatiste atë për një jetë të tërë namazi. Është sikur ezani t'i thoshte fëmijës: “Tani që ke hyrë në këtë botë, përgatitu për të filluar një jetë namazi, adhurimi dhe edukimi në një bashkësi shpirtërore me Zotin, e cila do të vazhdojë përtej ekzistencës sate në këtë botë. Në fakt, kur të ikësh nga kjo botë, do të nisesh në një udhëtim tjetër, udhëtim pa fund drejt Zotit, udhëtim që ndryshon nga qëndrimi yt i shkurtër në Tokë.”

Kur’ani na tregon se detajet e jetës sonë tokësore nuk janë asgjë tjetër veçse një akt adhurimi që marrin forma të ndryshme. Allahu i Plotfuqishëm deklaroi: “Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Edh-Dhariyat: 56) Kur studioni dhe mësoni, jeni në namaz. Kur punoni për ta mbajtur veten dhe familjen, prapë jeni në namaz. Kur i shërbeni shoqërisë dhe individëve të tjerë, jeni në namaz. Kur hani për të mbijetuar dhe për ta ruajtur forcën, jeni në namaz. Edhe kur kujdeseni për shëndetin, jeni në namaz. Jeta jonë e tërë nga A në Zh, në thelb, është një mjet për të adhuruar dhe falur namaz.

Vështroi me kujdes frazat e ezanit dhe do të gjeni se ai është thjesht një namaz i shkurtuar që përgatit rrugën për një akt më të detajuar të adhurimit.

*E KATËRTA:* Supozoni se kurrë nuk keni dëgjuar për ezanin ose fjalët që përfshin ai. Imagjinoni sikur po e dëgjoni frazën *Allahu Ekber* (Allahu është më i madh) për herë të parë edhe pse në realitet, është më e vjetër se vetë ezani (shprehja kishte qenë e njohur për muslimanët që nga pranimi i namazit nga Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pas *Lejlet el-Miraxhit* ose udhëtimit të tij të Natës në sferën qiellore). Reflektoni mbi kuptimin dhe formën e tij unike gjuhësore. Gramatikisht, është një deklaratë jo e plotë që, varësisht nga imagjinata dhe/ose rrethanat, mund të përfundojë në mënyra të ndryshme të mundshme: Allahu është më i madh... se sfera

tokësore që më largon nga Ai. Allahu është më i madh... se pasuritë e mia materiale. Allahu është më i madh... se shqetësimet që ma trazojnë e turbullojnë paqen e mendjes. Allahu është më i madh... se armiku me të cilin ballafaqohem. Allahu është më i madh... se përndjekësit dhe tiranët që më përndjekin.

Fraza *Allahu Ekber* (Allahu është më i madh) përmbledh tërë thirrjen për namaz. Është pika fokusale e thirrjes së jashtëzakonshme që e veçon Islamin midis feve të botës. Në fakt, ajo përmbledh vetë Islamin. Ne jemi “muslimanë” sepse e kemi deklaruar nënshtrimin tonë (istislam) ndaj një Qenie më të madhe se ne, Qenie që është më e madhe se gjithçka tjetër. I jemi nënshtruar, i jemi dorëzuar kësaj Qenie. Prandaj, fjala *Allahu Ekber* me të drejtë mund të quhet parullë që përmbledh gjithçka që është Islami.

*E PESTA:* Thirrja islame për namaz, e shkurtër ashtu siç është, ka një stil unik gjuhësor që ishte risi si për arabët e kohës së Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ashtu edhe për komunitetet dhe kombet e tjera. Stili i saj ishte shekuj përpara kohës së saj. Vini re, për shembull, se ajo përbëhet nga një seri e shkurtër deklarimesh që nuk mbahen së bashku nga asnjë prej pjesoreve që përdoren përgjithësisht në mes të një fraze dhe një tjetre, të tilla si “dhe”, “kështu”, dhe të ngjashme. Ajo ta kujton stilin që synojmë ta përdorim në mesazhet tekstuale që shkëmbejmë ditëve të sotme në telefonat tanë celularë. Me frazat e tij të ngushta dhe të drejtpërdrejta, ezani përmbledh për muslimanët e ditës së Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], frymën e mesazhit të ri, për hir të të cilit ata i kishin braktisur idhujt, doktrinën dhe mënyrat e tyre injorante të mëparshme.

*E GJASHTA:* Më i mrekullueshëm ende, është fakti që me stilin e tij gjuhësor të shpejtë, ky namaz i përpiktë korrespondon me gjuhën e pjesës më të rëndësishme të namazit, domethënë *Fatihën* ose hapësen e Kur’anit. Ashtu si ezani, edhe *Fatiha* është e lirë nga lidhjet e ndryshme gjuhësore që si arabët ashtu edhe të tjerët, janë mësuar t’i shohin dhe t’i përdorin. Sikur *Fatiha* të

ishite shkruar në një stil më të ngjashëm me fjalimin e përditshëm njerëzor, dysjoj se do të tingëllonte diçka si kjo (me shtesat e mia në kllapa katrore):

Falënderimi i takon Allahut, [i Cili është] Zot i botëve [dhe i Cili është gjithashtu], Mëshiruesi, Mëshirëbërësi. Sunduesi i Ditës së Gjykimit. [Prandaj, o Zot, pohojmë se] Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë [në të gjitha çështjet e jetës sonë. Prandaj, të drejtohem i Ty, duke të kërkuar dhe lutur që të na] udhëzosh (në) rrugën e drejtë....

*E SHTATA:* Duke marrë parasysh pozitën që ezani zë në adhurimin islam, disa protokolle dhe rregulla etikore ndërlidhen me të. Në përputhje me shembullin e përcaktuar nga Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duhet t'u përgjigjemi fjalëve të ezanit me fraza specifike. Keni dëgjuar ndonjëherë për sistemet kompjuterike interaktive dhe pajisjet e sistemet e tjera të shquara të bazuara në të njëjtin koncept? Marrëdhënia jonë me thirrjen islame të namazit, siç u tregua nga Profeti ynë i dashur [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], katërmbëdhjetë shekuj më parë, është një marrëdhënie interaktive midis *muezinit* dhe dëgjuesve të tij. Për çdo frazë të shprehur nga *muezini*, ekziston një frazë përkatëse që dëgjuesit e tij duhet ta "jehojnë" me disa fjalë përgjigjeje.

*E TETA:* Element i korrespondencës gjuhësore mes namazit dhe ezanit është vetë struktura dualiste ku secila prej frazave të saj komponentore përsëritet nga dy herë. Ky dualitet afirmon karakterin autonom të gjuhës së ezanit, ndërsa në të njëjtën kohë afirmon harmoninë e tij me strukturën e përgjithshme të namazit.

Numri dy nuk është një numër gjerësisht i pranishëm në ritet islame të adhurimit, këndimet dhe lutjet e ndryshme. Shifrat më të zakonshme janë: tri, shtatë, dhjetë, njëzet e një, tridhjetë e tre, nëntëdhjetë e nëntë dhe njëqind. Megjithatë, frazat të cilat përfshihen në ezan përsëriten nga dy herë, një fenomen që i përgjigjet strukturës duale të namazit, sikur kur ngremë duart kur shqiptojmë ha-

pjen *Allahu Ekber* (të njohur si *tekbirat el-ihram*), kur adoptojmë një pozicion të ulur pas çdo dy ciklesh ose rekatesh, kur bëjmë dy sexhde si pjesë e çdo cikli të namazit dhe kur e përfundojnë namazin me dy përsëritjet e paqes, Engjëllin në të djathtën tonë dhe tjetrin në të majtën tonë. Këto karakteristika të namazit më tej konfirmojnë ndjenjën se, derisa e përsërisim ezanin, në fakt po e këndojmë një namaz të shkurtër.

*E NËNTA*: Mund ta keni vërejtur se fjalët e ezanit janë neutrale në aspektin e vetës, numrit dhe gjinisë, në sensin se nuk përfshijnë përdorimin e vetës së parë (unë/ne), vetës së dytë (ti/ju) ose vetës së tretë (ai/ajo / ata/ato). Përjashtimet e vetme për këtë model janë dy “dëshmitë”, të cilat theksojnë përgjegjësinë personale dhe rëndësinë e afirmimit të kësaj përgjegjësie nga ana e folësit në fjalët: “(Unë) Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. (Unë) Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.” Edhe urdhri i përkthyer si “Ejani...” (*hajja*) në frazat: “Ejani në namaz, ejani në namaz! Ejani në shpëtim, ejani në shpëtim!” nuk përmban asgjë për ta markuar atë si njëjës ose shumës, mashkullor ose femëror dhe, për rrjedhojë, është i lirë nga kufizimet që tentojnë të futen në gjithçka që themi dhe shkruajmë. Ky stil gjuhësor i veçantë ndodh shumë rrallë, duke qenë i lidhur kryesisht me gloriifikimin (*tesbihun*), lutjet e përkujtimit hyjnor (*dhikret*) dhe lutjet mbi të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] (*salavatet*). Sidoqoftë, e gjithë gjysma e parë e *Fatijas*, shtylla kurrizore e namazit, markohet nga ky stil i njëjtë neutral, i përdorur rrallëherë.

*E DHJETA*: Mund të ketë nga ata që e shohin tingullin e thirrjes për namaz si një praktikë marginale, e cila nuk e meriton vëmendjen që i jepet përgjithësisht namazit. Personat e tillë ka të ngjarë ta mendojnë ezanin si të parëndësishëm, dhe rrjedhimisht, neglizhojnë ta shqiptojnë atë përpara se të falen. Megjithatë, i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili ishte një bartës besnik i mesazhit që kishte marrë nga lart dhe i cili, sipas Fjalëve të Zotit të tij, ishte “i mëshirshëm për besimtarët” (Et-Teube: 128), thoshte

ndryshe. Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] deklaroi: “Nëse një grup i përbërë prej tre adhuruesve e neglizhojnë thirrjen e ezanit ose ikametit (kur falin namaz), Shejtani do ta marrë më të mirën prej tyre.”<sup>13</sup> Po kështu, Abdullah bin Abdul-Rahman ibn Ebi Sa’s’ah transmeton nën autoritetin e babait të tij se Ebu Se’id Hudriu i kishte thënë njëherë: “Shoh se i do delet dhe dhitë, dhe dëshiron të vardisesh nëpër shkretëtirë. Kur kujdesesh për delet dhe dhitë, je në namaz. Prandaj, ngre zërin dhe thirr ezanin [për namaz]. Pasi çfarëdo xhini, qenie njerëzore ose krijese tjetër që e dëgjon zërin e muezinit në thirrje për namaz, do të dëshmojë në favorin e muezinit në Ditën e Ringjalljes.” (Shënon Buhariu)

Pra, dikush mund të pyesë: Sikur ezani të mos ishte gjë tjetër veçse një mjet për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve, atëherë ç’rëndësi ka që të dëgjohet nga delet, dhitë, shkretëtira dhe sendet e pajetë? A thua si e merr Shejtani më të mirën nga ata, në mesin e të cilëve nuk këndohet ezani? Megjithëse nuk mund ta dimë saktësisht se si ndodh kjo, këto deklarata nga Profeti ynë i hijshëm [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] hedhin dritë mbi vlerën e ezanit dhe ikametit, dhe rolin që luajnë ato në të ushqyerit e një shpirti adhurues në jetën e besimtarit. Pra, bëni çmos e mos lejoni që këto shprehje të adhurimit të shpëtojnë nga mbërthimi juaj.

Po të pyetesh: “Sa lloje të namazit ekzistojnë?” Do të përgjigjesha: “I heshtur, i zëshëm dhe publik (nga ky i fundit i referohem ezanit).” Secila prej këtyre tri llojeve të namazit ka një rol të ndryshëm për të luajtur, dhe secili prej këtyre roleve është po aq i rëndësishëm në plotësimin e të tjerëve për të na ndihmuar në menaxhimin e jetës dhe për ta korrigjuar veten kur gabojmë.

Ezani mund të përshkruhet si një projekt i shkurtuar për investim, i cili na përgatit për projektin më të madh të investimit përfundimtar: atë të namazit.

---

13 Transmeton Ahmedin nën autoritetin e Ebu Derdasë.



## KAPITULLI 10

# Dy larjet rituale

*Po të mos urreja të imponoj një barrë mbi popullin tim, do t'i udhëzoja ata që me marrjen e çdo abdesi (pastrimi ritual) para çdo namazi, t'i pastronin dhe lustronin dhëmbët përmes një shkopi të vogël (misvakut).<sup>14</sup>*

U ndala në këtë thënie të Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe nisa të vras mendjen: Përse “para çdo namazi”? Për sa kohë që e mbaj pastërtinë rituale, e cila është vetë zemra e shembullit profetik, përse ai do që unë të marr abdes përsëri? Le të supozojmë se mora përsëri, edhe pse tashmë isha i pastër, a nuk do të ishte ky shpenzim i ujit të çmuar? Dhe duket veçanërisht e çuditshme që një nxitje e tillë del nga zemra e shkretëtirës e jo nga vendi i liqejve dhe ujëvarave të mëdha!

I kam lexuar shkrimet e shenjta hebraike, shkrimet e shenjta të krishtera, shkrimet e shenjta islame dhe shumë prej koleksioneve të hadithit. Nëpërmjet këtij leximi, kam parë se as hebraizmi e as krishterimi nuk i lidhin doktrinën, ritet e adhurimit dhe kulturën e

---

14 Transmeton Ahmedin nën autoritetin e Ebu Hurejres. E saktësoi Albani.

përgjithshme me pastërtinë rituale, larjen dhe abdesin, ashtu siç bën Islami. As nuk kam lexuar ndonjëherë për një Profet që e udhëzoi komunitetin e tij në mirëmbajtje të higjienës dhe kultivim të pamje-këndshmërisë siç bëri Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Sidoqoftë, praktikat e bashkësisë muslimane sot janë shumë larg nga ajo që Profeti i tyre [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i ka këshilluar.

Theksi i Islamit për përsëritjen e abdesit nuk është thjesht për faktin se pastërtia është shenjë e shëndetit dhe e qytetërimit të përparuar, dhe si rrjedhojë është një qëllim i qartë i ligjit islam. Kjo është edhe për faktin se, ilustruar këtu në abdesin ritual, higjiena e mirë lidhet me pastërtinë e brendshme. Pastërtia e trupit dhe veshmbathja janë një produkt i natyrshëm i pastërtisë së brendshme, e cila pasqyrohet automatikisht në sjelljen e jashtme. Prandaj, disa shkolla juridike islame përfshijnë përgojimin, për shembull, në mesin e veprimeve që e zhvleftësojnë abdesin.

Me këtë logjikë mund të thuhet se ekzistojnë dy lloje të abdesit ritual, i brendshëm dhe i jashtëm, me të brendshmin që është më i rëndësishëm se i jashtëm. Në fakt, pastrimet e jashtme do të jenë të padobishme për dikë që nuk ka pastërti të brendshme. Në fund të fundit, ç'të mirë do t'i bënte dikujt të zhytet në një gropë të jashtëqitjes marrja e abdesit? Ndërsa lani gjymtyrët tuaja të jashtme, duhet të siguroheni se keni bërë gjithçka që duhet për të pastruar qenien tuaj të brendshme. Pastrimi i brendshëm nuk kryhet me ujë, rërë ose ndonjë substancë tjetër materiale. Përkundrazi, kjo ndodh kur çlirohemi nga brenda, si nga: urrejtja, zilia, zemërimi, shpifja, egoizmi dhe egotizmi, mashtrimi, dinakëria, mosmirënjohja, keqtrajtimi, ligësia e gjuhës, mospërfillja, mosbindja, mosbesimi ose hipokrizia.

Pastrojeni qëllimin nga të gjitha papastërtitë e tilla, madje qoftë edhe gradualisht. Në këtë mënyrë, do të jeni në gjendje t'ia dorëzoni zemrën, mendjen, shpirtin dhe fjalët Allahut të Plotfuqishëm. Për më tepër, kur të qëndroni në praninë e Tij në Ditën

e Gjykimit (dhe nuk do të zgjasë shumë ardhja e saj), fjalët tua do të gjejnë pranimin tek Ai; Ai do t'i dëgjojë lutjet tuaja të qeta dhe do t'ua falë mëkatet.

Njëherë vajti njëri tek Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe i tha: “Filani falet natën, ndërsa në mëngjes del e vjedhë.” Ndaj kësaj, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] reagoi: “*Ajo që thua ti [domethënë, fakti se ai është falur] duhet ta ndalojë atë nga vjedhja.*”<sup>15</sup>

Njëherë tjetër Profeti i mëshirës [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i pyeti të pranishmit: “*E dini se kush është i falimentuar?*” Ndaj kësaj, ata u përgjigjën: “I falimentuar është ai që s’ka qindarkë e pasuri.” Por, Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua ktheu:

*Përkundrazi, i falimentuar brenda komunitetit (musliman) është ai që, në Ditën e Ringjalljes, paraqitet para Zotit me namaze, agjërimi dhe lëmoshë, por që ka mallkuar, fyer dhe abuzuar fizikisht të tjerët, ka vjedhur pasurinë e tjerëve dhe ka derdhur gjak pa kauzë të mirë. Si rezultat, veprat e tij të mira do të shpërndahen midis njerëzve të cilët i ka dëmtuar në këtë jetë tokësore. Pastaj, nëse veprat e tij të mira mbarojnë para se veprat e tij të këqija të kompensohen, mëkatet e të shtypurve do të merren dhe do të vendosen mbi të dhe ai do të hidhet në Zjarr.*<sup>16</sup>

Sa muslimanë kanë “falimentuar” në kuptimin për të cilin paralajmëroi Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]? Sa prej nesh kanë lejuar që adhurimi të shkëputet nga praktika jonë e përditshme? Mund ta shohim dikë që bën ruku e sexhde, me ballë të shenjësuar nga e errëta dhe e ngrysur që pasqyron shpeshhtësinë e puthjes së ballit me tokën, ndërsa të gjejmë se në marrëdhëniet me ne nuk ka asnjë gjurmë mëshire, konsiderate ose mirësie. Kur’ani na tregon se:

*Vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat.* (El-Ankebut: 45)

15 Transmeton Ebu Hurejre në *Mishkat el-Masabih*. E saktësoi Albani.

16 Transmeton Muslimi në autoritetin e Ebu Hurejres.



Fenomeni i shkëputjes së adhurimit nga praktika e përditshme përbën një rrezik serioz për imazhin që muslimanët i projektojnë botës së besimit të tyre islam. Asnjë ndarje e tillë nuk ishte lejuar nga vetë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili ua mësoi njerëzve përmbajtjen e Kur'anit dhe zbatimin e tij hap pas hapi.

Ubej Abdul-Rahman el-Sulami transmeton nën autoritetin e Uthmanit, Ibn Mes'udit dhe Ubej Ibn Kabit se i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua këndonte dhjetë ajete kur'ano-re, dhe para se ata të vazhdonin në dhjetë ajetet vijuese, i mëson-te se si t'i zbatonin praktikisht ato që sapo i kishin mësuar. Prandaj, ata i nxinin mësimet e Kur'anit dhe i zbatonin ato në të njëjtën kohë.<sup>17</sup>

Duhet t'i rizbulojmë ritet tona të adhurimit. Duhet ta rizbulojmë namazin. Dhe sa herë që gjejmë një familjarizim vdekje-prurës i cili i zbeh ndjenjat tona ndaj madhësisë së kësaj shprehje unike islame të nderimit, duhet ta rizbulojmë abdesin ritual. Provoni të merrni abdes sikur sapo keni mësuar për të dhe sikur ta keni përjetuar për herë të parë. Pastaj pyesni veten: Çfarë zbulova nëpërmjet këtij eksperimenti? Nëse e shqyrtoni me kujdes, do të gjeni se sikurse namazi, ashtu edhe abdesi mishëron një mënyrë të tërë të jetës.

Së pari, ai sinjalizon një theks në pastërtinë dhe rregullsinë, të cilat janë shenja të kulturës, edukimit dhe qytetërimit. Së dyti, pasqyron kujdesin, maturinë dhe këmbënguljen, cilësi këto që përcaktojnë të suksesshmin nga i pasuksesshmi. Së treti, së katërti, së pesti, dhe... së dhjeti, ai reflekton pikat e pastërtisë në një proces këmbëngulës, i qëndrueshëm dhe vetë-shqyrtues, dhe dëshirën për t'u çliruar nga çdo papastërti që mund ta keni fituar që nga rituali juaj i fundit. Gjithashtu, ai e dallon besimtarin nga jobesimtari, të sinqertin nga i pasinqerti, të penduarin nga ai që ende endet në lajthitje. Madje mund të jemi në gjendje

---

17 *Tefsir El-Kurtubi*, vëll. 1, f. 39.

t'i dallojmë ata që kanë marrë abdes nga ata që nuk e kanë marrë thjesht duke shikuar në fytyrat e tyre.

Riti i tejemumit ose pastrimit me rërë mund të përngjasojë me komunikimin “pa tel” (lexo: pa ujë) për zemrën që thotë: “Përgatitu për ta takuar Zotin dhe çlirohu nga çdo gjë që mund ta prishë takimin tënd të afërt me Të.” Në fund të fundit, si Sovran i Gjithëdijshëm, Allahu është hollësisht i informuar për të gjitha sekretet tuaja, njësoj si për ato që i fshihni dhe ato që i sheshëzoni. Sa për abdesin e zakonshëm, ai është një mesazh “ujor” që komunikon të njëjtat mesazhe për zemrën, vetëm në një mënyrë të ndryshme.

Fjala arabe “*vudu*”, e përkthyer si “abdesi ritual”, rrjedh nga rrënja e njëjtë si fjala për “dritën” (*dija*) pasi ajo iluminon si fytyrën ashtu edhe zemrën. Në fund të fundit, drita që rrezatohet nga fytyra është thjesht një reflektim i dritës që vjen nga zemra dhe shpirti.

Përpikuni gjithmonë të jeni në një gjendje të pastër rituale. Nëse po, do të ndiheni, derisa ecni për në vendin e punës, sikur të jeni duke lundruar në ajër. Kur i përshëndetni të tjerët, do të ndiheni sikur po i shtrëngoni duart me Engjëjt. Ndërsa i kryeni detyrat e përditshme, do të ndiheni të sigurt për suksesin. Dhe ndërsa vendosni kokën në jastëk, do të bekoheni me një ndjenjë të përmbushjes së përgjegjësive për ditën, në më të mirën e aftësisë tuaj; do të ndiheni se më në fund jeni vendosur në Duart e më të Besueshmit, më Bujarit, më Falësit, më të Mëshirshmit.



## KAPITULLI 11

# Namazi i përbashkët (me xhemat): Çelësi drejt përparimit dhe qytetërimit

Keni provuar ndonjëherë ta përkufizoni nocionin “qytetërim”? I referohet ai fabrikave, kompjuterëve, raketave, flotave detare dhe ajrore, anijeve kozmike dhe bombave atomike? Të gjitha këto janë fryte të qytetërimit. Por, sa i përket vetë qytetërimit, burimi i këtyre fryteve, mund të thuhet se rritet nga dhjetë fazat e mëposhtme: (1) pastërtia, (2) saktësia dhe zotërimi, (3) përpikëria, (4) organizimin dhe vetë-disiplina, (5) ndershmëria dhe integriteti, (6) puna në grup, (7) toleranca, përlësia dhe pranimi i të tjerëve, (8) specializimi dhe përgjegjësia individuale, (9) durimi, ambicia dhe vendosmëria, dhe (10) drejtësia dhe barazia.

E keni pyetur veten ndonjëherë, siç e kam pyetur unë, përse namazi me xhemat është i nevojshëm? Përse na kërkohet që të dalim nga shtëpitë, zyrat, bizneset ose fabrikat pesë herë në ditë në një orë të caktuar, në mënyrë të caktuar, ku në të vërtetë, nëse vonohemi vetëm për pesë minuta, do ta kemi humbur adhurimin? E keni pyetur ndonjëherë veten, ashtu siç e kam pyetur unë, përse të dukemi bukur kur shkojmë në xhami? Përse të pastrohemi

ritualisht apriori? Dhe përse abdesi ritual? Është kjo thjesht në respekt ndaj shtëpisë së Zotit apo pa të nuk do të jemi të përgatitur siç duhet për të qëndruar në praninë e Zotit? Apo, alternativisht, ka të bëjë me funksionet kulturore që kryhen nga pastërtia, higjiena e mirë, zbukurimi dhe rregullimi personal si shprehje e respektit dhe korrektësisë, funksione që kanë plotësuesit e tyre në domenin fetar apo shpirtëror?

Në kontekstin e përpikërisë, gjejmë se namazi i përbashkët shërben si shkolla më e mirë në të cilën muslimani mund të diplomojë si bartës i pishtarit plotësisht të kualifikuar të qytetërimin. Siç thashë më parë, vonimi madje për pesë minuta në namazin me xhemat nënkupton humbjen dhe huqjen e pretendimit për shpërblimin që do ta kishim marrë për faljen e namazit në kohë. Kjo rrethanë, e cila përsëritet pesë herë në ditë në jetën e muslimanit, ia mëson atij vlerën e kohës dhe rëndësinë e të qenit i përpiktë në angazhimet e tij me të tjerët.

Në një moshë më të re, zhvillova një bisedë të drejtpërdrejtë me Shejh Albanin, ku në fakt unë mbroja idenë e lejimit të më shumë se një sesioni namazfaljeje të përbashkët me xhemat në një xhami të vetme. Përse, e pyeta, a nuk është e lejueshme për adhuruesit që janë vonë për sesionin e parë të një grupi namazfalësh, që të zgjedhin një udhëheqës namazi nga mesi i tyre dhe ta falin së bashku namazin e caktuar në një sesion të dytë? Dhe pse jo, pas kësaj, të lejohet një grup i tretë ose i katërt ta veprojnë të njëjtën gjë?

Shejh Albani ishte i vendosur e kategorik në refuzimin e propozimit tim. Për fat të keq, nuk mori edhe shumë kohë derisa e kuptova mençurinë dhe urtësinë e pozicionit të qëndrimit këmbëngulës të tij. Lejimi i grupeve të shumta e të ndryshme për të vazhduar me sesione të ndara namazfaljeje me xhemat në të njëjtin xhami, thjesht jep ndjeshmëri të lirë për ndarjet brenda kongregacionit; një shumëllojshmëri të drejtimeve, shumëllojshmëri të fraksioneve dhe ndarje, tjetërsim dhe fraksionizim jashtë xhamisë. Përkundrazi,

angazhimi për t'u falur me një grup të vetëm ose kongregacion siguron trajnim të përditshëm, të vazhdueshëm në përpikëri, respektim të kohës së caktuar të takimit, unitetit, solidaritetit dhe kohezionit në grup.

Sa i përket pastërtisë rituale, higjienës së duhur dhe mirëmbajtjes së dukshme, ku të gjitha na përgatisin për të hyrë në xhami dhe për të qëndruar në praninë e Allahut, ato janë të njëjtat gjëra që na përgatisin për kalimin nga errësira e injorancës, p.sh. “papistërisë” pakuptimisë, prapambetjes, apatisë dhe neglizhimit – në anëtarësim në “klubin” e qytetërimit, i cili ia mbyll dyert atyre që nuk i plotësojnë kushtet në aspektin e pastërtisë, modestisë dhe atraktivitetit, pamjes së duhur, jo vetëm në nivelin e higjienës personale dhe veshmbathjes në xhami, por edhe në shtëpi, zyrë, shkollë dhe spital.

Ishte Islami që për herë të parë prezantoi fjalën arabe për xhaminë, “*mesxhid*”, që do të thotë “vend i sexhdes”. Përshtatshmërisht, termi xhami është një reminishencë e pozitës në të cilën jemi më afër me Zotin tonë, d.m.th. qëndrim në sexhde, në të cilin koka, balli dhe hunda puthin dyshtemenë ose tokën. Një qëndrim i tillë shpreh shkallën më të thellë e përlësisë dhe thyerjes. Prandaj, sa më shumë që përqendrohemi para Allahut me qenien tonë fizike, aq më afër Tij jemi të tërhequr dhe aq më i lartë është stacioni jonë në praninë e Tij në jetën e Përtejme.

Kur besimtarët dalin me nderim para pranisë së Krijuesit çdo çast dite dhe nate dhe angazhohen në një trajnim përlësie, duke mos qenë “*mendjemëdhenj në adhurim ndaj Tij*” (El-A'raf: 206), siç thotë Zoti i Plotfuqishëm për ta dhe Engjëjt e Tij, përlësia bëhet pjesë e natyrës qenësore, sakaq nuk ngelet vend në jetën e tyre për arrogancë e mosmarrëveshje minore. Përkundrazi, ata bëhen “*të përlulur ndaj besimtarëve*” (El-Maide: 54) në përputhje me urdhrin e Zotit për të Dërguarin e Tij të besueshëm [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] që të “*jetë i butë dhe i përlulur ndaj besimtarëve*” (El-Hixhr: 88) Kur sillemi në këtë mënyrë, atëherë

e kemi ndërmarrë hapin tonë të parë drejt hyrjes në fushën e njohur si “qytetërim”.

Kur hyjmë në xhami, kujtojmë se po hyjmë në shkollën e sexhdes, përlësisë, zemërbutësisë, thyerjes dhe mirësisë ndaj bashkëbesimtarëve. Një emër tjetër arab, po aq i zakonshëm, për xhaminë është “*xhami*” ose “vendi i tubimit”. Kujtojmë kur hyjmë në të se ky është vendi që na bashkon, na bën të barabartë, na unifikon dhe eliminon urrejtjen dhe hidhërimin nga zemrat dhe mendjet tona. Si rrjedhojë, nuk ka më grindje dhe pakënaqësi dhe nuk ka më dallim midis të rinjve dhe pleqve, midis të varfërve dhe të pasurve, të zakonshmëve dhe mbretërorëve, të shtypurve dhe shtypësve.

*Drejtoni radhët (safat), sepse jeni duke u radhitur si Engjëjt. Qëndroni krah-për-krah dhe plotësoni boshllëqet [mes radhëve]. Merrini butësisht vëllezërit tuaj për t'u siguruar që të mos ngelet asnjë e çarë përmes së cilës Shejtani mund të përvidhet. Nëse afroheni pranë njëri-tjetrit në radhë, Allahu iu afrohet, e nëse largoheni nga njëri-tjetri, Allahu prej jush largohet.<sup>18</sup>*

Sa herë e kemi lexuar këtë porosi nga Profeti i hirshëm [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ose e kemi dëgjuar të cituar në biseda e predikime të *xhumave*? Sa herë na është përsëritur kjo porosi nga *imamët* kur namazi qe gati të fillojë? Megjithatë, sa prej nesh kanë medituuar mbi çdo frazë të saj, për të lexuar mes fjalëve dhe rreshtave? Po ta bënim këtë, do ta kuptonim se ky urdhër është më shumë sesa thjesht një rregull që ka të bëjë me qëndrimin në radhët e drejta. Është një recetë për reformimin e shpirttrave dhe për krijimin e një shoqërie të civilizuar, anëtarët e të cilës janë të gjithë të barabartë dhe në të cilën askush nuk zotëron mbi askënd tjetër.

Kur reflektojmë mbi këtë thënie profetike, pyetja e parë që na vjen ndërmend ka të bëjë me faktin se pse kaq shumë rëndësi

18 Transmetuar nën autoritetin e Abdullah Ibn Amrit. Saktësoi Albani në Sahih el-Xhami.

i jepet drejtimit të radhëve të adhuruesve dhe qëndrimin krahpër-krah me ta. Ç'është kaq e rëndësishme për adhuruesit, të cilët qëndrojnë në radhë të drejtë me krahë e këmbë mjeshtërisht të radhitur? Dhe përgjigjja, thjesht, është: sepse këtu fillon qytetërimi. Kjo është një nga “farat” e një shoqërie të civilizuar.

Jemi të ftuar të marrim pjesë në këtë tubim namazi, meqë qytetërimi nuk është një ndërmarrje individuale, por shoqërore. Ai bazohet në punën grupore dhe në heqjen dorë nga egoizmi dhe uni. Një qytetërim është, para së gjithash, një komunitet.

Së dyti, jemi të ftuar ta mbajmë këtë takim të saktë dhe të veçantë jo vetëm një herë, por pesë herë në ditë me vëllezërit dhe motrat tona. Në këtë mënyrë, shpirti i përkushtimit dhe saktësisë do të fillojë të rrjedhë nëpër venat tona. Kultura, në fund të fundit, bazohet në shtëpi, angazhim dhe respekt për kohën tonë dhe atë të të tjerëve.

Së treti, jemi të nxitur që të formojmë radhë me anëtarët e tjerë të komunitetit, meqë të nënshtruarit ndaj rregullave në këtë kontekst do të përkthehet në nënshtrim e rregullsi më të madhe në jetën tonë të brendshme, në mjeshtëri në punën tonë dhe në unitet në zemrat tona; që të gjitha këto ndihmojnë në ngritjen e një shoqërie të lulëzuar, bashkëpunuese dhe të civilizuar. Qytetërimi lind nga përpjekjet kolektive, integrimi, rendi, mjeshtëria, durimi, përulësia, toleranca, pranimiti i tjetrit dhe solidariteti në nivelet e mjeteve dhe përfundon njësoj.

Për të mos lejuar që ky udhëzim të sabotohet nga dobësitë tona njerëzore, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e lidhi atë drejtpërdrejt me Mbretërinë Qiellore. Është sikur ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] të thoshte: “Mbani mend, të gjithë ju që qëndroni në praninë e Zotit, që radhët tuaja derisa faleni në Tokë, janë modeluar në akord me radhët e Engjëjve në Qiell.” Kur u tha të pranishmëve: “*Jeni radhitur siç radhitën Engjëjt*”, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po tërhiqte një lidhje midis blloqeve të ndërtimit të civilizimit në Tokë dhe asaj që ndodh në Qiell.

Shkurtimisht, ajo që na tregon ky hadith është se adhurimi i shëndoshë është i barabartë me qytetërimin e shëndoshë dhe ashtu siç adhurimi është në Qiell, ashtu duhet të jetë edhe në Tokë.

Përveç kësaj, jemi të thirrur t'i përmbahemi një kushti tjetër, që është "plotësimi i boshllëqeve... duke mos lënë asnjë çarje përmes së cilës Shejtani mund të përvidhet." Në këtë mënyrë, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po tërhiqte vëmendjen ndaj rolit të kredibilitetit dhe përgjegjësisë personale në krijimin e qytetërimit. Me çfarëdo kapaciteti të posaçëm që kemi, secili prej nesh qëndron në një kufi të caktuar të komunitetit tonë. Secili prej nesh ka rolin e vet individual për ta kryer, veprimin e tij individual për ta vepruar dhe aftësitë e tij unike për t'i zbatuar në formësim të qytetërimit. Nëse e braktisim përgjegjësinë tonë për t'i "plotësuar boshllëqet", çfarëdo boshllëqe qofshin ato, ajo do të lërë një "çarje" në muret tona mbrojtëse. Rrjedhimisht, një braktisje e tillë përbën një veprim tradhtie që e lë komunitetin të pambrojtur e të cenueshëm. Me pak fjalë, qytetërimi bazohet në specializim, përgjegjësi individuale dhe përpjekje bashkëpunuese e konstruktive.

Edhe njëherë, Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e lidh këtë mësim tokësor me Qiellin, sikur thotë: "O robër të Allahut: Nëse i bashkoni radhët në namaz në këtë botë, Zoti do t'ju përqafojë në tjetrën, por nëse i thyeni radhët këtu, Ai do t'ju braktisë atje." (*"Kur afroheni me njëri-tjetrin në radhë, Allahu do t'ju afrohet, e në rast se tërhiqeni nga njëri-tjetri, Ai prej jush do të largohet."*) Ç'lidhje më e qartë mund të ekzistojnë midis rrethanave të qytetërimit njerëzor këtu në Tokë dhe asaj që ndodh në fushën e Qiellit? Shkurtimisht, rrethanat për adhurim të shëndoshë janë vetë rrethanat për një shoqëri të shëndoshë dhe solide.

Dhe mbi të gjitha, thirrëmi të heqim dorë nga çdo ashpërsi dhe mizori, dhe t'i trajtojmë vëllezërit dhe motrat me butësi në namaz, në shoqëri dhe në jetë si tërësi. Me fjalë të tjera, kur të tjerët përpiqen t'i plotësojnë boshllëqet në një radhë adhuruesish, duhet t'ua



lehtësojmë procesin duke krijuar vend për këdo që ka nevojë të zhvendoset në këtë ose atë, ashtu që të mbyllim hendekun midis dy radhëve, etj. Një veprim i tillë, në mënyrë të rregullt do t'i formësojë karakteret tona në një mënyrë të atillë saqë nuk do të priremi më drejt ashpërsisë, vrazhdësisë, militantizmit, ekstremizmit ose dhunës në mendimet tona, në disponueshmërinë e çështjeve tona ose në mënyrën se si u përgjigjemi atyre që mbajnë pikëpamje ose doktrina të kundërta. Ky është shembulli që na është përcaktuar nga i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në të gjitha aspektet e jetës së tij. Siç Aishja [radijallahu anhu], Nëna e Besimtarëve, transmeton:

... Ai (i Dërguari i Allahut) [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk goditi as grua e as rob/robëreshë me dorën e tij, asnjëherë. Në fakt, kurrë nuk goditi krijesë me dorën e tij, përveç nëse ishte i angazhuar në luftë në rrugën e Allahut. Sa herë i jepej zgjedhja midis dy kurseve të ndryshme të veprimit, ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] preferonte atë që kërkonte vështirësinë më të vogël – duke u siguruar, natyrisht, që ky veprim të mos përfshinte ndonjë akt mëkatues. Nëse, megjithatë, veprimi i tillë ishte i natyrës mëkatuese, e shmangte atë tërësisht. Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kurrë nuk hakmerrej ndaj askujt për çfarëdo arsye, nëse nuk ishte shkelur ndonjëri nga urdhrat e shenjtë të Allahut, në të cilin rast ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk hakmerrej për veten, por për Allahun.<sup>19</sup>

I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] na nxiti të jemi të përuhur, ndërsa ne, mjerisht, jemi bërë arrogantë. Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] na mësoi të jemi të butë, ndërsa ne jemi bërë mizorë. Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] demonstroi modërim dhe tolerancë, ndërsa ne shfaqim ashpërsi dhe ekstremizëm. Na këshilloi që të jetonim me mirëkuptim të ndërsjellë dhe të afroheshim me njëri-tjetrin, ndërsa në vend të kësaj, ne jemi

19 Transmetuar nën autoritetin e Aishes [radijallahu anha]. E saktësoi Albani në *Silsilet el-Ahadith el-Sahihah*.

grindur dhe larguar nga njëri-tjetri. Ai [sal-lallahu alejhi ve sellem] na mësoi të bashkohemi dhe të unifikohemi në forcë, por ne jemi ndarë dhe dobësuar.

Muslimanët *Suni* dhe *Shija* dallojnë në detaje të shumta të besimit dhe praktikës. Sidoqoftë, asnjëherë përgjatë shekujve, ata nuk janë pajtuar mbi bazat e namazit, numrit të namazeve ditore, lëvizjeve që ato përfshijnë ose kohën kur ato duhet të falen. Dhe arsyeja për këtë qëndron në natyrën e përbashkët (xhematore) të namazit.

Struktura e përbashkët (xhematore) e shumicës së riteve të adhurimit në Islam, i ka mbrojtur muslimanët nga shtrembërimi. Për rrjedhojë, ata nuk kanë dalluar asnjëherë në lidhje me tekstin e Kur'anit, sepse Islami kërkon që ata ta këndojnë atë bashkërisht dhe ta verifikojnë korrektësinë e tij gjatë secilit prej tri namazeve të përditshme, këndimet e të cilave kryhen me zë të lartë (namazin e sabahut, namazin e akshamit dhe namazin e jacisë). Ky proces zhvillohet në çdo xhami, në çdo vend të botës, në çdo fshat, në çdo shtëpi: këndon udhëheqësi i namazit, ndërsa ata që adhurojnë pas tij e përcjellin vëmendshëm dhe, në rast se është e nevojshme, saktësojnë këndimin e prijësit. Muslimanët nuk kanë dalluar në lidhje me formën e namazit sepse është një rit publik që konfirmohet në xhami nga kongregacioni në tërësi, pesë herë në ditë; megjithatë, ata kanë dalluar nga Ai tek i Cili zemrat drejtohen së pari në namaz, meqë vetëm Allahu mund ta vëzhgojë atë që ndodhet në zemrat tona. Në mënyrë të ngjashme, nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje mbi formën ose themelet e haxhit ose pelegrinazhit të madh, pasi, ashtu si namazi, pelegrinazhi është një rit publik që kryhet nën syrin vigjilent të të gjithë bashkësisë muslimane. Megjithatë, ka pasur theksime të ndryshme mes muslimanëve në aspekte të caktuara të haxhit në krahasim me të tjerët.

Po të përpiqeshim t'i identifikonim cilësitë që i karakterizojnë shoqëritë të cilat janë bërë më të civilizuar kundrejt atyre që kanë mbetur prapa, do të gjenim se ato që kanë përparuar drejt

civilizimit janë ato që kanë demonstruar përlësi dhe tolerancë, unitet dhe kohezion; ato që kanë zhvilluar sfera të njohurive dhe ekspertizave të specializuara dhe kanë punuar për ta ndërtuar atdheun e tyre si një ekip i vetëm, me një zemër dhe shpirt, me vendosmëri dhe entuziazëm, ndërkohë ato që kanë ngelur prapa kanë shfaqur arrogancë, krenari, ashpërsi dhe ngurtësi, dhe kanë qenë neglizhente në detyrat e tyre ndaj njëri-tjetrit, secili prej tyre duke shkuar në rrugën e vet ku nëse dy fraksione bashkoheshin, bashkoheshin vetëm për t'u grindur ose për të luftuar. A nuk e përkrahur ky përshkrim i fundit, mjerisht, shumicën e shoqërive muslimane në botë sot?

I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

*Nëse ka tre njerëz në një fshat të caktuar ose në zona rurale që nuk e falin namazin së bashku, Shejtani do ta marrë më të mirën prej tyre. Duhet të sakrifikoni për ta falur namazin komunal, sepse ujku i gllabëron delet që ndahen nga tufa.<sup>20</sup>*

Nëse i kushtojmë vëmendje kësaj thënie të Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe e zbatojmë atë për vetet tona, familjet tona dhe të tjerët rreth nesh, arsyeja për të cilën Profeti i Zoti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e thekson namazin xhemator do të ishte e qartë: Vetëm përmes namazit të përbashkët me xhemat marrim dhe mbajmë forcën dhe kohezionin. Përndryshe, siç delet që largohen nga tufa, ashtu edhe ne do të jemi pre e lehtë për ujqërit, të cilët janë kaq në numër në këtë kohë.

Kur edhe zemrat tona e jo vetëm trupat tanë, të bashkohen në namazin me xhemat, ky unitet do të pasqyrohet në jetën tonë të përditshme dhe në mënyrën tonë të menduarit. Rrjedhimisht, do të fillojmë të veprojmë jo vetëm si individë, por si grup. Preferencat tona do të udhëhiqen jo nga prirjet tona individuale, por nga interesat e grupit. Ajo që pranojmë ose refuzojmë do të përcaktohet jo

---

20 Transmeton Ebu Davudi nën autoritetin e Ebu Derdasë.

nga shijet dhe dëshirat individuale, por nga ato grupore. Do të menjohet së bashku, do të punohet së bashku, do të ndërtojmë së bashku, do të gëzohemi së bashku, do të pikëllohem së bashku. Vetëm në këtë mënyrë, muslimanët ishin në gjendje të zhvendoseshin nga injoranca, prapambetja dhe dekadencia e epokës paraislame në përsosjen morale dhe intelektuale të epokës islamike që pasoi, duke përfshirë zgjerimin territorial dhe unitetin që u arritën nën kalifët e hershëm. Në të vërtetë, Qielli dhe Toka u bashkuan për ta kur ata u bashkuan në namaz nën shpresën e Xhenetit. Siç deklaroi i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]:

*Jini të palëkundur në namazin e përbashkët me xhemat, dhe kujdes e mos u ndani. Shejtani e tërheq prapa vetëm të veçuarin, ndërsa largohet nga dy që janë së bashku. Kushdo që dëshiron të ketë një vendbanim të gjerë dhe të rehatshëm në Xhenet, le të falet në bashkësi.<sup>21</sup>*

Qytetërimi bazohet në praktikën e tubimit të rregullt, integritetit, unitetit, zotësisë dhe saktësisë, modestisë, dhembshurisë, tolerancës, pranimit të tjetrit, afrimit, entuziazmit, përkushtimit, vendosmërisë dhe durimit.

---

21 Transmeton Omer ibn el-Hatabi. E saktësoi Albani në *Zilel el-Xheneh fi Takhrir el-Sunneh*.



## KAPITULLI 12

### Predikimi i *xhumasë*: kurs drejt zhvillimit

Kongregacioni në një xhami të caktuar në Oksford u bë i zhurmshëm pasi *imami* i tyre kishte dhënë predikimin tërësisht në anglisht. "Predikimi nuk është i vlefshëm, sepse nuk ishte në gjuhën arabe!" – kundërshtonin ata. - "I gjithë namazi i *xhumasë* do të jetë i papranueshëm nëse predikimi nuk jepet në arabisht!"

Këtu në Britani, mbase mund të hutohemi dhe të habitemi nga një incident i tillë. Në të njëjtën kohë, nuk mund të rrimë mënjandë, pos të ndiejmë admirim dhe vlerësim për këta vëllezër të cilët, megjithëse nuk flasin arabisht, shfaqin nderim, dashuri dhe respekt për gjuhën që ne, folësit e tij amë, e kemi humbur. Ndjenja nga ana e tyre është aq intensive dhe e përzemërt sa që na bën të turpërohem. Ajo shërben si një thirrje zgjimi duke na zhveshur nga efekti negativ e vdekjeprurës i mbi-familjaritetit në respektin dhe dashurinë për gjuhën tonë amtare, dhe na ndihmon të rilidhemi me emociione të atilla dhe ta rizbulojmë shenjtërinë e gjuhës sonë dhe vendin e veçantë që ajo meriton në jetë.

Kjo është ana e ndritshme e reagimit të lartpërmendur nga vëllezërit joarabë. Megjithatë, ka një tjetër anë të dobët në reagimin

e tyre. Këmbëngulja e tyre që predikimi i *xhumasë* të jepet në arabisht dhe në asnjë gjuhë tjetër, edhe nëse nuk e kuptojnë as edhe një fjalë të vetme nga ajo që thotë *imami*, tregon për një të kuptuar të shtrembëruar dhe joadekuat të rolit që predikimi i së premtes ka për qëllim ta luajë në jetën e muslimanëve. Gjithashtu, thekson ndarjen e rrezikshme që ekziston për disa muslimanë në mes të fesë dhe realitetit të tyre të përditshëm. Qëndrimi i individëve të tillë duket sikur jehon: Përderisa e jep predikimin në gjuhën e Kur'anit dhe Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nuk ka rëndësi se ç'thua ose s'thua. Dhe për aq sa i falim pesë namazet e përditshme që kërkohen prej nesh, është në rregull edhe nëse vjedhim, mashtrojmë, gënjejmë ose kryejmë imoralitet seksual. Mjafton të sigurohemi që të mos konsumojmë mish derri ose ndonjë mish tjetër që nuk lejohet sipas ligjit islam; përndryshe le të mëkatojmë siç të duam!

Imazhi që jomuslimanët kanë formuar për Islamin, veçanërisht në Perëndim, reflekton mendimin dhe praktikën e deformuar të vetë muslimanëve, të cilët shpesh përqendrohen në çështje me rëndësi triviale, duke neglizhuar panoramën kardinale të domosdoshme të fesë së tyre. Vetëm ndaluni e mendoni për padrejtësitë që muslimanët i bëjnë Islamit përmes mungesës së mirëkuptimit!

Këta vëllezër tanë përcaktojnë se predikimi i së premtes nga *imami* i tyre duhet të jetë në gjuhën arabe në vend se, për shembull, të jetë në gjuhën e tyre lokale ose në ndonjë gjuhë tjetër që e kuptojnë. Predikimi mund të përbëhet jo vetëm nga disa vargje kur'anore, nga një sasi e vogël e haditheve dhe nga disa thënie të shkurtra që *imami* është mësuar t'i përsërisë në çdo predikim të tij. Pastaj, adhuruesit largohen nga xhamia praktikisht në të njëjtin gjendje në të cilën kishin ardhur, me asgjë të mësuar, pa kuptim të ri të fituar, pa kuptuar mençuri, pa dobi të akumuluar, pa rindezje të përkujtimit të Allahut, pa sqarim e qartësim të vendimeve ligjore të bazuara në shkrimet fetare dhe pa trajtim të çështjeve të botës moderne. Në këtë mënyrë, ne muslimanët e

vrasim shpirtin e predikimit të së premtes, duke lënë asgjë, përveç skeletit të saj gjuhësor.

E vjedhim këtë mundësi didaktike të rëndësishme javore të kuptimit të saj, duke e shndërruar atë në asgjë më shumë se një ritual verbal të pamend. Ngjashëm, shumë muslimanë i vjedhin ritet e tyre të adhurimit nga rëndësia e tyre praktike, duke i ndarë ato nga jeta e tyre e përditshme. Ata falen dhe vjedhin, agjërojnë dhe gënjejnë, kryejnë pelegrinazhin në Meke dhe pastaj vazhdojnë të mashtrojnë, kryejnë padrejtësi, përgojnë, shkelin të drejtat e të tjerëve dhe tejkalojnë ligjin e Zotit në kënaqjen e epshit të tyre. Në këtë mënyrë, ata përjetësojnë një lloj bizariteti të shkëputjes midis ekzistencës së tyre shpirtërore dhe praktike.

Kështu, mund ta gjeni dikë që u jep leksion për nevojën e respektimit të rregullave të caktuara që kanë të bëjnë me mishin *hallall*, edhe nëse ndodh që ju të keni qasje më korrekte në pyetjen se cili mish është *hallall* dhe cili nuk është. Për më tepër, ky individ mund të jetë dikush që, fshehurazi ose haptazi, jeton jetën e një mashtruesi komplotues, hileqari, gënjeshtari, hajduti, inatçiu e mllefçari që me dëshirë dëshmon rrejshëm kundër të afërmit të tij dhe që shkel ligjin në çdo shans të disponueshëm. Ai mund të jetë mbase edhe një përdorues i drogës. Megjithatë, pavarësisht të gjithave, ai e mendon veten e tij si model musliman. Ky është skenari më i mirë. Në skenarin më të keq, ai mbas gjase ju deklaron si femohues nëse nuk pajtoheni, me të drejtë ose je, me përkufizimin e tij të mishit *hallall*.

Përshkrimi i lartpërmendur zbatohet për një sektor fatkeqësisht të gjerë të muslimanëve të sotëm. Motoja e tyre e pashprehur është: Faluni, pastaj bëni si t'ua dojë qejfi. Thoni ç'të doni në predikimin e së premtes, pasi e gjitha që ka rëndësi është të jetë në gjuhën arabe. Bëni ç'të doni dhe trajtoni të tjerët siç të dëshironi, pasi gjithçka ka rëndësi është që të mos hani asgjë përveç mishit *hallall* në përputhje me përkufizimin tonë provincial dhe joadekuat të "*hallallit*".

Shumë muslimanë nuk janë të vetëdijshëm mbi rolin themelor të luajtur nga predikimi i së premtes në edukimin dhe zhvillimin e shoqërisë islame. Si rrjedhojë, ata e trajtojnë namazin dhe predikimin e të premtes sikur të ishin thjesht detyra rituale që duhet të kryhen. Pra, kur ata falin namazin, ndjehen të kënaqur me faktin se janë çliruar nga një detyrë e papërmbushur. Shfaqen në kohë, dëgjojnë *imamin*, rreshtohen pas tij në radhë të drejtë dhe e falin namazin, dhe kaq!

Na bëhet e nevojshme të pyesim: a jemi këshilluar ta dëgjojmë *imamin* që jep predikimin e së premtes dhe të qëndrojmë të qetë, ndërsa ai flet thjesht nga mirësjellja dhe respekti për folësin? Nëse po, a nuk do të thotë kjo se namazi i së premtes është pak më shumë se një ceremoni fetare që përfshin lëvizje të caktuara trupore dhe ushtrime, përmbajtja e të cilave nuk ka rëndësi dhe nuk ka kuptim? Namazi është shprehje e adhurimit dhe predikimi i së premtes është një plan-veprimi. Predikimi është një pjesë organike dhe e pandashme e namazit të *xhumasë*. Prandaj, disa hadithe e trajtojnë dikë që e humbet predikimin sikur ta ketë humbur namazin:

*Ditën e xhuma, Engjëjt qëndrojnë tek porta e xhamisë, duke regjistruar dhe klasifikuar njerëzit sipas stacioneve të tyre të ndryshme. "Filani erdhi në filan kohën. E filani në filan kohën. Filani erdhi pasi imami kishte filluar të predikonte. Filani erdhi në kohën e namazit, por e humbi predikimin; prandaj, ai humbi namazin e xhumasë."*<sup>22</sup>

Një *imam* i cili dëshiron që dëgjuesit e tij të largohen nga predikimi me mësim domethënëse, duhet t'i përshtatë fjalët me nevojat, interesat, rrethanat dhe nivelin arsimor të pjesëmarrësve në kongregacion. Prandaj, një predikim i predikuar në një kongregacion të punëtorëve do të duhet të ishte i ndryshëm nga ai i drejtuar në një kongregacion të intelektualëve; duhet të dallojë

22 Transmeton Ahmedin nën autoritetin e Ebu Hurejres.



predikimi në një kongregacion të nxënësve të shkollave nga ai në një kongregacion të studentëve dhe profesorë universitarë; ai i të porsa-konvertuarve e kështu me radhë.

Kur predikonte, Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sellem] asnjëherë nuk i përsëriste vargjet kur'anore në një mënyrë të rastësishme dhe në formë të palidhur sipas mënyrës së shumë *imamëve* të sotëm, predikimet e të cilëve përbëjnë pak më shumë se disa vargje ose hadithe që ata papagallojnë vazhdimisht në kongregacionet e tyre, pa asnjë përpjekje që t'i lidhin me realitetin bashkëkohor. Ne i bëjmë padrejtësi vetë vargjeve kur ia përsërisim ato me pamendësi njerëzve pa ndonjë kontekst kuptimplotë. Një praktikë e tillë mund të ketë ndikim negativ në moralin dhe qëndrimet e adhuruesve, duke e kthyer dashurinë e tyre për këto hadithe dhe pasazhe kur'anore, dhe mbase edhe të tjerave, në mospëlqim dhe ftohje e tjetërsim.

Kur vallë do të bëhet stili retorik i predikimit më pak i rëndësishëm se përmbajtja e tij? Kur do të trajtohet çështja e ngrënies së *hallallit* si një çështje dytësore në krahasim me mësimet themelore morale të Islamit? Kur do të bëhet jeta jonë një mishërim, një zbatim dhe një konfirmim i veprimeve tona të adhurimit? Nëse, siç na është njoftuar nga Profeti ynë i dashur [sal-lallahu alejhi ve sellem], Allahu dërgon dikë që ta ringjallë fenë islame një herë në njëqind vjet, atëherë roli i *imamit* në predikimet e tij të së premtes është të frymojë një jetë të re në rregullat e fesë sonë mbi rrethanat dhe problemet me të cilat përballemi nga një javë në tjetrën, në mënyrë që të mund të ritmojmë me lëvizjen e vazhdueshme të jetës dhe të kontribuojmë në evolucionin dhe zhvillimin e saj.

Ashtu siç çdo institucion arsimor ka një program trajnimi dhe zhvillimi të detyrueshëm për punonjësit dhe stafin e tij, predikimi i së premtes është program i trajnimit, zhvillimit dhe udhëzimit të kërkuar në jetën e një muslimani, lidhja zyrtare javore në nivelet e njohurive dhe praktikës midis institucionit të Islamit dhe institucioni i jetës.

## KËTU FILLOJMË

I vajta në vizitë një vëllai që nuk e frekuentonte më xhaminë tonë. Më thanë se kishte filluar të shkonte në një xhami tjetër, sepse kishte një mosmarrëveshje me një anëtar të caktuar të xhamisë sonë. Pastaj takova një vëlla tjetër që nuk kishte ardhur në xhami për një kohë të gjatë. Kështu, e pyeta: “Përse s’ të shoh dot në xhami?” Ma ktheu: “Nuk dua të falem në një xhami, *imami* i së cilës predikon se qeniet njerëzore janë krijuar nga një pikë fare “e neveritshme”. Si guxon ai t’i referohet pikës së farës nga e cila kemi ardhur në jetë si gjë “e neveritshme”?! Pak kohë më vonë, kur mora rrugën për xhami, u bashkova me një mik timin musliman dhe filluam të bisedojmë. Kur arritëm te xhamia, më përshëndeti me përshëndetje lamtumirëse, qartësisht nuk kishte ndërmend të hynte brenda. I habitur, e pyeta: “Pra, a nuk do të falesh me ne?” Duke tundur kokën, ai u përgjigj: “Nuk bëj adhurim në një xhami ku falen *Selefitë*.”

Dhe thashë me vete: Ç’do të bëhet me ne nëse e gjithë bashkësia muslimane i takon njerit prej këtyre tri grupeve: atyre që refuzojnë të falen në të njëjtën xhami me dikë me të cilin kanë pasur mosmarrëveshje, atyre që refuzojnë të falen pas një predikuesi ose *imami* për një gabim njerëzor - duke supozuar se rasti në fjalë ishte, në fakt, një gabim; dhe atyre që nuk janë të gatshëm të adhurojnë me këdo që nuk pajtohet me mendimin apo interpretimin e tyre fetar? A mendoni se një komunitet i tillë do të kualifikohet për ta qeverisur veten për disa ditë, e lëre më ta qeverisë gjithë botën?!

Ç’është bërë me protokollin e xhamisë? Ç’është bërë me rregullat e etikës që dikur rregullonin namazet e përbashkëta me xhemat? Ç’është bërë me rolin historik të luajtur dikur nga xhamitë, të cilat shërbyen si trampolina për njerëzit që e sollën Islamit në botë me një shpejtësi të paprecedent, duke krijuar një epokë të artë të të mësuarit dhe qytetërimit islam dhe duke frymëzuar përhapjen e moralit në të gjithë botën?

Në prill të vitit 2012 u ftova të merrja pjesë në një kurs që po organizohej nga një institucion në Egjipt, i njohur si Akademia e Predikuesve Bashkëkohorë [Muslimanë]. Kursi do të mbahej në Kajro për qëllimin e deklaruar të “nxjerrjes në pah të shembujve të të diplomuarve të shquar të Ez’herit, si në aspektin akademik ashtu edhe në sjellje, për të komunikuar mesazhin e Islamit të moderuar me të rinjtë e sotëm”.

Bazuar në përvojën time të afro dy dekadave si inspektor i Këshillit Britanik të Akreditimit, puna e të cilit u zgjerua së fundmi për të përfshirë universitetet dhe institutet jashtë Mbretërisë së Bashkuar, propozova krijimin e asaj që unë e quaj “Këshilli Ndërkombëtar i Akreditimit Islam”. Qëllimi i këtij këshilli do të ishte krijimi i qendrave kulturore që i nënshtrohen kushteve të këtij këshilli të ri në vende të ndryshme arabe dhe islamike. E para e këtyre qendrave do të ngrihej në Egjipt; megjithatë, ato nuk do të kufizoheshin në universitete dhe institucione të tjera arsimore, por do të përfshinin të gjitha institucionet shtetërore, të mëdha dhe të vogla, duke përfshirë firmat dhe organet qeveritare, byrotë e qeverisë, rrugët, lagjet e vogla, ndërtesat e banimit, spitalet, klinikat, shkollat, institutet, klubet, dyqanet, xhamitë, kishat, parqet publike, parqet për fëmijë, banjot publike, punëtoritë, etj.

Pesëdhjetë studentët që kishin marrë pjesë në kursin e organizuar nga Akademia e Predikuesve Bashkëkohorë Muslimanë, të cilët vinin nga një varg provincash egjiptiane, do të formonin bërthamën për këtë ide nëpërmjet organizatave të vogla lokale të lidhura në mënyrë qendrore me këshillin e lartpërmendur të akreditimit. Institucionet në rajon pastaj do të inkurajoheshin të konkurrojnë për njohjen e këshillit në fushat e fesë dhe kulturës, dhe institucionet që nuk kishin aplikuar për një njohje ose akreditim të tillë, do të ishin të izoluara nga mjedisi i tyre.

Shpresohej që qendrat dhe vendet e lartpërmendura të përhapeshin gjatë muajve dhe viteve dhe të ushtronin një ndikim në rritje në aspekte të ndryshme të jetës në Egjipt me rezultatin që brenda

një ose dy dekadave, Egjipti do ta gjente veten në një nivel me kombet evropiane në aspektin e aftësisë, rendit, disiplinës, pastërtisë, pamjes, produktivitetit, sigurisë në vendin e punës, nivelit arsimor dhe marrëdhënieve ndërpersonale. E gjithë kjo, sigurisht, do të ndihmonte për ta rikthyer vendin në vlerat fetare që ai i ka humbur.

Kur ideja dështoi të dilte në praktikë për shkak të ngjarjeve fatkeqe që pasuan Revolucionin e 25 janarit 2011, filluam të mendonim për një drejtim alternativ, domethënë, të fillojmë nga njësia më e vogël kulturore në shtetin islam: komuniteti i xhamive, të paktën një do të gjendej në çdo rrugë, në çdo lagje dhe në çdo fshat. Çdo xhami, e kryesuar nga *imami* i saj dhe një grup i pjesëmarrësve të tij të rregullt, mund të shndërrohet në një lloj këshillimi lokal akreditimi për institucionet brenda zonës së saj të drejtpërdrejtë gjeografike. Vlerësimet e tij/saj për këto institucione do të bazoheshin në dhjetë kushtet themelore kulturore që propozuam më lart në diskutimin tonë për namazin me xhemat.

Kriteret për njohje nga Këshilli Britanik i Akreditimit - përtej atyre që zbatohen në mënyrë specifike në universitete - janë të zbatueshme për çdo grup që vepron brenda shtetit dhe mund të përmbliidhen si vijon:

1. Pamja e jashtme dhe e brendshme e ndërtesës.
2. Shëndeti, siguria dhe kushtet e pastërtisë për stafin punonjës dhe përfituesit nga shërbimet e saj.
3. Përshtatshmëria e strukturës fizike, duke përfshirë zyrat dhe dhomat e tjera, për ofrimin e llojeve të shërbimeve që ofron institucioni.
4. Disponueshmëria e sigurimit të nevojshëm për të gjithë punonjësit dhe përfituesit.
5. Suksesi i administratës në udhëheqjen e institucionit dhe përmbushja e objektivave të saj.
6. Kualifikimet e dokumentuara mirë të stafit, përfshirë nivelin dhe cilësinë e gradave që ata gëzojnë dhe përshtatshmërinë e përvojës që sjellin në punën e tyre.

7. Kurset trajnuese e të vazhdueshme të stafit.
8. Kontratat e rregullta për të gjithë punonjësit e institucionit dhe një shkallëzim i barabartë i pagave.
9. Sistemi nxitës që nxit iniciativën individuale nga ana e punonjësve dhe zhvillon talentet dhe dhuntitë e tyre.
10. Sistemi efikas dhe modern për organizimin e shënimeve dhe dosjeve për stafin dhe përfituesit.
11. Aktet nënligjore, rregulloret, politikat, planet dhe përshkrimet e punës të qarta dhe të ruajtura për të gjithë të punësuarit.
12. Shpalljet, njoftimet dhe reklamimet e besueshme.
13. Sigurimi i shërbimeve të besueshme dhe kredibile, përvoja, ekspertiza dhe diploma.
14. Përdorimi i gjuhës së përshtatshme civile, e shkruar ose e folur, në adresimin ndaj të tjerëve.
15. Komunikimi i administratës me punonjësit dhe përfituesit, dhe përgjegjësitë e tyre ndaj opinionit dhe kërkesave të tyre.
16. Pajisjet e ofruara nga institucioni për personelin dhe përfituesit, veçanërisht ndaj atyre me nevoja të veçanta.
17. Shkalla e barazisë që u jepet stafit dhe përfituesve, dhe mungesa e diskriminimit racor, fisnor, partiak ose doktrinor midis tyre.
18. Pjesëmarrja e gjyqtarëve të jashtëm në një vlerësim vjetor të aktiviteteve dhe shërbimeve të institucionit.
19. Vlerësimi i rezultateve të arritura në fund të çdo semestri / viti / faze, etj.

Kjo, pra, është lista e kategorive dhe kritereve të cilave, një inspektor duhet t'u kushtojë vëmendje kur e viziton institucionin që kërkon akreditim nga Këshilli Britanik i Akreditimit. Ato janë të gjitha, në thelb, në përputhje me dhjetë "farat" e civilizimit të identifikuar në një diskutim të mëhershëm, fara që mbillen dhe ushqehen me namaz të përbashkët.

Një lëvizje që lind nga namazi me xhemat, mund të fillojë nga xhamitë e shpërndara. Më pas, në bazë të dhjetë kategorive të përmendura më lart, secila xhami vendos kritere që duhet të përbushen nga çdo institucion ose organizatë që kërkon të akreditohet. Në një fazë të mëvonshme, organet që përfaqësojnë xhamitë pjesëmarrëse mund të takohen për të formuar një këshill të unifikuar dhe për të rënë dakord mbi një sërë kriteresh të standardizuara.

Këto kritere të standardizuara pastaj mund të zhvillohen dhe të zgjerohen në një kushtetutë ose një sërë aktesh nënligjore për një Këshill Kombëtar të Akreditimit që vepron në nivelin e shtetit.

Inicimi i një lëvizjeje të tillë duhet të paraprihet nga një plan mirë i dizajnuar prej një ose më shumë *imamëve*, të cilët do të punonin për të formuar një bashkësi adhuresish të bashkuar nga një ndërgjegjësim për funksionin e vërtetë të namazit të përbashkët me xhemat dhe rolin e tij në çdo ditë të jetës dhe reformës shoqërore. Ky komunitet themelues fillestar, mund ta formojë bërthamën e një komuniteti më të madh të përbërë nga kongregacionet e të gjitha xhamive në një rajon të caktuar. Ky komunitet më i madh dhe më gjithëpërfshirës do të përbënte Këshillin e Lartë të Akreditimit.

Qoftë në Egjipt ose në ndonjë vend tjetër musliman, një lëvizje e tillë do të themelohej që të përhapej pastaj në mbarë botën muslimane. Duke pasur parasysh planifikimin dhe ekzekutimin e duhur, një lëvizje e tillë mundet, brenda pak dekadave, ta rivendosë bashkësinë muslimane në vendin që dikur gëzonte midis qytetërimeve të botës, duke e ringjallur frymën e reflektimit të shëndoshë fetar dhe duke i lidhur ritet islamike të adhurimit si me jetën private ashtu edhe me atë publike në nivelin praktik. Në këtë mënyrë, Islami mund të zbulojë fytyrën e vërtetë kulturore në pjesën tjetër të botës.

Kjo premton të jetë një detyrë e madhe. Sidoqoftë, udhëtimet më të gjata fillojnë me një hap të vetëm dhe nëse i afrohem

atij me seriozitetin dhe vendosmërinë e duhur, mund të shpre-  
sojmë, nëpërmjet një këshilli të tillë, të arrijmë atë që brezat e  
qeverive dhe mendimtarët nuk e kanë arritur dot.



## KAPITULLI 13

# Pesë linjat e namazit

*O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç'flitni. (En-Nisa: 43)*

Sa herë e kemi kënduar këtë ajet kur'anor, por pa i vënë re mësimet që ai ofron? Po ta shihnit një kalimtar rasti duke folur e gje-stuar me duar, duke tundur kokën dhe pa as njeri tjetër pranë vetes, gjëja e parë që do t'iu shfaqej në mendje do të ishte mendimi se është duke folur me dikë në celular përmes formës alto-parlant ose mbase i ka kufjet në veshë. Nëse, megjithatë, e vështroni nga afër dhe zbuloni se nuk kishte asgjë në veshë, asnjë mikrofoni pranë gojës dhe asnjë celular në dorë ose xhep, do të arrinit në përfundim se ai është një i çmendur, i retarduar ose i dehur. Apo, mos vallë po ekzagjeroj gjë unë?

Analogjia e njëjtë vlen për mënyrën se si e falim namazin. Kur sheh njerëz duke u falur dhe nuk sheh askënd pranë tyre, asnjë telefon celular në horizont; kur sheh se i drejtohen ajrit të hollë me asnjë njeri para tyre, ky mbase mund të jetë një imazh



i fuqishëm i një të menduari të tillë. Në namaz, ose mund të lidhemi së brendshmi me Allahun ose, të pavëmendshëm për Të, mund të veprojmë ndryshe nga ata që flasin me zë të lartë pa mikrofon ose pa telefon celular, të cilët duken të dehur, të pavetëdijshëm për atë që thonë.

Ekziston një dallim i madh në mes të të folurit në një mënyrë që është e dukshme nga qëndrimi dhe nga shprehjet e fytyrës sonë, se e mendojmë atë që themi dhe se jemi të angazhuar në një bisedë ku thjesht i lëvizim buzët dhe gjuhën duke dhënë përshtypjen se po flasin me dikë ose se nënkuptojmë diçka nga ajo që themi. Situata e fundit përfshin një këndim të nxituar të fjalëve, të cilat në origjinë kishin domethënie, por që, duke marrë parasysh sjelljen e pakuptimtë të folësit, karakteristikat e shëmtuara e të avashta të fytyrës së tij dhe monotoninë në të cilin fjalët fluturojnë nga gjuha e tij, ato nuk komunikojnë asgjë me rëndësi.

Tani, merrni telefonin dhe provoni ta thirrni një mikun tuaj. Kërkoni nga bashkëshortja ose ndonjë anëtar tjetër i familjes të shënojë saherë që ai/ajo sheh një ndryshim në shprehjen tuaj të fytyrës, tonin e zërit ose mënyrën e të folurit gjatë bisedës që pason. Tiparet tona, shkalla në të cilën flasin, toni ynë i zërit, gjestikulacionet e dorës dhe pozicionet e trupit tonë ndryshojnë pa pushim gjatë një bisede normale derisa japim dhe marrim, lusim dhe përgjetojmë, insistojmë dhe kërkojmë, pranojmë dhe refuzojmë, përgëzojmë dhe lëvdojmë, kundërshtojmë dhe protestojmë, qortojmë dhe paralajmërojmë, surprizohemi dhe zhgënjehemi, tronditemi dhe lehtësohemi, pyesim dhe përgjigjemi. Shprehim habi dhe hezitim, frikë dhe pritje. Gjykojmë; afirmojmë po edhe mohojmë. Ka pushime dhe rifillime, korrigjime, hezitime dhe kështu me radhë e kështu me radhë. Nëse asnjëra nga të mësipërmet nuk ndodh kur flasin, kjo do të thotë se ne nuk jemi asgjë tjetër veçse robotë.

Kur falni namaz, a jeni të sigurt se nuk dukeni si robotë, pijanecë apo të çmendur? Keni punuar ndërgjegjshëm për t'u sigu-

ruar se “dikush” po kontakton “dikë” ashtu siç dikush prej nesh do të kontaktonte një mik, një profesor ose një epror në punë? Keni menduar ndonjëherë se si mund të tregoni se ka një person vërtet të gjallë në anën tjetër të linjës? Nëse jeni të bindur se Allahu vërtet është “në anën tjetër të linjës”, se po i drejtoheni Atij dhe se Ai po dëgjon, se Ai po ju kujton ashtu siç ju e kujtoni Atë dhe se Ai iu përgjigjet lutjeve tuaja, atëherë ç’dëshmi do të vëzhgohen nga dikush që ju ka vështruar ose duke dëgjuar derisa faleni? Në fakt, si mund t’ia vërtetoni Vetë Allahut, i Cili dëgjon çdo tingull të zërit tuaj, numëron çdo rrahje të zemrës tuaj dhe e di çdo mendim tuajin, se në fakt po i flisni jo “askujt”, por Atij?

*Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit. (El-Mu’minun: 1-2)*

*Pra shkatërrim është për ata që falen, të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm. (El-Ma’un: 4-5)*

Çdo çast i kontaktit me Zotin, edhe nëse është i lirë nga të folurit, është më i mirë se tekstet (kur’anore) i që këndojmë pa ndonjë komunikim. Zoti i Plotfuqishëm e shikon qenësinë tonë të brendshme. Pra, t’i adresuarit Allahut pa fjalë, për një çast të vetëm, nga zemra, është më mirë se t’i adresuarit Atij pafundësisht me fjalë, por pa jehonë të zemrës, duke supozuar, domethënë se ne me të vërtetë duam ta arrijmë Zotin dhe, nëpërmjet komunikimit tonë me Të, t’i riprogramojmë shpirtat tanë për ta gjetur rrugën e lumturisë dhe për t’i fshirë mëkatet që kanë njollosur qeniet tona.

*Dhe fale namazin në dy skajet e ditës, e edhe në orët e afërta (me ditën) të natës. S’ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat. (Hud: 114)*

Namazi nuk është një lloj ushtrimi fizik, edhe pse përfshin aktivitetin fizik. Nuk është thjesht kohë që lëmë mënjanë për faljen

e tij, edhe pse falja e tij kërkon kohë. Nuk as fjalë që formësojmë me buzë e gjuhë, edhe pse ato janë pjesë e saj. Përkundrazi, namazi përbëhet nga pesë linja të njëkohshme, të ndërlidhura dhe të integruara. Dhe nëse duam që namazi jonë ta përfshijë komunikimin e vërtetë me Zotin e Plotfuqishëm, asnjëra nga këto linja nuk duhet parë si e vetëkontraktuar, e pavarur nga të tjerat. Ato nuk përmenden në tekstet e shenjta midis shtyllave të namazit. Megjithatë, ato përbëjnë elementet më thelbësore të të gjithëve, meqë namazi nuk do të ishte namaz pa to.

“Linjat” për të cilat po flas janë: (1) koha, (2) gjuha, (3) trupi, (4) zemra dhe (5) veprimi.

**KOHA:** Mos u mundoni të më bindni mua ose veten tuaj se brenda hapësirës prej pesë ose gjashtë minutave, mund ta përfundoni namazin drekës, namazin ikindisë ose ndonjë nga namazet e tjera të nevojshme të ditës. Sasia e kohës që ja kushtoni adhurimit është një çështje me rëndësi thelbësore për të përcaktuar nëse namazi ose komunikimi me Zotin përmes namazit, ka ndodhur në të vërtetë. Mbase pjesa më e rëndësishme e faktorit kohor në namaz janë çastet e heshtjes që ndërhyjnë midis një ajeti dhe një tjetri dhe mbase edhe midis një fjale dhe një tjetre. Shmangni lejimin e fjalëve që të ngjeshen, mbingarkohen dhe grumbullohen në gjuhët tuaja, ku secila prej tyre nxiton për të dalë përpara tjetrës. Shijoni ato, duke i rrotulluar në gjuhët tuaja si mjaltin. Çdo fjalie, çdo fraze, madje çdo fjalë të namazit, kushtojani disa çaste heshtjeje gjatë së cilës mund t'i orientoni ato drejt mendjes tuaj dhe të reflektoni mbi kuptimin e tyre. Shijoni bukurinë e tyre. Sigurohuni që mendja juaj nuk ka bredhur asgjëkund, por se është përqendruar në kuptimin e fjalëve, ndërsa i shprehni ato. Le të përshkohet gjysma e namazit tuaj nga heshtja, ndërsa gjysma tjetër nga biseda e qetë drejtuar vetëm Allahut.

**GJUHA:** Me gjuhë, këndojmë fjalët e modeluara për ne nga i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duke kërkuar

të vëmë drejtësi për çdo fjalë dhe çdo kuptim me intonacionin, melodinë dhe vëllimin e duhur. Vetëm nëpërmjet virtutit të harmonisë së nevojshme midis të gjitha këtyre elementeve, adhuruesi do ta përjetojë praninë e plotë dhe ndërimin e vërtetë përlules.

*TRUPI:* Gjithë sjellja jonë, nga gjestikulacionet e deri tek shprehjet e fytyrës, kanë një rol në shprehjen e kuptimeve të fjalëve që këndojmë. Fytyra, sytë dhe tërë trupi shprehin kuptimin e fjalëve edhe nëse gjuha dhe buzët nuk bëjnë lëvizje dot. E kenë vështruar ndonjëherë namazin e atij që nuk ka aftësi për të folur? Ai i derdh të gjitha fuqitë e tij të shprehjes në sytë, fytyrën dhe trupin e tij me qëllim që ta kompensojë pamundësinë e tij për t'u shprehur me gjuhë. Mësoni të faleni me trup sikur të jeni memecë. Pastaj, përforconi shprehjet trupore me fjalë.

*ZEMRA:* Zemra duhet të godas tek lëvizja e gjuhës, në mënyrë që secila prej tyre ta konfirmojë vërtetësinë e tjetrës. Mendimet dhe shqetësimet nuk duhet të jenë në një vend ndërsa buzët dhe gjuha në një tjetër.

Idealisht, fjalët që shprehim me buzët tona duhet të gjejnë njëfarë shprehjeje fizike. Ah sikur ndërveprimi mes zemrës dhe trupit të ishte i atillë sa që në tingujt e fjalëve që na preken përbrenda, dridhjet të ndiheshin përmes nesh, fytyrat të na zbeheshin, zërat të na dridheshin e lotët të intensifikoheshin në sytë tanë!

*VEPRIMI:* Duhet ta krijojmë një synim të ndërgjegjshëm, për ta lënë jetën tonë të përditshme të jetë një zbatim praktik i fjalëve që shprehim dhe emocioneve që përjetojmë gjatë namazit. Jeta jonë duhet të jetë mishërimi fizik i fjalëve që shprehim në adhurim. Namazi nuk duhet të jetë thjesht një ritual formal që nuk lidhet me praktikën tona të përditshme dhe marrëdhëniet tona me Zotin dhe të tjerët. Ashtu siç rituali i abdesit ka një aspekt të jashtëm dhe një të brendshëm, po ashtu ka edhe

namazi. Në të dyja, në literaturën kur'anore dhe hadithore, namazi lidhet me veprimin, zbatimin, urdhërimin e asaj që është e mirë dhe ndalimin e asaj që është e keqe.

*O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat... (Lukman: 17)*

*E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqij, që e lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo të keqe (ose në Gaja). (Merjem: 59)*

*Nëse namazi nuk ju pengon nga kryerja e veprimeve të dëmshme dhe në kundërshtim me arsyen, atëherë ai nuk bën tjetër veçse ju largon nga Zoti.<sup>23</sup>*

#### Prandaj:

- Faluni me gjymtyrë, sikur nuk keni fytyrë fizike.
- Faluni me shprehje të fytyrës, sikur nuk keni gjuhë.
- Faluni me ton të zërit, sikur nuk keni trup.
- Faluni me rrahje-zemre, sikur ato të jenë rrahjet e fundit.
- Zgjateni namazin, sikur të jeni duke e falur namazin e fundit.

Një njeri i caktuar u ftua në një festë të madhe në një vend të largët. I ngazëllyer, veshi rrobat më të bukura dhe ndërmoi udhëtimin e gjatë, të vështirë dhe të kushtueshëm në vendin ku do të mbahej festimi, duke hequr dorë nga mundësitë për përfitime tokësore në proces e sipër. Kur më në fund arriti në destinacionin e tij, tregoi ftesën që kishte marrë dhe iu lejua hyrja brenda në sallë. Sapo hyri në të madhen sallë, u ul në mesin e mysafirëve të tjerë dhe priti që ngjarja të fillojë. Por, brenda disa minutash, madje edhe para se perdjia të ngrihej, atë e kaploi një gjumë i lehtë në ulësen e tij. Pak kohë më vonë, u zgjua papritur tek tingujt e

---

23 Transmeton Safarini el-Hanbeli nën autoritetin e Abdullah ibn Abasit në *Sherh Kitab el-Shihab*.

shërbëtorëve që i kërkonin të largohesh, në mënyrë që të pastronin sallën e kremtimit. Ahengu mbaroi, dhe të ftuarit ishin shpërndarë dhe kishin vajtur nëpër shtëpitë e tyre, secili!

Ky njeri është si ata prej nesh, të cilët në përgjigje të një ftese hyjnore, përgatiten për namaz duke marrë abdes, pastaj shpenzojnë çdo kohë dhe para që iu nevojitet për të shkuar në xhami. Më pas, kalojnë ca kohë në xhami në adhurim. Pas gjithë kësaj, largohen që aty pa përjetuar asgjë nga bekimet shpirtërore, pa ndërë ndonjë lidhje me Krijuesin e pa e ndërë marrjen e shpërblimit që e kishin shpresuar.

I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njëherë i ndihmoi dy burra muslimanë të miqësoshin me njëri-tjetrin. Më vonë, njëri prej tyre u vra, ndërsa një javë pas tij, u vra edhe tjetri. Pas vdekjes së të dytit, disa në komunitetin musliman thanë: “O Zot, falja mëkatet dhe bëj që ai të bashkohet me mikun e tij [në Xhenet]!” Pas këtyre fjalëve, reagoi i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] duke thënë:

*Si mund të krahasohen namazet e këtij me ato të mikut të tij? Si mund të krahasohen veprat e tij të mira me ato të mikut të tij? Ata janë aq larg nga njëri-tjetri sa vetë Toka nga Qielli.<sup>24</sup>*

Thjesht mendoni: Nëse vlera e një jave me namaz mund t’ju sjellë një shpërblim të tillë të madh hyjnor, atëherë imagjinoni shpërblimin që mund ta merrni me një namaz të vetëm! Meditoni mbi këtë incident dhe fjalët që tha Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në përgjigjen e tij. Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk qe i kënaqur thjesht me pyetjen: “Si mund të krahasohet [numri i namazeve të këtij njeriu me ato të mikut të tij]?” Përkundrazi, e pasoi atë me një pyetje që është e pandashme nga e para, duke thënë: “Si mund që [numri i] veprave të tij të mira të krahasohet me ato të mikut të tij?” Prandaj, ky hadith është një rikujtim se

24 Transmeton Ebu Davudi nën autoritetin e Ubjed Ibn Halid el-Sulamit. E saktësoi Albani.

namazi dhe veprimi janë një njësi organike, të cilat nuk guxojnë të divorcohen nga njëra-tjetra.

Sa herë që e mbaroni faljen e namazit, pyesni veten: Në ç'largësi më ka ngre namazi që sapo e fala? Lart mbi qiejt? Përtej Hënës? Kalova retë? Mbi çatinë e shtëpisë sime? Disa pëllëmbë mbi kokën time? Disa inçë? Një inç? Aspak fare?

Asnjëherë mos u largoni nga xhamia pas namazit, pa u siguruar se jeni një person tjetër nga ai që hytë pak minuta më parë.



## KAPITULLI 14

### Nr. 1: “Allahu është më i madh” *Allahu Ekber*

Siç e pamë më tashmë, fraza: “*Allahu Ekber* - Allahu është më i madh,” përcjell një energji unike, e cila na fuqizon të distancohemi nga sfera tokësore. Sidoqoftë, shembulli i kësaj fraze që e shqiptojmë në fillim të namazit, e njohur si *tekbir el-ihram*, ose “lavdërimi hyjnor i shenjtërimit”, ka një cilësi edhe më të veçantë, pasi na shtyn drejt një fusheje të shenjtë e të krahasueshme me gjendjen e shenjtërimit në të cilin hyn haxhiu në Mekë para se ta kryen haxhin.

Nëse dikush do t’ju thoshte: “Armiku është më i dobët,” pastaj hesht, çfarë do të mendonit ju? Do të thoshit me vete: Çfarë më pas? Pse nuk e përfundoi ai fjalinë? Ose: Mbase ai papritmas u ndje keq ose diçka e pengoi nga përfundimi i frazës. Meqë do të prisnit që deklarata e tij të merrte një formë më të plotë, të gjitha këto shpjegime do të mund të vetë-sugjeroheshin nga ju. Mund të kishit pritur që ai të thoshte, për shembull: “Armiku është më i dobët se sa kishim menduar.” Me fjalë të tjera, dikush do të priste që fjala “më i dobët”, si forma krahasuese e mbiemrit,



të ndiqej nga pjesa “sesa...”. Por, ajo ka ngelur e hapur për shumë mundësi, mundësi të pasura që e lejojnë dëgjuesin ose folësin ta përfundojë atë në intimitetin e mendjes së tij me rezultate, madje qindra ose mijëra përfundime alternative: Allahu është më i madh... se ti, o Shejtan! Allahu është më i madh... se ti, o tiran! Allahu është më i madh... se ju, o shqetësimet e mia! Allahu është më i madh... se ju, o kënaqësitë dhe ëndjet e botës! Allahu është më i madh... se çdo gjë që mund të shpërqendrojë nga të folurit ose të menduarit rreth Atij që është Autori i të gjithëve.

Mbiemri arab i përdorur në këtë frazë (*ekber*) nuk nënkuptohet as “i madh” as “më i madhi”, por, “më i madh”. Sidoqoftë, duke e pasur parasysh se edhe ne arabët nuk e kemi kuptuar me të drejtë, të verbuar siç jemi me efektin e zbehjes së familjaritetit dhe përsëritjes, nuk duhet të habitemi që ata që e kanë përkthyer atë në gjuhë të tjera, kanë bërë shpesh gabimin e të përkthyerit si “Allahu është i madh”, ose “Allahu është më i madhi”, në vend që ta ruajnë dykuptimësinë dhe shfajësimin e veçantë e “Allahu është më i madh”.

Nëse i dëgjoni me kujdes *muezinët* dhe ata që shpallin namazin e përbashkët me xhemat (*ikametin*), do të gjeni se shumica e tyre i lënë jashtë dy përsëritjet e *Allahu Ekber*-it, ashtu që në të vërtetë thonë, *Allahu ekberallahu ekber...* sikur ato të ishin një frazë e vetme. Duke vepruar kështu, ata vjedhin *Allahu Ekber*-in e parë nga karakteri i tij i veçantë dhe nuk e dëgjojmë ashtu siç është në të vërtetë - një frazë e hapur dhe jo e plotë e ndjekur nga elipsat (*Allahu Ekber...*) që jemi të ftuar ta plotësojmë me imagjinatën tonë.

Ky bashkim i dy rasteve të veçanta të frazës *Allahu Ekber*, është një nga shumë rezultatet praktike të faktit se, për shkak të familjarizmave të tepërta, e kemi humbur kontaktin me natyrën dalluese gjuhësore të kësaj fraze. E kemi shndërruar atë në një fjali të zakonshme pa ndonjë element të hapur. Pra, kush mund t'i fajësojë përkthyesit të cilët gabimisht e përkthejnë frazën

*"Allahu Ekber"* si: "Allahu është i madh" (*Allahu Kebir*) ose "Allahu është më i madhi" (*Allahu huve el-ekber*)?

Mundohuni ta imagjinoni veten midis banorëve të qytetit të Medinës, kur e dëgjuan ezanin e parë ose thirrjen për në namaz. Si do të ndiheshin ata sikur ta hasnin këtë strukturë të re dhe të papërfunduar gjuhësore? *Allahu Ekber... Allahu Ekber... Allahu Ekber....* Herë pas here, do ta kishin dëgjuar fjalën *ekber*, "më i madh", por pa dëgjuar plotësuesin gramatikor që natyrisht do ta kishin parashikuar.

*Allahu Ekber* - fraza me të cilën e fillojmë çdo namaz - mund të përqaset me të parën në një seri "pullash të kuqe", të cilat i shtypni ndërsa fluturoni "anijen kozmike" të namazit para se ajo të fluturojë në vendet më të largëta të sferave qiellore.



## KAPITULLI 15

# Leximi, recitimit dhe këndimi

Një vëlla musliman më pyeti një herë: “Përse nuk e planifikojmë atë që do ta këndojmë gjatë faljes së namazit? Si do të na ndihmojë një pasazh që thotë, për shembull:

*E ato gra që janë shkurorëzuar janë të obliguara të presin tri menstruacione. (El-Bekare: 228)*

të afrohemi më afër Allahut ose të jemi më të përlur e nderues në praninë e Tij?”

Në fakt, kur këndojmë nga Kur’ani, duhet ta kemi parasysh se nuk po këndojmë fjalim njerëzor, por një zbulesë hyjnore. Nuk po këndojmë në kuptimin e zakonshëm të fjalës - domethënë, në kuptimin e thjeshtë të shprehjes së një teksti me zë të lartë. Përkundrazi, po emulojmë ose ndjekim këndimin e bërë para nesh nga i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili nga ana e tij e pasoi këndimin e bërë para tij nga Engjëlli Xhibril [alejhis-selam], i cili e kishte pasuar Zotin e Plotfuqishëm.

Fjala arabe e përkthyer si “emulim” ose “pasim”, “*tilauah*” (e nxjerrë nga folja *talajatu*), është një fjalë e përdorur në mënyrë

specifike vetëm për këndimin e Kur'anit. Para ardhjes së Kur'anit, arabët e shkretëtirës nuk kishin qenë të familjarizuar me përdorimin e foljes “*tala*” në një kontekst të tillë gjuhësor. Për ta, kjo fjalë thjesht nënkuptonte “pasim” ose “ndjekje”. Ata mund të thoshin, për shembull: “Një njeri erdhi aty ku po qëndronim ulur dhe u pasua (*tal’hu*) nga një tjetër.” Në Kur’an, nga ana tjetër, kjo folje u përdor në kuptimin e emulimit ose pasimit të dikujt në aktin e këndimit. Kur, në kohën tonë, e këndojmë Kur’anin vetë, në fakt e “pasojmë” (*natlu*) të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sellem], i cili “e pasoi” Engjëllin Xhibril [alejhis-selam], i cili nga ana e tij “e pasoi” Sunduesin Hyjnor, duke i kënduar Fjalët e Shpalljes.

Mund ta dalloni rëndësinë e këtij kuptimi? Në fakt, jemi të angazhuar në një proces të vazhdueshëm të “pasimit” të Vetë Zotit të Plotfuqishëm. Ndërsa këndojmë ajete nga Kur’ani, faktikisht përjetojmë një ndjenjë të lidhjes direkte, të ngrohtë dhe intime mes vetes dhe Allahut të Plotfuqishëm nëpërmjet këtij zinxhiri të shenjtë, me të cilin tani jemi të lidhur. Pra, ndërsa këndon pjesë nga Kur’ani, jini të vetëdijshëm për vendin që tani e zini në këtë zinxhir fisnik.

Rregullat e këndimit formal e melodik të Kur’anit, ose të *texhvidit*, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e transmetimit besnik dhe të saktë të Kur’anit përgjatë epokave. Si i tillë, me proceset e tij të asimilimit (*idgham*), zgjatjes (*madd*) dhe shkurtimit (*kasr*), ndarjes (*fasl*), lidhjes (*wasl*) dhe pushimeve/pauzave (*wakf*), jemi trajnuar në saktësi të përsosur dhe besnikëri absolute në qarkullimin e tekstit. Si rezultat, këndimi ynë i sotëm është një kopje e saktë e këndimit, recitimit ose leximit original që mori Xhibrili [alejhis-selam] nga Zoti i tij dhe ia përcolli të Dërguarit të Zotit, Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sellem], e të cilën pastaj Vula e Profetëve [sal-lallahu alejhi ve sellem] e përcolli tek.

Rregullat e *texhvidit* na mësojnë t’i japim këndimit më shumë kohë sesa do t’i jepnim një lexim të zakonshëm të tekstit me zë të lartë. Kjo kohë shtesë, na ndihmon t’i nxëmë kuptimet e ajeteve

kur'anore dhe fjalëve individuale që i formësojnë ato, pasi nuk na lejohet të kalojmë me nxitim pa e lidhur lëvizjen e gjuhës dhe buzëve nga njëra anë me lëvizjen e mendimeve dhe imagjinatave nga ana tjetër. Provoni këndimin ose leximin e kaptinës së fundit të Kur'anit, të titulluar *Suret En-Nas*, pa i respektuar rregullat e *texhvidit*. Pastaj, kthehuni dhe këndoni ose lexoni ato duke zbatuar këto rregulla, të cilat do t'ju japin një ndjenjë se sa më tepër kohë ju duhet për ta kënduar Kur'anin formalisht krahasuar me kohën kur bënit një këndim të thjeshtë.

Deri në masën e disponueshme, provoni që gjatë namazit ta këndoni Kur'anin në mënyrë melodike (duke respektuar rregullat e *texhvidit*) në vend se thjesht ta këndoni ashtu joformalisht. Këndimi i tekstit do t'ju japë një ndjenjë më të qartë të përgjegjësisë individuale ndaj saj, një nderim më të thellë, frikë-respekt dhe një brengë për t'i dyfishuar me besnikëri absolute fjalët e Zotit të Plotfuqishëm, ashtu siç u përcollën nga Engjëlli Xhibril [alejhis-selam].



## KAPITULLI 16

### Gjuha e re e Kur'anit

Diçka që mund t'ju ndihmojë ta zhvilloni, thelloni dhe përmirësoni këndimin e Kur'anit, është kuptimi se kur këndoni Kur'an, nuk keni të bëni me gjuhën e zakonshme, tradicionale dhe njerëzore. Ajo që më së shumti i preku muslimanët e hershëm kur e dëgjuan Kur'anin nga buzët e vetë Profetit të tyre [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] për herë të parë, nuk ishte bukuria e gjuhës së tij (Kur'anit); as nuk ishte stili i tij retorik i shkëlqyer, elokuenca e tij, kuptimet e tij, qartësia e tij, saktësia e tij ose ritmi i tij. Përkundrazi, ajo që i preku ata në thelb ishte prania e njëkohshme e të gjitha këtyre karakteristikave krah-për-krah me diçka shumë më të madhe dhe më të shquar, diçka që, pavarësisht aftësisë dhe ekspertizës së tyre gjuhësore dhe besimit e krenarisë së tyre në poezinë, letërsinë dhe elokuencën e tyre, asnjëherë nuk e kishin vërejtur në gjuhën e tyre më parë. Kjo "diçka" ishte risia dhe unikaliteti i gjuhës që po përdorej, e cila dallohej në mënyrë cilësore nga ajo arabe që ata kishin hasur ndonjëherë më parë, duke përfshirë vetë të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Para shpalljes së profetësisë së Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], miqtë e tij arabë ishin të familjarizuar me gjuhën e

përdorur zakonisht nga ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e cila në thelb nuk ishte e ndryshme nga ajo e tyre. Për këtë arsye, duhet të ketë qenë një ngjarje tronditëse, kur një mëngjes ata u zgjuan dhe e panë atë [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] duke iu adresuar atyre në një gjuhë që ndryshonte tërësisht si nga forma e tij e zakonshme e shprehjes gjuhësore ashtu edhe nga e tyrja. Ajo ishte e dallueshme në kontekstin e pjesoreve, vokabularit, shprehjeve, idiomave, lidhëzave, imazheve dhe tipareve të saj retorike. Por, në të njëjtën kohë - dhe këtu qëndron aspekti i mrekullueshëm dhe turbullues i saj - gjuha që ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po përdorte tani ishte përsëri e pastër, e papërzier arabisht, bazuar në rregullat e përcaktuara të gjuhës me të cilën ata ishin aq të familjarizuar. I tillë ishte rasti, përkundër të gjitha shtesave që ishin prezantuar, konventave të reja që e kishin pasuruar tani, dhe horizonteve të pakufizuara të hapura për inovacion dhe zhvillim.

Ajo me të cilën ata u ballafaquan ishte një kombinim i jashtëzakonshëm i rregullave themelore të arabishtes, në të cilat gjuha e re mbështetej dhe që ajo kishte ruajtur plotësisht të paprekur, dhe një largim nga konventat tradicionale dhe të njohura të terminologjisë dhe gramatikës. Kjo përzierje e paprecedent, me veçantinë, risinë dhe unikalitetin e saj, është mjaft e thellë dhe e zakonshme për të na tronditur, për të na eksituar dhe për të frymëzuar një qëndrim të nderimit të përlulur, siç e përsërisim në namazet tona. Dhe për këtë arsye, kapitujt e këtij libri të frymëzuar në mënyrë hyjnore kanë një emër të ri, unik - *sure*, literalisht, “mur” ose “gardh” - që sinjalizon padepërtueshmërinë e ndonjë gjëje në to dhe pamundësinë e imitimit ose falsifikimit të tyre.

Njësitë ose versetet, në të cilat janë të ndarë suret e Kur’anit, gjithashtu mbajnë një emër të veçantë - ajet, ose “shenj / mrekulli” - e cila pohon natyrën e mrekullueshme të këtij fenomeni gjuhësor dhe pamundësinë e falsifikimit, imitimit ose penetrimit në misteret e saj për të gjithë kohën që do të vijë.<sup>25</sup>

---

25 Për detaje të tjera mbi këtë temë, shihni hyrjen e pjesës 1 të librit tim të titulluar “*El-Mu’xhize*”, 2012.



## KAPITULLI 17

# Gjuha e hapur dhe “Hapësirat Fertile”

Shpesh hasim në fjalë dhe fraza me të cilat jemi aq të familjarizuar, aq të mësuar me dëgjimin ose përsëritjen e tyre sa herë kalojmë skaj tyre, por pa një mendim të dytë. I trajtojmë ato sikur të ishin krejtësisht të zakonshme edhe pse në qoftë se i zhveshim kujtimet tona nga efektet e zakonit ose familjaritetit, do t'i shihnim ndryshe. Me rëndësi të madhe këtu është hadithi i mëposhtëm: “Kur përkulej në ruku dhe përulej në sexhde, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thoshte:

Subbuhun kuddus rabbu el-mela'iketi ve el-ruh. – I lartësuar është më i Shenjti, Zoti i Engjëjve dhe i Shpirtit (Xhibrilit).<sup>26</sup>

Ashtu siç termi *subhane*, praktikisht i përdorur gjithmonë para emrit të Zotit në kuptimin e: “I lartësuar është më i Shenjti,” termi *subbuh* u fut në gjuhën arabe vetëm me ardhjen e Islamit. Të dy këto terme janë të hapura në natyrën e tyre në kuptimin se ato lënë një “hapësirë bosh” për t'u mbushur me konceptimet

26 Transmeton Muslimi nën autoritetin e Aishes [radijallahu anha].



ose imagjinatat tona, pasi ato lidhen me tiparet e përsosmërisë hyjnore. Në këtë kontekst, termat e tillë ngajnë me frazën *Allahu Ekber*.

Me modelin e saj morfologjik “*fu’lan*”, termi “*subhan*” është një emër verbal i pazakontë. Sikurse termi “*subbuh*”, edhe ai ka efektin e lartësimit të personit për të cilin flet, për ta shpallur atë të jetë “mbi” një cilësi ose veprim të caktuar. Prandaj, kur themi, “*subhane rabbija*”, po themi, në fakt: “Zoti im është i paqortueshëm ose i lirë nga...” (*unazzihu rabbi’an...*). Atëherë shtrohet pyetja: “Për ç’cilësi dhe veprime e mbaj Zotin tim të paqortueshëm apo të lirë?” Përgjigjja e kësaj pyetje nuk përmendet në formulat e lavdërimit të shprehura gjatë rukusë dhe sexhdes së namazit. Në vend të kësaj, ato mbeten të hapura, të pamjaftueshme gjuhësisht dhe të pasuara nga një hapësirë semantike të cilën jemi të lirë ta plotësojmë me çdo gjë që zgjedhim. Në lidhje me këtë, këto dy fraza janë si *Allahu Ekber* e hapur, sikur të thoshim, për shembull, *Subhane rabbije el-a’la*, *Subhane rabbije el-adhim*, që është: “I Dëllirë është Zoti im më Madhështor; I Dëllirë është Zoti im më i Lartë,” ... mbi papërsosmërinë, turpin, lodhjen, padrejtësinë, gabimin, dobësinë, gjumin, sëmundjen, etj.

Namazi përmban fraza të shumta që gramatikisht dhe semantikisht janë të paplota dhe të cilat, për këtë arsye, janë të hapura për një mori mundësish. Çu d itërisht, megjithatë, ato ndeshen krah-për-krah me frazat që janë të plota, por që janë të hapura për arsye të tjera. Ky lloj i fundit i frazës ndodh shpesh në *Fatiha*, për shembull, si dhe në përsëritjet dhe lutjet e formuluara që formojnë një pjesë të namazit.

Në rrjedhën e çdo çifti rekatesh të namazit, shprehim jo më pak se tridhjetë e tri shprehje që janë gjuhësisht jo të plota. Ajo që dua të them është se kemi tridhjetë e tri “hapësira të hapura” të cilat mund t’i mbushim me imagjinatën tonë dhe të cilat na lejojnë kohë të mjaftueshme për t’i marrë kuptimet e tyre dhe për t’i bërë ato të pranishme në mendjet tona. Ky numër nuk

përfshin *Fatiha*-n, përshëndetjet dhe lutjet e shprehura për dhe në emër të Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe të tjerëve. As nuk përfshin ajete të tjera ose lutje tradicionale që mund të jenë pjesë e namazit tonë. Tridhjetë e tri shprehjet e hapura që formojnë një pjesë të çdo namazi janë të detajuara si më poshtë:

1. Njëmbëdhjetë shprehjet: *Allahu Ekber* - Allahu është më i madh...: më i madh se çfarë?
2. Dy shprehjet: *Semi'a Allahu li men hamideh* - Allahu e dëgjon atë që e falënderon: kush e falënderon Atë dhe për çfarë?
3. Dy shprehjet: *Rabbena ve leke el-hamd* – Zoti ynë, Ty të takon falënderimi: falënderimi për çfarë?
4. Gjashtë (2 ruku x 3) shprehjet: *Subhane rabbije el-adhim* – I Dëllirë është Zoti im më Madhështor: më Madhështor se çfarë?
5. Dymbëdhjetë (4 sexhde x 3) shprehjet: *Subhane rabbije el-a'la* – I Dëllirë është Zoti im më i Lartë: më i Lartë se çfarë?

Shpeshësia e shfaqjes së fjalëve të tilla të hapura, jo të plota gjuhësisht, tregon rëndësinë e elementit imagjativ për përdorim më të mirë të shumëllojshmërisë që shënon namazin, për të mbajtur nivelin më të madh të nderimit të përlulur, për të kultivuar mirëkuptimin dhe ndërgjegjësimin për atë që njeriu jep si adhurues dhe, për rrjedhojë, duke bërë kontakt të sinqertë me Zotin.

Megjithatë, është e rëndësishme të bëhet dallimi në mes të asaj që e quajmë një shprehje të hapur, por gjuhësisht të plotë, dhe një shprehjeje "të hapur dhe gjuhësisht jo të plotë". Çdo shprehje gjuhësore jo e plotë është gjithashtu shprehje e hapur; megjithatë, jo të gjitha shprehjet e hapura janë gjuhësisht jo të plota.

Shprehjet: *Subhane rabi* (Zoti im është i Lartë), *Semi'a Allahu li men hamideh* (Allahu e dëgjon ata që e falënderon) dhe *Rabbena ve leke el-hamd* (Zoti ynë, Ty të takon falënderimi), për shembull,

janë gjuhësisht jo të plota. Si rezultat, ato ndiqen nga një lloj “hapësire horizontale” e cila mund të plotësohet në mënyra të ndryshme. Sa për termat ose shprehjet e hapura që i gjejmë në *Fatiha*, nga ana tjetër, ato janë të kompletuara gjuhësisht dhe gramatikisht, dhe për këtë arsye nuk kanë nevojë për plotësim horizontal; megjithatë, ato i nënshtrohen më shumë se një interpretimi. Duke marrë parasysh këto interpretime të ndryshme të mundshme, ato janë shprehje të hapura. Megjithëkëtë, shtesat ndaj të cilave ato janë të hapura janë “vertikale” në kuptimin se ato plotësojnë thellësinë semantike, pavarësisht plotësisë gramatikore të frazës. Ky lloj fraze ose termi me shumë shtresa mund t’i përngjasojë një ndërtesë disakatëshe ose disaniveloze, secila prej të cilave ka përmbajtjen, aromën dhe ngjyrën e saj të dallueshme.



## KAPITULLI 18

### Roli i *Fatiha*-s

Keni vrarë mendjen ndonjëherë pse *Fatiha* nuk është thjesht surja ose kapitulli hapës i Kur'anit, por është gjithashtu vetë hapësja e namazit? Në fakt, *Fatiha* mund të mendohet të jetë vetë namazi. Sipas fjalëve të Zotit të Plotfuqishëm të komunikuar përmes Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i Madhërishmi thotë:

*E kam ndarë namazin (d.m.th. Fatiha-n) mes Meje dhe robit Tim.*<sup>27</sup>

Keni soditur ndonjëherë mbi këtë namaz, si një lloj besëlidhjeje e shenjtë midis dy palëve: adhuresit (Pala 2) dhe të Adhuruarit (Pala 1)? Sipas kësaj marrëveshjeje, Pala 2 i premtun Palës 1: lëvdata dhe falënderime të vazhdueshme: "*El-hamdu lilahi* – Falënderimi i takon Allahut," pranim të sundimit dhe sovranitetit: "*Rabil-alemin* –

---

27 Me fjalë të tjera, pjesët e *Fatiha*-s që përfshijnë falënderimin e Allahut ("*Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve*") dhe pohimit të mëshirës së Tij ("*Mëshiruesit, Mëshirëbërësit*") kanë të bëjnë me Allahun; ndërkohë që shprehjet e adhurimit ("*Vetëm Ty të adhurojmë*") dhe kërkesës për ndihmë ("*Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë*") dhe udhëzimit ("*Na udhëzo në rrugën e drejtë*") përfshijnë robët e Allahut.

Zotit të botëve,” pranim të mëshirës së Tij të vazhdueshme: “*Er-Rahman er-Rahim* - Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tani dhe përgjithmonë,” sundim mbretëror dhe qeverisjes absolute të universit në Ditën e Ringjalljes: “*Maliki jevmid-din* - Sunduesit të Ditës së Gjykitimit (përgjegjesisë-shpërblimit),” shërbesë të dëgjueshme dhe dorëzim përballë Njeshmërisë së Tij: “*Ijake na’budu* - Vetëm Ty të adhurrojmë.” Në këmbim, Pala 1 i premtos Palës 2 që ta ndihmojë në të gjitha çështjet: “*Ijake neste’in* - Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë,” ta udhëzojë në këtë fushë tokësore në rrugën e drejtë: “*El-sirat el-mustekim* - Në rrugën të cilët Ai i udhëzon dhe i begaton robët e Tij të dashur,” dhe ta mbrojë nga fati i atyre që kanë fituar pakënaqësinë e Tij: “*El-magdubi alejhim* - Atyre që kundër vetes tërhoqën hidhërimin,” si dhe fati i atyre që humbën veten: “*Ed-dalin*” duke mos e adhuruar më Allahun në Njeshmërinë e Tij të vërtetë.

Ndërsa e këndon *Fatiha*-n, keni menduar ndonjë herë se ajo nuk është një fjalim i zakonshëm njerëzor: se ndryshon jo vetëm nga arabishtja e përdorur në jetën e përditshme, por edhe, duke u bazuar në të gjitha narrativet që kanë ardhur tek ne, nga ajo e përdorur prej vetë Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në ditët e tij?

Çfarë do të thoshit sikur t’ju tregoja se *Fatiha*, e cila përbëhet nga njëzet e nëntë fjalë në arabishten origjinale, përmban jo më pak se pesëdhjetë e tetë fenomene gjuhësore me të cilat arabët e ditës së Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk ishin të familjarizuar përpara shpalljes së Kur’anit? Këto karakteristika të reja gjuhësore ishin të huaja edhe në gjuhën e përditshme të të Dërguarit të Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], përjashtim të vetëm bënin vendet të cilat ai i citonte nga vetë Kur’ani.<sup>28</sup>

Mundohuni ta mbani mend gjithë këtë, kur e këndon *Fatiha*-n në namaz. Për t’i sjellë kuptimet e saj më afër zemrës dhe për ta përqafuar shpirtin e fjalëve të saj, përpiquni të imagjinoni

28 Për një diskutim më të detajuar mbi këtë çështje, referojuni seksionit mbi *Fatiha*-n në pjesën e dytë të librit tim “*El-Mu’xhize*” (Washington, DC.: IIIT, 2015), f. 51-92.

se vetë ju jeni duke nxjerrë fjalët nga mendja juaj. Imagjinoni sikur vetë ju po e formuloni atë, por pa harruar se ajo është vetë-shprehje e pakrahasueshme dhe e paimitueshme e Allahut. Nëse mund ta bëni këtë, do të filloni t'i ndjeni fjalët që dalin nga brenda dhe do ta ndjeni zemrën duke rrahur me ritmin e tyre. Do të ndjeni se po shprehni fjalë, të cilat me të vërtetë i mendoni dhe të cilat e pasqyrojnë atë që me të vërtetë e besoni, e jo thjesht të papagalloni fjalë të thëna nga dikush tjetër, të cilat nuk i kuptoni vërtet dhe nuk sjellin përgjigje të brendshme nga ana juaj.

Nëse e kaloni këtë test, do ta keni marrë hapin e parë në rrugën drejt të kuptuarit vlerën e çdo fjale të kësaj kaptine të veçantë, duke e përjetuar madhësitinë e çdo fraze dhe duke mishëruar kuptimet e mrekullueshme që ajo transmeton.

Gjithnjë mbani mend se kjo kaptinë kur'anore ka rëndësi të veçantë. Pa marrë parasysh se çfarë kaptinash ose pasazhesh tjera ndodh t'i këndonin në namaze, asnjëra prej tyre nuk mund të zë vendin e *Fatiha*-s. Edhe nëse e këndonin çdo kaptinë të Kur'anit në një namaz të vetëm, por pa e kënduar *Fatiha*-n, do të ishte sikur të mos ishit falur fare. Mund t'ju jenë dhënë nderime etribute për këndim tuaj, por jo edhe për namazin. Ashtu siç Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njëherë tha:

*Asnjë namaz nuk i atribuohet atij që nuk e ka kënduar suren e hapjes së Librit të Shenjtë (d.m.th. Fatiha-n).<sup>29</sup>*

## NË EMËR TË ALLAHUT, MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT, TANI DHE PËRGJITHMONË (*BISMILAH* ER-RAHMANI ER-RAHIM)

*Besmeleja* – fraza: “*Bismilah Er-Rahman Er-Rahim*” - është një nga ajetet më të bukura në Kur'an, nëse jo më e bukura nga të gjitha.

29 Transmeton Buhariu nën autoritetin e Ubejd bin el-Samitit.

Megjithatë, përsëritja, zakoni dhe familjarizmi e kanë zbehur bukurinë e saj tek ne. E përsërisim atë sikur të ishte thjesht një frazë mirësjelljeje, si: “faleminderit”, “pardon” dhe “lamtumirë”. Por, le ta pyesim veten: Përse Zoti i botëve e zgjodhi këtë si ajetin e parë që e përsërisim në namaz? Përse është fjala me të cilën çilet Kur’ani? Përse ajo prezanton tek të gjitha, pos te njëra prej sureve të Kur’anit? Dhe pse ajo është pjesë përbërëse e *Fatiha*-s?

Fakti që e shqiptojmë shprehjen: “*Bismilah Er-Rahman Er-Rahim* - Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tani dhe përgjithmonë,” teksa fillojmë të falim namaz, ndërsa fillojmë të këndojmë Kur’an dhe në fillim të pothuajse secilës prej kapitave kur’anore, për të mos përmendur faktin se jemi mësuar ta shprehim atë sa herë që fillojmë ndonjë veprim në jetën tonë të përditshme, kjo na e ka dhënë iluzionin se *besmeleja* nuk do të thotë asgjë më shumë se fillimi i një detyre të re. Në fakt, gjuhëtarët arabë kanë rënë pre e të njëjtit iluzion. Ata, rrjedhimi sht, kanë bërë shumë pak përpjekje për të identifikuar foljen e nënkuptuar ose aktualitetin me të cilën e shoqërojnë parafjalën (arabisht, *bi*, anglisht “in” ose shqip “në”) dhe rasën gjinore (*maxhrur*), e cila e pason atë (fjala arabe për “emrin”, *ism*, është në rasën gjinore, sepse pason një parafjalë). Disa gjuhëtarë mendojnë se veprimi ose rasti i implikuar në të është: “Unë filloj,” me kuptimin e plotë të frazës: “Në emër të Zotit filloj - (*Bismilahi abda’u*).” Kështu, ata mund ta kenë zgjidhur një rebus gramatikor; megjithatë, nuk kanë bërë asgjë për ta sqaruar kuptimin e vërtetë të frazës.

Fakti që *besmeleja* gjen shtrirje kaq të shpeshtë në prezantimin e një vepre ose një teksti të shenjtë, ka krijuar iluzionin se, në thelb, ajo është thjesht një gjë e tillë - një parathënie për diçka tjetër. Megjithatë, mesazhi më i rëndësishëm i *besmeles* është se çdo deklaratë kur’anore që e pason atë, qoftë ai një urdhër ose një ndalesë, një premtim ose një kërcënim, një përshkrim ose një raport, një nxitje ose një rikujtues, do të komunikohet në emër të Zotit dhe nga autoriteti i Tij.

Qeniet njerëzore janë mëkëmbësit ose përfaqësuesit e Zotit në Tokë (shih El-Bekare: 30). Pra, ndërsa ata përgatiten t'i këndojnë Fjalët e Atij që i ka bërë përgjegjës për tokën, dhe ndërsa përpiqen t'i riprodhojnë këto Fjalë në formën në të cilën u shpallën së pari, duhet t'i vetëdijesojnë dhe t'i rikujtojnë dëgjuesit, se po i këndojnë ato në emër të Zotit, nga autoriteti i Tij dhe në cilësinë përfaqësore të Tij në Tokë.

Kur një gjyqtar nis një aktgjykim me fjalët: "Në emër të popullit," ai lëshon vendime në emër të popullit dhe në cilësinë e tij si përfaqësuesi i tyre ose si një, të cilin ata e kanë caktuar për ta kryer një detyrë të caktuar, pasi ai derivon autoritetin e tij prej tyre dhe vendimet e tij bëhen në përputhje me ligjet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, kur e fillojmë këndimin e *Fatiha-s* me fjalët: "Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tani dhe përgjithmonë," – kjo shërben si përkujtues për ne, se çfarëdo mësimë qiellore ose udhëzime që përcjellim, do t'i përcjellim me fuqinë dhe autoritetin e Zotit. Nëse, me gjuhëtarët, pohojmë se *besmeleja* implikon një grup foljor paraprak, por të papërcaktuara, siç është: "Unë filloj..." (ku deklarata e plotë do të bënte: "Në emër të Allahut filloj," ose "Filloj në emër të Allahut"), e kursejmë veten nga bezdisja për të hulumtuar dhe eksploruar. Në të njëjtën kohë, mbyllim një horizont dhe harrojmë kuptimin më të rëndësishëm dhe themelor të frazës.

Kur e filloj namazin me *besmele*, kjo duhet të shërbejë si një rikujtues se ajo në të cilën jam gati për t'u angazhuar, është më shumë se një sërë lëvizjesh pa menduar, ose për më tepër, është përsëritje e linjave të memorizuara që nuk kanë asnjë lidhje me pjesën tjetër të qenies sime. Përkundrazi, është një veprim i sinqertë i komunikimit me Allahun, në të cilin mbaj besëlidhjen midis nesh dhe pohoj dëshirën për të qenë mëkëmbësi dhe përgjegjësi i Tij besnik në Tokë.

Njëkohësisht, kur e paraqes *besmelen* në faqen e parë të këtij libri, ajo vepron si një rikujtues për mua ndaj Zotit të botëve



dhe si një pohim i imi për Të, se gjithçka brenda librit, nga fillimi e deri në fund do të jetë në përputhje me besëlidhjen mes nesh. Kjo do të thotë se për çdo fjalë që libri përmban, nga fillimi e deri në fund, kërkoj kënaqësinë e Allahut, i përmbahem urdhrave të Tij, i respektoj kufizimet që ka vendosur Ai dhe i përmbahem kushteve që Ai ka parashtruar për përdorimin legjitim të autoritetit tokësor të investuar në mua. *Besmeleja* është një dokument që pohon se ju jeni thjesht mëkëmbës të Allahut në këtë sferë tokësore. Nuk ka asnjë rregull ose autoritet, përveç Allahut. Nuk ka kamje as pasuri, pos që i përket Allahut. Nuk ka ushqim e s'ka as pije, pos që Allahu është Burimi i tyre. Ne, qeniet njerëzore, u dërguam nga Mbretëria Qiellore në këtë vend të vogël të njohur si “Planeti Tokë” - i cili pa dyshim është vetëm një nga miliarda e miliarda çifligjesh të tjera, të mëdha dhe të vogla, të shpërndarë në këtë univers të gjerë - për t'i menaxhuar punët e saj në emër të Pronarit të saj dhe për t'i zbatuar dispozitat e kontratës mes nesh, të cilave do t'u vijë fundi së shpejti. Pra, a jemi të përgatitur për largimin tonë të afërt? A jemi të përgatitur për t'u paraqitur para Pronarit me librat e llogarive në duart tona?

Megjithatë, historia e *besmeles* nuk mbaron këtu. Ky “ekskluzivitet dhe privilegj” ose kontrata e përfaqësimit mund të kishte përfunduar me fjalët: “Në emër të Allahut – *Bismillah*.” Në vend të kësaj, Allahu i Plotfuqishëm e lidhi atë me një shtojcë, e cila shërben si një pjesë e pandashme e saj, d.m.th. fjalët: “Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tani dhe përgjithmonë - *Er-Rahman Er-Rahim*.” Lidhja konsistente e dy fjalëve *Er-Rahman* dhe *Er-Rahim*, të dyja prej të cilave rrjedhin nga një rrënjë e vetme, në *besmele* (“kontrata e përfaqësimit” midis nesh dhe Allahut), dhe pozita e *besmeles* në fillim të dy mjeteve më të rëndësishme të komunikimit ndërmjet muslimanëve dhe Zotit të tyre - namazit dhe Kur'anit - përcjellin disa mesazhe.

*E PARA:* Për shkak se, siç na thuhet në një thënie hyjnore që transmetohet përmes Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve

sel-lem]: “*Mëshira ime i ka paraprirë (e ka tejkaluar) Hidhërimin Tim*”. Allahu zgjodhi që ne t’i fillojmë namazet me këtë emër të veçantë të dyfishtë. Kjo zgjedhje nga ana e Zotit bëhet e qartë me faktin se jo më pak se 113 nga 114 kapitujt e Kur’anit fillojnë me *besmele*, dhe kjo përkundër faktit se të dy Emrat Hyjnorë që ajo përmban, rrjedhin nga e njëjta rrënjë. Vini re se nuk ka shumëllojshmëri në çiftet e Emrave Hyjnorë që përdoren për të filluar sure të ndryshme të Kur’anit; me fjalë të tjera, *besmeleja* nuk zëvendësohet asnjëherë me ndonjë çift tjetër të Emrave/Atributeve Hyjnorë. Nuk gjejmë, për shembull, një kaptinë kur’anore të paraqitur nga një çift Emrash Hyjnorë që do të balanconin mëshirën me ashpërsinë, dhe kjo pavarësisht faktit se këto çifte përsëriten shpesh në Kur’an dhe pavarësisht nga disponueshmëria e modaliteteve çiftore që tregojnë etimologji të tjera të kundërta, si në shprehjen të cilën e përshkruan Allahu, si: “*Ai i Gjithëfuqishmi (t’i ndëshkojë) po edhe i Mëshirshmi*.” (Esh-Shu’ara: 9) Ose: “*Ai është Ngadhënjyesi, Mëkatfalësi*.” (El-Mulk: 2)

*E DYTA*: Për shkak se atributet e dyfishta të Emrave *Er-Rahman* dhe *Er-Rahim* kanë një rëndësi kaq të madhe, duke qenë pjesë themelore e namazit dhe një parathënie për çdo këndim kur’anor, ato përbëjnë një shtyllë të mësimëve doktrinale të Islamit. Prandaj, nëse jeni të denjë për të qenë məkëmbës të Allahut në Tokë, kjo shtyllë e mësimit islam duhet të jetë e dukshme në sjelljet dhe qëndrimet tuaja.

*E TRETA*: Për shkak se jeni emëruar məkëmbës të Allahut në Tokë, duke qenë Ai “Mëshiruesi, Mëshirëbërësi, tani dhe përgjithmonë”, kjo kërkon që, në përputhje me këto dy përshkrime të zgjedhura nga Vetë Hyjnorë, të jeni məkëmbës në kapacitetet më të mira. Marrë parasysh përdorimin e vazhdueshëm dhe këmbëngulës të Kur’anit mbi këto dy përshkrues për Zotin, duhet të ngriheni vazhdimisht në sfidën që ju është dhënë duke qenë mishërimi i mirësisë dhe i dhembshurisë. Nëse jeni muslimanë, atëherë bota duhet të shohë - në mirësinë e karakteristi-

kave tuaja, ngrohtësinë e buzëqeshjes suaj, ndjeshmërinë e ndërveprimit tuaj ndaj të afërmeve të afërt dhe atyre të largët, dashurinë dhe durimin tuaj me miqtë dhe armiqtë - kuptimin e vërtetë të mirësisë dhe dhembshurisë, gatishmërinë për të falur dhe gatishmërinë për t'i përqaftuar të tjerët.

Pra, mund të pyesni veten: A është ky imazhi i Islamit që pasqyrohet në jetën tonë sot?

ER-RAHMAN ER-RAHIM:  
“MËSHIRUESI, MËSHIRËBËRËSI, TANI DHE  
PËRGJITHMONË”

Megjithëse Emrat *Er-Rahman* dhe *Er-Rahim* bazohen në rrënjën trilaterale *r-h-m*, nga e cila nxjerrim fjalën për mëshirë ose dhembshuri (*rahmeh*), megjithatë ato ndjekin dy modele të dallueshme morfologjike: *fa'lan* dhe *fa'il*. Rrjedhimisht, secila prej tyre ka karakterin dhe personalitetin e saj të dallueshëm. Modeli *fa'lan* i mbiemrit ka tendencë të mbajë një ndjenjë të menjëhershme dhe të përdoret për të folur rreth diçkaje që ndodh tani, në këtë çast. Ajo ilustron në mbiemrat arabë: *atshan* - “i etur”, *ghadban* - “i zemëruar”, *sahran* - “i zgjuar, vigilent” dhe *farhan* - “i gëzueshëm”, secili prej të cilëve përshkruan një gjendje aktuale. Dikë që e përshkruajmë si *atshan*, ai ka etje tani, por nuk mund të mbetet i etur edhe për shumë kohë. Ngjashëm, dikë që e përshkruajmë si *ghadban* ose “i zemëruar”, ai nuk do të vazhdojë të jetë i zemëruar. Prandaj, *Er-Rahman*, i përkthyer ndryshe si “Më i Mëshirshmi”, “Mëshirëploti” dhe “Më Përdëllyesi”, është Ai, mirësia, mëshira, dhembshuria dhe dashuria e të Cilit derdhen mbi ju nga lart “tani”, do të thotë, në çastin në të cilin shprehni fjalën *Er-Rahman*. Si i tillë, termi *Er-Rahman* përcjell një ndjenjë të menjëhershme dinamike, sikur fuqia shpirtërore të zgjerohej vertikalisht nga

Qielli në Tokë. Me përdorimin e këtij atributi, ndjejmë mëshirën, dhembshurinë dhe dashurinë hyjnore që lëvizin drejt nesh, duke zbritur drejtpërdrejt tek ne, duke sjell freskim të menjëhershëm nga lart. Pra, kur e thoni këtë fjalë, bëni që një pikë e mëshirës të zbres si një ujëvarë që ju mbulon, duke ju shpëlarë nga koka deri te këmbët me mëshirën e plotfuqishme të Zotit.

Sa i përket termit *Er-Rahim*, i cili ndjek modelin morfologjik *fa'il*, ai synon të përcjellë një ndjenjë të qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë me kalimin e kohës. Prandaj, një person bujar (*kerim*) është bujar nga natyra; bujaria është një tipar i qëndrueshëm i karakterit të atij personi. Në mënyrë të ngjashme, një person dorështrënguar (*bakhil*) është koprrac nga natyra, dhe kështu e demonstroi këtë cilësi vazhdimisht gjatë kohës, ndërsa individi vulgar, i paedukuar (*wadi*) është i paedukuar jo vetëm në rrethana specifike, por kudo që ai e gjen veten. Prandaj, kur flasim për Allahun si *Er-Rahim*, themi se Ai është, mëshira e të Cilit na përfshin në të gjitha kohët, dhe se ashtu siç Allahu ishte i mëshirshëm dhe i dhembshur në të kaluarën, po ashtu është i mëshirshëm dhe i dhembshur në të tashmen dhe do të jetë kështu në të ardhmen. Mëshira dhe dhembshuria janë të qëndrueshme, karakteristika të përhershme të karakterit të Allahut, i Cili ka qenë i mëshirshëm, i dhembshur dhe i dashur për gjithë përjetësinë dhe do të vazhdojë të jetë i tillë për gjithë përjetësinë. Prandaj, mund të themi se me përmasën e saj të zgjeruar, "horizontale", përshkruesi *Er-Rahim* plotëson fjalën *Er-Rahman* me përmasën e saj të menjëhershme, "vertikale".<sup>30</sup>

Përshtatshmëria e dallimit që kam tërhequr mes këtyre dy Atributeve Hyjnore dhe përmasave të tyre përcaktuese, konfirmohet nga mënyra me të cilën vetë i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i këndonte ato.

30 Për detaje të mëtutjeshme, referojuni diksutimit mbi *Fatiha*-n në librin tim "*El-Muxh'ize*", pjesa 2, f. 51-92.

Enesi ishte pyetur një herë: “Si këndonte [Kur’an] i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]?” Ai ishte përgjigjur: “Këndonte duke i nxjerrë fjalët (*kanat kira’atuhu maddan*.)” Pastaj [në demonstrim të mënyrës së këndimit të Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]], i këndoi frazat: “*Bismilah Er-Rahman Er-Rahim*,” duke thënë: “Ai e zgjaste frazën: “*Bismilah* - Në emër të Allahut.” Dhe e vepronte të njëjtën gjë me emrin *Er-Rahman* dhe me emrin *Er-Rahim*.””<sup>31</sup>

Akti i nxjerrjes së shqiptimit të frazës *Er-Rahman* dhe frazës *Er-Rahim*, përkundër faktit se asnjëra nga to nuk përmban asnjë nga veçoritë që, bazuar në rregullat e *texhvidit*, do të kërkonin zgjatje të tillë, i jep secilës prej tyre një lloj autonomie dhe një dallueshmëri të vetën. Duke rritur distancën kohore midis një fraze dhe tjetrës, kjo mënyrë e këndimit vepron për ta ndarë përshkruesin e parë nga ai që e ndjek atë. Për më tepër, ndarja nënkupton autonominë dhe unikalitetin në kuptim dhe orientim.

---

31 Transmeton Buahriu nën autoritetin e Katades.



## KAPITULLI 19

### Nr. 2: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë” - *Ijake na'budu ve ijake neste'in*

Imagjinoni një njeri të cilit i është bërë padrejtësi në një farë mënyre dhe i tilli ka vajtur në një zyrë qeveritare me shpresën për t'i kërkuar të drejtat e tij. Hyn brenda për ta takuar ndonjë punonjës të qeverisë dhe paraqet kërkesën e tij. Punonjësi, nga ana tjetër, i thotë hallexhiut që ta plotësojë një formular të caktuar, ta vendosë atë një zarf të firmosur dhe ta dërgojë në agjencinë qeveritare përkatëse, në mënyrë që rasti i tij të kalojë nëpër kanalet e duhura. Dhe sapo zyrtari i autorizuar ta vlerësojë kërkesën dhe ta marrë një vendim për rastin e tij, hallexhiut nuk do t'i ngelet zgjidhje tjetër veçse ta pranojë rezultatin, qoftë i drejtë ose i padrejtë, i ndershëm ose i pandershëm. Pastaj, krahasoni gjendjen e këtij njeriu me atë të një individi tjetër, më fatlum, i cili është një i afërt i ngushtë personal i zyrtarit të lartpërmendur, i cili ka fjalën e fundit për atë që adresohet nga çdo kërkesë e peticioni i paraqitur në agjenci dhe që, për më tepër, është

njeri i drejtë, i zgjuar, me integritet të patëmetë që nuk i bën pa-drejtësi askujt, assesi.

Megjithëse asgjë dhe askush nuk mund të krahasohet me Zotin e Plotfuqishëm, i Cili është mbi dhe përtej të gjitha kategorive të mendimit njerëzor, thënia: *“Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë,”* megjithatë pasqyron një situatë që ka ngjashmëri me atë që sapo e përkrova. Kur keni të bëni me Vetë Zotin e Plotfuqishëm, ankesa juaj nuk duhet të dëgjohet nga ndonjë punonjës i vogël dhe nuk ju kërkohet të parashtroni një peticion formal nëpërmjet “kanaleve të duhura”. Në vend të kësaj, jeni të lejuar - në fakt, jeni të urdhëruar - që t’i adresoheni *“Zyrtarit në detyrë”* drejtpërdrejt, dhe t’i kërkonit çfarëdo që ju nevojitet. Jo vetëm kaq, por ky *“Zyrtar”* ju jep formularin që Ai dëshiron ju ta përdorni për ta bërë kërkesën tuaj. Përmes vërtitjes sëtributeve me të cilat Ai e ka përkruar Veten e Tij - në vargjet e hapjes së *Fatiha-s* - nëpër buzët tuaja, ua jep mundësinë të pohoni se jeni rob i Tij dhe se Ai është Zoti juaj; se Ai është përgjegjës për ju dhe për përmbushjen të gjitha nevojave tuaja: *“Vetëm Ty të adhurojmë.”* I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njëherë tha:

*Zoti i Plotfuqishëm thotë: “E kam ndarë namazin - domethënë Fatiha-n - në mënyrë të barabartë ndërmjet Vetes dhe robit Tim. Gjysma e saj është për Mua, ndërsa gjysma tjetër për robin. Për më tepër, robi Im do të marrë gjithçka që ai / ajo kërkon. Kur robi thotë: “Falënderimet i takojnë Allahut - El-hamdul lilahi rabbil-alemin,” do të them: “Im rob më ka falënderuar.” Kur robi thotë: “Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, tani dhe përgjithmonë - Er-Rahman Er-Rahim,” do të them: “Im rob më ka lartësuar.” Kur robi më përshkruan si: “Zot i Ditës së Gjykimit - Maliki jevmi el-din,” do të them: “Im rob më ka glorifikuar.” Kur robi thotë: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë - Ijake na ‘budu ve ijake neste ‘in,” do të them: “Ky [ajet] është i ndarë mes Meje dhe robit Tim. Përveç kësaj, Im rob do të marrë gjithçka që ai kërkon.” Kur robi thotë: “Udhëzoni (përforconi) në rrugën e drejtë - Ihdinas sirata el-mustekim,” “..në rrugën e atyre, të cilët i begatove*

me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten! - *Sirata el-ledhine en'amte alejhim gajri el-magdubi alejhim ve led-dalin,*" do të them: "Kjo është për Tim rob dhe Im rob do të marrë gjithçka që ka kërkuar."<sup>32</sup>

Tani jemi në pikën qendrore të ajetit i cili është, në anën tjetër, pika qendrore e *Fatiha*-s. Kjo pikë qendrore ose ky mes shënon fundin e seksionit të parë, i cili karakterizohet nga ngritja e afirmimit, lëvdimit dhe adhurimit të Allahut në adhurim: "*Vetëm Ty të adhurojmë,*" dhe fillimit të seksionit të dytë, i cili karakterizohet me lutje dhe përgjërime, ku adhuruesi i parashtron kërkesa Allahut: "*Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.*"

Kur ta arrijmë këtë pikë të tranzicionit, mund ta ndiejmë dallueshmërinë e mrekullueshme dhe të jashtëzakonshme të dy "stacioneve", të cilat bashkohen nga ky ajet ose ajet i vetëm. Rrjedhimisht, mund ta ndiejmë nevojën për të pauzuar në këndim, kur arrijmë në gjysmën e parë të ajetit: "*Vetëm Ty të adhurojmë*" para se të procedojmë në gjysmën e dytë: "*Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.*" Dhe në të vërtetë, Ali ibn Ebi Talibi [radijallahu anhu] thuhet se e ka kënduar shprehjen "të adhurojmë" (*na'budu*) në mënyrë të atillë sa që "shkronja *dal* tërhiqet deri në pikën ku gjeneron tingullin "u" të shkronjës vijuese "waw".<sup>33</sup> Kjo mënyrë e shqiptimit të fjalës *na'budu* shërben për të zbuluar dhe theksuar "personalitetet" dalluese të dy gjysmave të *Fatiha*-s ku ndodhet ajo.

Ndërsa i shprehni këto dy fraza në namaz, keni ndjerë ndonjëherë se, edhe pse ato shfaqen në një ajet të vetëm, përfaqësojnë dy qëndrime ose pozita të ndryshme, dhe se toni i adoptuar në pjesën e parë të ajetit: "*Vetëm Ty të dhurojmë*" duhet të jetë ndryshe nga toni që përdorni në të dytën: "*Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë?*" Nëse është kështu, atëherë kjo është e përshtatshme, pasi po kaloni nga seksioni që ka të bëjë me Palën 1 të kontratës (Alla-

32 Transmeton Muslimi nën autoritetin e Ebu Hurejres.

33 Abdel-Sabur Shahin, *Tarih el-Kur'an* (Kairo: Dar el-Kalem, 1961), f. 175.



hun e Plotfuqishëm) në seksionin që ka të bëjë me Palën 2 (adhuruesin).

Ndërsa këndoni fjalët: “*Vetëm Ty të adhurojmë,*” zëri juaj duhet të shënohet nga një ton nderimi, frike dhe nënshttrim ndaj fuqisë së Atij që mban jetën dhe fatin në Duart e Veta. Dhe kur të vini te fraza: “*Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë,*” toni juaj duhet të jetë një lutje e sinqertë, përgjërimit, kërkesë dhe shpresë e sinqertë ndërsa parashikoni derdhjen e mëshirës dhe ndihmës hyjnore. Dhe si mund të jetë ndryshe kur e dini se jeni duke u dëgjuar nga i Plotfuqishmi, i Cili nëse është kundër jush, s’ka kush që mund t’ju shpëtojë dhe i Cili, nëse është me ju, s’ka kush që mund të qëndrojë kundër jush?

Është mbi këtë ajet, që më i Besueshmi i Premtuesve ua ka premtuar robërve të Tij adhurues, premtimet më të mrekullueshme, duke thënë: “*Dhe Im rob do të marrë çfarëdo që ai / ajo ka kërkuar.*” Prandaj, kur thoni: “*Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë,*” bëjeni këtë me besim të plotë se ndihma që kërkonte është me të vërtetë e juaja. Bëjeni këtë me besimin e adhuruesit, i cili, kur doli në një ditë të vapë, i etur për ta falur namazin e shiut me një grup bashkëbesimtarësh, u kthye duke mbartur një ombrellë nën krahet e tij.

## UDHËZONA (PËRFORCONA) NË RRUGËN E DREJTË

Tani që u janë hapur dyert e lavdërimit dhe e keni falënderuar Allahun fuqimisht; tani që dyert e mëshirës u hapën dhe në to hyni me kënaqësi dhe përulësi; tani që u është dhënë mundësia të kërkonte dhe keni kërkuar plotësisht, Zoti i botëve ka vënë në gjuhët tuaja kërkesën më të madhe që mund të bëhet ndonjëherë në këtë botë: kërkesën për t’u udhëzuar në rrugën e drejtë. Ka ndonjë gjë që ia keni më shumë frikën se sa lajthitjes nga rruga e drejtë?

Imagjinoni të jeni shumë të pasur, inteligjentë, të shëndetshëm dhe të lumtur siç mund të jetë ndokush, por pa qenë të udhëzuar me udhëzime të vërteta dhe besim në Njëshmërinë e Allahut. Më thoni, ç'dobi do të kishte lumturia juaj tokësore nëse do të ishit privuar nga lumturia në jetën e ardhshme? Çfarë janë njëqind vjet, një mijë vjet, njëqind mijë vjet ose edhe një milion vjet jetë në këtë botë krahasuar me një çast të vetëm në sferat e përjetësisë, qoftë në lumturi apo në mundim? Kur lexojmë në Kur'an:

*E veprat e atyre që nuk besuan janë si valët (nga rrezet e diellit) në një rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t'i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty e gjen Allahun dhe Ai do t'ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje. (En-Nur: 39)*

Tradita e mëposhtme, e saktësuar nga Albani dhe e transmetuar nga Ibn Maxhe nën autoritetin e Enes Ibn Malikut, pohon të njëjtën të vërtetë:

*Në Ditën e Ringjalljes, një nga jobesimtarët, i cili ishte begatuar më së shumti në këtë botë, do të sillet për gjykim. Pastaj do të thuhet: "Zhyteni filanin vetëm një herë në Zjarr." Pasi të kenë zhytur në të, ai do të pyetet: "Ke njohur ndonjëherë lumturi, o filan?" "Jo, asnjëherë!" - do të përgjigjet ai. Pastaj, njëri prej besimtarëve që ka vuajtur më së shumti në këtë botë do të sillet për gjykim dhe do të thuhet për të: "Zhyteni filanin vetëm një herë në lumin e Xhenetit." Pasi ta kenë zhytur aty, besimtari do të pyetet: "Ke vuajtur ndonjëherë padrejtësi apo shtrëngatë, o filan?" Ai do të përgjigjet: "Jo, asnjëherë!"*

Kënaqësia që e përjetojmë kur themi: "Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë," është ndryshe nga kënaqësia që ndiejmë kur, menjëherë pas kësaj, lutemi: "Na udhëzo në rrugën e drejtë." Faza e parë është zakonisht një kërkesë për ndihmë tokësore ose për furnizim, ndërsa e dyta është përgjithësisht një kërkesë që lidhet me botën që do të vijë pas. Kjo nuk e përjashton faktin që ajo

të jetë një lutje për udhëzim edhe në këtë botë, natyrisht. Frazja, “*rrugën e drejtë*” është e hapur semantikisht. Për më tepër, duke iu referuar udhëzimit Hyjnor dhe besimit në Njëshmërinë e Allahut, ajo mund t’i referohet gjithashtu mençurisë, urtësisë, lirisë së gjykimit dhe aftësisë për të krijuar mendime të mirëfillta për gjërat. Më thoni, und të ketë begati më të madhe në këtë botë sesa aftësia për të menduar mirë mbi çështjet e jetës dhe aftësia për t’i ndihmuar të tjerët ta bëjnë të njëjtën gjë?

Cilësia e hapur që e karakterizon termin “*rrugë*” (*sirat*) vlen edhe për terma të tjerë në tërë kaptinën *Fatiha*. Kush, për shembull, janë: “*ata të cilët i begatove me të mira - El-ledhine en’amte alejhim*”, “*ata që kundër veti tërhoqën hidhërimin - El-maghdubi alejhim*” dhe “*ata që e humbën veten - Ed-dalin*,” të përmendur në fund të *Fatiha*-s?

Secila prej frazave të lartpërmendura është gjuhësisht e plotë. Si e tillë, asnjëra prej tyre nuk pasohet nga një “hapësirë boshe virtuale”, e cila na nxit ta mbushim atë me imaginatën tonë. Megjithatë, nëse i krahasojmë ato me shprehje të tjera të përdorura në fjalimin e përditshëm njerëzor, cilësia e tyre e hapur bëhet e dukshme.

Që ta kuptojmë më mirë dallimin mes gjuhës së hapur dhe asaj të mbyllur, le ta lexojmë përsëri fragmentin, duke i zëvendësuar frazat kur’anore “të hapura” me frazat alternative “të mbyllura”. Pasazhi tani do të tingëllonte: “Na udhëzo në rrugën e drejtë, në rrugën e popullit “A”, jo në rrugën e popullit “B” e as në rrugën e popullit “C””. Kjo alternativë, leximi “i mbyllur”, nxjerr në pah, nga ana tjetër, pasurinë e gjuhës kur’anore, e cila na lejon ta interpretojmë shprehjen: “*ata të cilët i begatove me të mira - El-ledhine en’amte alejhim*,” sikur ajo zbatohet për çdo individ i cili është begatuar me mirësi në çfarëdo forme; na lejon t’i interpretojmë fjalët: “*ata që kundër veti tërhoqën hidhërimin - El-maghdubi alejhim*,” si referencë ndaj kujtdo që është i pakënaqur me Allahun, dhe ta interpretojmë shprehjen: “*ata që e humbën*

*veten - Ed-dalin,*" si referencë për të gjithë ata që e kanë lajthitur rrugën e tyre drejt së vërtetës. Kjo hapje nuk e anulon e as nuk e ndalon interpretimin e ofruar nga Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Megjithkëtë, ajo as nuk "i mbyll" tri shprehjet e tilla ku secila prej tyre i referohet vetëm një grupi të caktuar dhe asnjë tjetri.

Kur lexojmë ose këndojmë në namaz, "*na udhëzon në rrugën e drejtë*", është shumë e rëndësishme ta mbajmë në mend se këto dhe frazat e shumta të tjera të përsëritura në namaz, janë shpallur në një formë "të hapur" për disa arsye në urtësinë hyjnore. Është për shkak të cilësisë së hapur të këtyre frazave që, nëse i zgjedhim, mund të mendojnë për to se e përfshijnë çdo krijesë në Tokë, ashtu që, nëse duam, mund t'i ngushtojmë deri në atë masë ku vështirë se i përfshijmë madje vetë vetet tona. Duhet të vihet në dukje se kjo lutje nuk është në formën njëjës: "më udhëzo mua..." Përkundrazi, është në shumës: "na udhëzo..." Me këtë në mendje, përpiquni ta lejoni këtë lutje t'i përqafojë të gjithë të ndodhurit rreth jush, duke filluar nga fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes, fqinjët dhe të njohurit në të gjithë botën, përfshirë miqtë dhe armiqtë, muslimanët dhe jo-muslimanët. Mund të ketë gjë më të mrekullueshme se sa t'i luteni Zotit të derdhë bekimet e Tij mbi miqtë, armiqtë dhe gjithë njerëzit pa përjashtim; që t'i udhëzojë ata me mirësinë e Tij drejt të vërtetës, drejtësisë dhe "rrugës së drejtë"? Në të vërtetë, a nuk iu lut Profeti ynë [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] Allahut që ta fuqizojë Islamin me njërin prej dy (jomuslimanëve) Omerëve? Lutje e cila më vonë qe dhuratë për Islamit me kalifin e madh Omer ibn el-Hatabin [radijallahu anhu]!

Mos harroni se duke u zhvendosur nga "unë" ekskluzive në "ne" gjithëpërfshirëse, i thyejmë barrierat e urrejtjes dhe hidhërimit mes vetes dhe të tjerëve, kushdo qofshin ata. Dhe duke vepruar kështu, deklarojmë vendosmërinë tonë për t'iu përgjigjur me dashuri dhe tolerancë atyre që e glorifikojnë urrejtjen dhe të cilët u mësojnë fëmijëve të tyre që, për të qenë muslimanë, duhet t'i

urrejnë dhe t'i kenë zët të tjerët. Pra, mbajeni mend këtë rregull të artë: Jeni muslimanë, pra, përhapni dashuri dhe pranim:

*Ti (Muhamed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve. (El-A'raf: 199)*

*... e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek Allahu. (Esh-Shura: 40)*

*... e nëse nuk merrni masa, nuk ua vini veshin dhe i falni, ta dini se edhe Allahu është Mëkatfalës, Mëshirues. (Et-Tegabun: 14)*

## ZGJATIMI I ZANORES “MADD” NË FATIHA

Zgjatja e tingullit zanor, e përmendur në arabisht si “*madd*”, përbën një pauzë të shkurtër në të folur. Prandaj, ajo i jep fjalës ose frazës në të cilën tingulli zanor shfaqet, personalitetin e vet dhe një shkallë më të lartë autonomie, meqë vonesa kohore e përfshirë lejon kohë për të reflektuar dhe përfutur kuptimin e fjalës ose shprehjes në të cilën ngjan “*madd*”.

Duhet të dallojmë këtu midis pushimeve të përfunduara në këndim dhe “*madd-in*”, që është një lloj i veçantë i pushimit ose “gjysmë-pushimit”. I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pushonte plotësisht në këndimin e tij ritual para dhe pas *Fatiha*-s. Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vepronte të njëjtën gjë midis ajeteve, të cilat siguronin një “hapësirë fertile” mes një ajeti dhe tjetrit. Sa për pushimet, ose, më tepër, gjysmë-pushimet brenda ajeteve që dalin nga “*madd-i*”, ato e markojnë këndimin tonë me nderimin më të madh dhe e rrisin aftësinë tonë për t'i sjellë kuptimet e tekstit vetëdijshëm në mendje dhe për ta nxënë atë që e këndojmë. Sa për pushimet midis ajeteve kur'anore, ato na japin kohë jo vetëm për të reflektuar mbi ajetin e mëparshëm, por për të parashikuar ajetin që do të pasojë. Në mesin e njëzet e nëntë fjalëve që e përbëjnë *Fatiha*-n, kam numëruar jo më

pak se njëzet e dy raste të "madd-it". Këto, jashtë pushi m eve natyrore midis ajeteve prej të cilave janë shtatë. Prandaj, shpeshësia e pushimeve në *Fatiha* është shumë më e lartë se ajo që haset në bisedat dhe shkrimet e përditshme; bile këtë nuk e hasim në kapitujt tjerë të Kur'anit.

Rastet e njëpasnjëshme të "madd-it" në *Fatiha* përfaqësojnë një largim nga rregullat e *texhvidit* në përgjithësi. Në të vërtetë, *Fatiha* është pothuajse tërësisht e lirë nga fenomenet gjuhësore për të cilat zbatohen rregullat e *texhvidit*. Kjo përbën ende një tjetër tipar unik të *Fatiha*-s, e cila mund të na ndihmojë të zhytëmi në reflektim, dorëzim dhe nderim për Atë, në praninë e të Cilit qëndrojmë.

Nëse, për shembull, i krahasojmë rastet e "madd-it" në kaptinën *El-Keuther* (Suren nr. 108) dhe atë *El-Ihlas* (Suren nr. 112), dy nga kapitujt më të shkurtër të Kur'anit, gjejmë se në *El-Keuther*, ka tre raste të "madd-it" nga gjithsej dhjetë fjalë (në fjalët: *inna, e'tajnak* dhe *shani'eke*), ndërsa në kaptinën *El-Ihlas*, ka vetëm katër raste të "madd-it" (në fjalët: *Allahu, Allah, juled* dhe *lehu*) nga gjithsej pesëmbëdhjetë fjalë.

Ndërsa e përfundojmë këtë diskutim të veçantë, më lejoni të them përsëri se çfarëdo mendimesh, analizash dhe sugjerimesh që ofroj këtu, mbeten jo më shumë se produkte të mendjes sime njerëzore. Si të tilla, ato u nënshtrohen kritikave dhe përgënjeshttimeve. Nëse dëshmitë tregojnë se propozimet ose analizat e mia janë të pavlefshme, unë do të jem i pari që do ta pranoj autoritetin e tekstit të shenjtë dhe nuk do t'i mbështes dëshmitë mbi hipotezat e mia. Si musliman që jam, si vallë mund të veprojmë ndryshe?



## KAPITULLI 20

### Centraliteti i rukusë dhe sexhdes

Herën e parë që shkova në haxh në moshën dyzet vjeçare, u ndjeva si një çun i vogël i ngathtë, derisa po ecja, duke u sjellë rreth e rrotull Qabes. Ndërsa i bëra rrotullimet rreth Qabes, i mbështjellë në disa pëlhura të bardha, mund ta dëgjoja Shejtanin duke më pëshpëritur: “Po sikur studentët tu universitarë (dhe në mesin e tyre kishte muslimanë dhe jo-muslimanë), të të shihnin në një pamje si kjo? Ata sigurisht do të thoshin: “Ç’ka ndodhur me profesorin tonë? Ai zakonisht duket aq imponues dhe dinjitoz!”” Për fat të mirë, jo shumë kohë pas kësaj, më përshkoi një frymë besimi duke më rikujtuar se kush jam. - “Unë jam musliman, që do të thotë se jetoj në një gjendje nënshtrimi dhe bindjeje. Jam vetëm se një rob i përulur dhe i bindur. Me fjalë të tjera, nuk jam asgjë përpara të Ploftuqishmit, Gjithëfuqishmit, të Madhërishmit, Atij që zotëron qiejt dhe tokën, i Cili jep jetë dhe merr me vdekje.”

Dhe që atëherë e tutje, sa herë që i nënshtrohesha me përulësi Allahut në vepra adhurimi, i gjeja këto puhi freskuese shpirtërore të njëjta duke fryrë mbi mua. Mund t’i ndieja ato sa

herë që ulesha, sa herë që e glorifikoja Allahun dhe sa herë që e deklarova përsosjen e Tij dhe të qenit e Tij larg nga të gjitha fajet, dobësitë, padrejtësitë, papërsosmëritë, lodhshmëritë dhe pavëmendjet. I ndjeja ato derisa ngrihesha nga pozita e rukusë, duke i shqiptuar fjalët: *“Semi’a Allahu li men hamideh – Allahu e dëgjon atë që e falënderon,”* pastaj duke iu përgjigjur: *“Rabbena ve leke el-hamd – Zoti ynë, Ty të takon falënderimi,”* që më krijo-ve, më udhëzove drejt dhe m’i dhurove të gjitha bekimet që i gëzoj. I ndjeja ato derisa përulesha në sexhde dhe e lavdëroja përsëri me fjalët: *“Subhane rabbije el-a’la – i Dëlirë është Zoti im i Lartë,”* duke e deklaruar Atë të lirë nga çdo lloj papërsosjeje. Me ballin tim në pozicionin më të ulët të mundshëm në praninë e Perëndisë, ndjehesha aq afër qiellit sa s’e imagjinoja dot.

“Njëherë, e takova Theubanin, një rob të liruar të të Dërguarit të Zotit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe i thashë: “Më trego diçka, të cilën në qoftë se e veproj, Allahu do të më gradojë me Xhenet.”<sup>34</sup> Por ai nuk dha asnjë përgjigje. E përsërita pyetjen dhe përsëri nuk mora përgjigje në këmbim. Kur e pyeta për të tretën herë, ai më tha: “Ja parashtrova të njëjtën pyetje të Dërguarit të Zotit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe ai më porositi: *“Bëj sexhde sa më shpesh. Për çdo sexhde që bën, Allahu do të ta ngrejë nga një shkallë dhe do të të lirojë nga një mëkat.”*<sup>35</sup>

A e dini se disa njerëz, edhe pse e adhurojnë Allahun, vjedhin? Vjedhin mes një rukuje dhe tjetrës, një sexhdeje dhe tjetrës. Dhe, ç’është më e çuditshme, të tillët nuk vjedhin nga të tjerët, por nga vetvetja e tyre!

Para se të shpallehin dënimet hyjnore për pije intoksikuese-alkoolike, kurorëshkelje dhe vjedhje, [Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njëherë i pyeti disa nga pasuesit e tij]: *“Ç’mendonit për ata që konsumojnë pije alkoolike, shkelin kurorën dhe vjedhin?”*

34 Një lexim alternativ është: “Më tregoni se cili veprim është më i dashur për Zotin?”

35 Transmetojnë Buhariu and Muslimi nën autoritetin e Midan Ibn Ebi Talhas.



“Allahu dhe Profeti i Tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mund t'i gjykojnë ata më së miri.” – qe përgjigjja e tyre. “*Ato janë të neveritshme,*” - u tha Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], - “*dhe ka dënime të përshkruara për ta. E lloji më i keq i hajdutit është ai që e vjedh namazin e vet.*” “Dhe si mund dikush ta vjedh namazin e tij?” - pyetën shoqëruesit. “*Duke mos i kryer siç duhet ruketë dhe sexhdet.*”<sup>36</sup> – u përgjigj Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Sigurisht, ajo që aludoi Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka kuptim të përsosur. Në fund të fundit, namazi erdhi tek ne si një dhuratë nga Allahu, që është “*obligim (për kohë) të caktuar për besimtarët.*” (En-Nisa: 103), me anë të të cilit ata grumbullojnë sasi të mirësisë shpirtërore, të cilën pastaj e depozitojnë çdo ditë në llogarinë e tyre të botës tjetër. Për shumë njerëz, megjithatë, namazi është bërë një “çështje e rëndë” dhe një humbje kohe. Për njerëzit që e shohin namazin si jo të drejtë, por si detyrë, namazi nuk përbën gjë tjetër për ta veçse një sërë lëvizjesh të nxituara për t’u përfunduar sa më shpejt që është e mundur.

[Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njëherë tha]:

*Namazi përbëhet nga tri pjesë të barabarta. Pjesa e parë konsiston në arritjen dhe mirëmbajtjen e pastërtisë rituale. Pjesa e dytë konsiston në përkuljen e rucusë. Dhe pjesa e tretë përbëhet nga përlulja në sexhde. Nëse robi ia jep hakun namazit, namazi do të pranohet prej tij, ashtu siç do të pranohen edhe të gjitha veprat e tij të tjera të mira. Por, nëse namazi i të tillit nuk pranohet nga Allahu, atëherë të gjitha veprat e tij të mira do të refuzohen gjithashtu.*<sup>37</sup>

Thjesht mendoni: Nëse përkulja në ruku llogaritet si një e treta e namazit, nëse përlulja në sexhde llogaritet si një e treta tjetër dhe nëse pastërtia rituale llogaritet si një e treta e fundit, a thua si

36 Transmetuar nën autoritetin e Nu'man Ibn Murras. E saktësoi Albani në *Sahih el-Targhib*.

37 Transmetuar nën autoritetin e Ebu Hurejres. E saktësoi Albani në *Sahih el-Targhib*.

llogaritet pjesa tjetër? Vini re se rukuja dhe sexhdeja janë të vetmet lëvizje që kërkohen prej nesh në namaz. E fillojmë namazin duke qëndruar në këmbë dhe e përfundojmë në një pozitë të ulur. Përveç këtyre dy pozicioneve, të vetmet lëvizje të përfshira në namaz janë rukuja dhe sexhdeja.

Një pikë tjetër që vlen të përmendet është se i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përqendrohet në bashkimin e secilës prej këtyre dy lëvizjeve me një shprehje të hapur dhe të pasuar nga çaste reflektimi të qeta. Kur e shprehim frazën: “*Allahu Ekber* - Allahu është më i madh...,” natyra e saj e hapur kërkon që ta pasojmë atë me një kohë reflektimi të heshtur: Allahu është më i madh... se çfarë? I shqiptojmë fjalët: “*Semi Allahu li men hamideh* - Allahu e dëgjon atë që e falënderon,” pasuar nga: “*Rabbena ve leke el-hamd* - Zoti ynë, Ty të takon falënderimi,” të pasuara nga reflektimi akoma më i heshtur: Për çfarë? Në mënyrë të ngjashme, pas shprehjes së frazave: “*Subhane rabbije el-adhimi* - I Dëlirë është Zoti im më Madhështor” dhe “*Subhane rabbije el-a’la* - I Dëlirë është Zoti im më i Lartë,” duhet të ndalemi dhe ta pyesim veten: Madhështor mbi çfarë; i Lartë mbi çfarë?

Është mbi këtë bazë që rukuja dhe sexhdeja numërohen si dy të tretat e namazit. Kur shprehimisht deklaroni: “*Subhane rabbije el-adhim*” (kur përkuleni në ruku) ose “*Subhane rabbije el-a’la*” (kur përukeni në sexhde), sjellni në mendje atë që do t’ju ndihmonte ta vlerësoni madhështinë dhe madhërinë e Allahut. Në këtë mënyrë, mund t’i shndërroni fjalët e glorifikimit dhe, me të vërtetë, gjithë namazin tuaj, nga një zakon i thjeshtë në adhurim të sinqertë.

Nëse fjalët *Allahu Ekber* janë shansi juaj për ta mësuar durimin dhe këmbënguljen më të madhe, kjo do t’ju forcojë që të ballafaqoheni me vështirësitë dhe sprovat me të cilat përballeni në jetë.

Nëse fjalët: “*El-hamdu lilahi rabbi al-alemin*” dhe “*Rabbena ve leke el-hamd*” janë shansi juaj për t’i thithur bekimet dhe mirësitë e Allahut, atëherë fjalët: “*Subhane rabbije el-adhim*” dhe

“*Subhane rabbije el-a’la*” janë shansi juaj për të medituar dhe reflektuar mbi madhësinë dhe fuqinë krijuese të Allahut.

Shfrytëzojeni namazin për të mirën e jetës suaj në Tokë dhe asaj në Ahiret. Bëhuni nga ata të cilët, kur përulen në sexhde dhe shprehin fjalë glorifikuese, i gjithë trupi, mendjet dhe zemrat e tyre janë të mbushura me falënderime.



## KAPITULLI 21

### Nr. 3: “Përshëndetjet i takojnë Allahut, si dhe lutjet dhe fjalët e mira” *Et-tehijatu lilahi ve salavatu ve tajibatu*

E imagjinoni dot se ç’do të thotë ta përshëndesni Vetë Allahun? E kuptoni tani se ç’privilegj i çmuar është të jeni në gjendje të depërtoni në praninë e Tij, aty nën Pemën Kozmike (*Sidret el-Munteha*) ndërsa Ai ju shikon nga Froni i Tij i plotfuqishëm derisa ju thoni: “Përshëndetjet i takojnë Allahut, si dhe lutjet e fjalët e mira”?

Fazat e namazit që i paraprijnë kësaj, thjesht ju përgatisin për këtë hap të rëndësishëm. Qëllimi i vetëm i tyre është t’ju japin karikuesin shpirtëror që ju nevojitet për t’i kapërcyer e përshkuar kufijtë dhe hapësirat e brendshme, të cilat do t’ju sjellin aty ku jeni tani dhe ta merrni shpërblimin e jashtëzakonshëm që tani e gëzoni: të përshëndeturit Vetë Zotin. Marrë parasysh vendin e mrekullueshëm në të cilën e gjeni veten tani, jeto-

jeni momentin më të plotë. Jini plotësisht të vetëdijshëm se është Vetë Zoti, Ai që i adresoheni kur thoni: “Të përshëndes, o Allah!” Jeni “drejtpërdrejt” me Krijuesin e Universit, të Lartësuarin dhe të Madhërishmin, pa ndonjë ndërmjetës!

Edhe sikur ky takim të mos ndiqej nga një shpërblim tjetër (që është, në të vërtetë), shpërblim në vetvete, nëse e përjetoni me të vërtetë gëzimin që ky takim ofron, atëherë e keni përjetuar një kënaqësi përtej të gjitha kënaqësive, një çmim që nuk përputhet me asnjë tjetër. Fjalët e përshëndetjes që unë them janë si më poshtë:

*Et-tehijatu lilahi ve salavatu ve tajibatu.* - Përshëndetjet i takojnë Allahut, si dhe lutjet e fjalët e mira.

*Es-selamu alejke ejuhe el-nebiju ve rahmetu Allahi ve bereketuhu.*

– Paqja, mëshira dhe begatitët qofshin mbi ty, o Lajmëtar!

*Es-selamu alejna...* - Paqja qoftë mbi ne...

*...ve ala ibadilah es-salihin.* - ...dhe mbi të gjithë robërit e mirë të Allahut!

Përshëndetjet e përmbledhura më lart, në të vërtetë përbëjnë një set prej katër përshëndetjesh të veçanta, secila prej të cilave është e dallueshme nga tjetra. Në të parën, e përshëndesim vetëm Krijuesin tonë të Plotfuqishëm: “Përshëndetjet i takojnë Allahut, si dhe lutjet e fjalët e mira.” Në të dytën, e takojmë të Dërguarin e Tij të hirshëm [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “Paqja, mëshira dhe begatitët qofshin mbi ty, o Profet i Allahut!” Vetëm pas këtij takimi, fillojmë ta marrim “çmimin e madh” nëpërmjet një përshëndetjeje drejtuar vetes: “Paqja qoftë mbi ne...” Procesi i shenjtë i përshëndetjeve përfundon me një lutje për paqe: “... mbi të gjithë robërit e mirë të Allahut.”

Këto katër përshëndetje janë të ndërthurura nga një numër “hapësirash të hapura” të cilat, siç e kemi vënë re, përbëjnë një element kritik gjuhësor të namazit. Duke marrë parasysh formulimin e shtrirë e të gjerë të këtyre përshëndetjeve, koha që na

duhet për ta shprehur secilën prej tyre veç e veç, na lejon të absorbojmë importin e frazave të mëparshme dhe t'i ngjallim në mendje nuancat e tyre delikate.

Le të përfytyrojmë tani se këto lutje dhe përshëndetje erdhën të përmbledhura, në një seri me qitje-të-shpejtë: "Përshëndetjet i takojnë Allahut, paqja qoftë mbi të Dërguarin dhe mbi ne dhe mbi të drejtët." Ose, për më tepër me kuptimin ku do të mund të lexonin: "Përshëndetjet i takojnë Allahut, të Dërguarit të Tij dhe të drejtëve." Vini re se dy versionet "e përmbledhura" të sugjeruara këtu, nuk lënë asgjë jashtë nga kuptimi i synuar. Megjithatë, ato na privojnë nga dimensionet e shumta delikate që gjenden në tekstin origjinal.

Forma e shkurtuar e shprehjes që kam propozuar këtu, nuk na jep asnjë mundësi për ta hamendësuar pozicionin e jashtëzakonshëm në të cilin e gjejmë veten, për ta peshuar rëndësinë e tij dhe për t'i thithur breshëritë e bekimeve dhe mëshirës që na mbulojnë nga koka deri te këmbët. Ajo gjithashtu na drejton kah të çmuarit e menjëhershmerisë së përgjigjes hyjnore që po marrim.

Për t'i përjetuar më mirë bekimet e kësaj përshëndetje, përpikuni t'i hiqni tingujt e zanoreve nga skajet e fjalëve të caktuara, në mënyrë që t'i zgjasni ato. Mund të thoni, për shembull: *et-tehijatu... lilahi... ve salavatu... et-tajibatu...*

E njëjta qasje mund të zbatohet për përshëndetjen që ia dërgojmë të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në fjalët: "*Es-selamu alejke ejuhe en-nebi*. - Paqja qoftë mbi ty, o Profet." Kur lutemi për paqen e Allahut mbi personin më të dashur të Tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe gjithë bashkësinë muslimane, ia hapim vetes dy burime të lumturisë që nuk duhet shpërfillur. Duhet të ecim ngadalë dhe të mos vazhdojmë derisa të kemi përjetuar plotësisht ndikimin ngazëllyes të secilës frazë që kemi shprehur. Burimi i parë i lumturisë është akti i përshëndetjes së të Dërguarit të Zotit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], sikur ai të

ishite drejtpërdrejt para nesh, ndërsa i dyti është përgjigjja që marrim nga Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili rikthehet në jetë për të na e kthyer përsëritet. Siç thoshte Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “Kurdo që dikush më përsëritet, Allahu do të më rikthejë në jetë, në mënyrë që unë t’ia rikthejë përsëritet e tij të paqes.”<sup>38</sup>

Edhe më e mahnitshme dhe më e gëzueshme është vetëdija se Allahu i Plotfuqishëm bashkohet me Profetin e Tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në këtë përgjigje të hirshme. Pasi Vetë Ai, kur lutemi për ose e përsëritet Profetin e Tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], na përsëritet dhe na bekon në këmbim. Kjo është pohuar në më shumë se një thënie hyjnore që thuhet nga vetë buzët e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili tha: “Lutuni për mua sidomos ditën e xhuma. Një herë erdhi tek unë Engjëlli Xhibril dhe, duke folur në emër të Allahut, më tha: “Kurdo që një musliman në Tokë lutet për ty një herë [ditën e xhuma], Engjëjt e Mi dhe Unë do të lutemi për të dhjetë herë më shumë.”<sup>39</sup>

Ç’përsëritet paqësore! Ç’lutje! Ç’shpërblim! Mund ta imagjinoni se ç’do të thotë që Allahu të lutet për ju, dhe që miliona e miliona Engjëj të bashkohen me Të në këtë lutje nën urdhrin e Tij? E perceptoni dot se ç’mrekulli mbartin këto lutje të shenjta për bekime mbi ju? Këmbehen dhjetë lutje ndaj jush sa herë që ju luteni një herë për Profetin Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], qoftë gjatë namazit apo në ndonjë kohë tjetër.

---

38 Transmetojnë Ibn Tejmije në *Maxhmu el-Fatava* dhe Neveviu nën autoritetin e Ebu Hurejres.

39 Transmetuar nën autoritetin e Enes Ibn Malikut. Albani e klasifikoi të mirë në *Sahih el-Targhib*.



## KAPITULLI 22

### Nr. 4: “Paqja qoftë mbi ne...” *Es-selamu alejna ve ala ibadilah es-salihin*

Këto fjalë janë më shumë se sa thjesht një përshëndetje. Janë vetë simboli i një çmimi të madh, të cilin e keni fituar si rezultat i depërtimit në praninë e Zotit, përshëndetjes së Tij dhe të Dërguarit të Tij të hirshëm [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Po ta vizitonit një president ose një monark, dhe të gjenit se, me t’u larguar nga pallati ose rezidenca e tij, ai ju ka lënë një dhuratë te porta, do të habiteshit. Duke qenë nga një kryetar shteti, për më tepër, ajo nuk do të ishte dhuratë e zakonshme, pasi e pasqyron statusin e dhuruesit dhe pozitën shoqërore të tij.

Ç’dhuratë mund të prisni, pra, nga Krijuesi i mbretërve dhe presidentëve; nga Krijuesi i qiejve dhe i tokës, nëse ia ofroni Atij nderimet e juaja? I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njoftoi se do të merrnim një shpërblim ose shpërblime, për çdo përshëndetje paqeje që i japim kujtdo në Tokë. Prandaj, dhurata që do ta merrni nga Zoti i Plotfuqishëm në mënyrë të pashmangshme, do ta tejkalojë çdo gjë që mund ta kërkonit ose



mendoni, qoftë në qiell ose në tokë, që nga koha kur Ademi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u krijua deri në ditën kur njerëzit do të ngrihen nga varret.

*Nëse dikush thotë: “Es-selamu alejkum - Paqja qoftë mbi ju,” do t’i regjistronen dhjetë mirësi. Nëse dhotë: “Es-selamu alejkum ve rahmetu Allah - Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju,” njëzet vepra të mira do të regjistronen në favor të tij. E nëse thotë: “Es-selamu alejkum ve rahmetu Allahi ve bereketuhu – Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju,” tridhjetë vepra të mira do të regjistronen në llogarinë e tij.<sup>40</sup>*

Kur e fjalëzoni këtë përshëndetje të dyfishtë në namaz, do të keni një nder të dyfishtë: nderin e marrjes së paqes hyjnore të pakufizuar derisa ajo derdhet mbi ju, familjen tuaj dhe të dashurit tuaj (*es-selamu alejna*), duke ju breshëruar juve dhe ata me mëshirën e Allahut, me mirësi dhe qetësi; dhe nderin e të qenit të breshëruar me favore Hyjnor pasi jeni lutur për paqe mbi “të gjithë robërit e drejtë të Allahut”.

Përsëri, mos e harroni asnjëherë faktin që paqja që thirret në këtë lutje nuk është vetëm për ju; përkundrazi, thirret paqe mbi “ne”. Ka një botë të dallimit midis thirrjes së paqes mbi veten tuaj dhe lutjes ndaj vetes së bashku me të gjithë rreth jush: të afërmit e afërt dhe të afërmit e largët, farefisi dhe të huajt, besimtarët në mbarë botën dhe grupet e panumërta njerëzish që përfshihen në mesin e “robërve të drejtë të Allahut”.

Së fundmi, mbani mend se në të gjitha këto lutje, thjesht nuk po jepni; përkundrazi, po merrni gjithashtu. Me çdo fjalë që thoni, duhet të siguroheni që ta merrni shpërblimin tuaj pa vonesë.

Pas thënies: “*Et-tehijatu lilah* - Përshëndetjet i takojnë Allahut,” prisni dhe përjetojeni marrjen e përgjigjes. Pasi të keni

---

40 Transmetuar nën autoritetin e Suhejl Ibn Hanifit. Albani e saktësoi në *Sahih el-Targhib*.

thënë: "*Es-salavat et-tajibatu* – Paqja qoftë mbi ty, o Lajmëtar," prisni dhe përjetojeni marrjen e përgjigjes. Pas lutjes: "*Allahume Sali ala Muhamed...* - O Allahu im, bekoje Muhamedin...," prisni dhe përjetojeni marrjen e përgjigjes. Dhe pasi të keni thënë, "*...ve ala ali Muhamed* - ...dhe mbi familjen e tij," prisni dhe përjetojeni marrjen e përgjigjes.

Dhe tani, pasi e keni kuptuar, a ndiheni ende, ndërsa ngriheni për namaz, sikur po përmbushni një detyrë të cilën doni ta hiqni qafe? Apo vallë ndiheni sikur po pranoni një çmim më të madh se ç'bota mund t'ju ofrojë dhe po ushtroni një të drejtë më të mrekullueshme se ç'do mund të gëzonte dikush tjetër? Nëse nuk dilni nga namazi duke u ndjerë sikur të keni lindur përsëri, atëherë e keni humbur kuptimin e vërtetë të tij.



## KAPITULLI 23

# Sesion për lutjen dhe adhurimin e fshehtë

Lutja (arabisht, *du'a*) është një formë e thjeshtësuar e namazit. Ajo markohet nga fryma dhe shpirti i namazit, por i mungon korniza formale, protokollare, përgatitore, procedurale dhe specifike kohore. Është një lloj namazi i lehtë dhe lirë i rrjedhshëm, i cili mund të ofrohet kudo, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë.

Folësit e anglishtes, zakonisht, përdorin fjalën “prayer” për t’iu referuar të dyjave, asaj që arabët e quajnë namaz dhe asaj që quhet *du'a* ose lutje. Ky bashkim i termave sugjeron se për sa kohë që personi në fjalë i drejtohet Allahut, atëherë fjala e tij ose e saj përbën një formë të namazit. Mbase kjo ndihmon për të shpjeguar se pse gjuha që Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] adoptonte kur angazhohej në lutje, e cila i adresojte gjithmonë Allahut, ishte qartë e dallueshme nga stili i tij i rregullt i bisedës kur i adresojte të tjerëve përreth tij. Kritikët e familjarizuar me tekstet islame dhe stilet e retorikën letrare arabe të mirë-përgatitura, theksojnë se pavarësisht bukurisë dhe elokuencës së fjalës së Profetit Muhammed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në përditshmëri, gjuha që ai

[sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përdorte në lutje është gjithsesi më shumë prekëse dhe e mbushur me patos (ndjenjë të fuqishme), është më ritmike, më retorike mjeshtërore dhe më magjepsëse sesa gjuha që ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përdorte në biseda të përditshme. Në mënyrë të ngjashme, kritiku i dallueshëm mund të dallojë mes gjuhës që përdoret në thëniet e jashtme hyjnore kur'anore të transmetuara nga Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] (*el-Ahadith el-Kudsij*) dhe gjuhës që Mëshira e njerëzimit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përdorte në bisedën e përditshme.

Ashtu si hadithet *kudsij*<sup>41</sup> ashtu edhe gjuha, toni dhe ritmi i lutjeve të tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kanë një aureolë shpirtërore, sikur Qielli të merrte pjesë në formulimin e tyre. Kur u mësonte shokëve të tij lutje të tilla, i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] sigurohej që ata t'i nxënë përmendsh fjalë për fjalë, literalisht ato, dhe i paralajmëronte për rëndësinë e ruajtjes së formulimit të tyre origjinal ashtu siç ua kishte transmetuar. Pra, ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte i vendosur për këtë sakaq njëherë e korrigjoi njërin prej shokëve të tij, thjesht për zëvendësimin e fjalës “Profet” me fjalën “i Dërguar”, edhe pse të dy termat i referohen qartë të njëjtit person.

El-Bera Ibn Azibi transmetoi incidentin e mëposhtëm: “Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], njëherë herë tha:

*Para se të shkoni në shtrat, merrni abdes sikur të jeni duke shkuar për të falur namaz. Pastaj shtrihuni në të djathtën tuaj dhe thoni: “O Allah! Ty të jam dorëzuar dhe fytyrën drejt Teje e kam kthyer. Shqetësimet e mia, Ty t'i besoj dhe veten e strehoj tek Ti. E bëj gjithë këtë nga dashuria për Ty dhe në frikë nga fuqia Jote. Nuk ka mbrojtje e as strehim përveçse tek Ti. Besoj në Librin Tënd që e ke*

41 Hadithi kudsij është ai, që Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e ka transmetuar nga Allahu i Madhërishëm me fjalët e Allahut dhe me domethënie nga Ai. Pra, hadithi kudsij është ai, domethënia e së cilit është shpallje nga Allahu ndërsa fjalët janë të të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

*shpallur dhe në Profetin Tënd, të cilin e ke dërguar.” Pastaj, nëse vdisni para se të zgjoheni, do të vdisni në gjendjen e pacenuar, natyrore sikur kur keni ardhur në këtë botë. Pra le të jenë këto fjalë, fjalët e fundit që i shqiptoni.” Kështu, i përsërita këto fjalë para tij [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe kur arrita te pjesa që thotë: “Besoj në Librin Tënd që e ke shpallur,” thashë, “dhe në të Dërguarin Tënd” në vend të “Profetit Tënd”. Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më tha: “Jo!” Dhe shtoi: “Profetin Tënd, të cilin e ke dërguar.”<sup>42</sup>*

Prandaj, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u mësoi shokëve të tij lutje të caktuara në të njëjtën mënyrë siç u mësoi pasazhe nga Kur’ani, duke këmbëngulur që ato të mësohen tekstualisht, pa shtesa ose fshirje. Kjo ilustron në incidentin e mëposhtëm:

Sipas Ibn Abasit, i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua mësonte atyre një lutje të caktuar në të njëjtën mënyrë siç ua mësonte ndonjë sure nga Kur’ani. Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i mësoi: *Thuaj: O Zot, kërkojmë mbrojtjen Tënde (në një version tjetër: “Kërkoj mbrojtjen Tënde”) nga dënimi i Zjarrit. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga vuajtja e varrit. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga mashtrimet e Dexhallit (Antikrishtit) dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga tundimet dhe joshjet e jetës dhe të vdekjes.*<sup>43</sup>

Dhe:

I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] na e mësoi *teshehud*-in (*et-tehijatu lilah*), i cili përfshin përhëndetjet drejtuar Zotit dhe të tjerëve, në të njëjtën mënyrë siç na mëson të sure nga Kur’ani.<sup>44</sup>

42 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

43 Transmeton Muslimi.

44 Transmeton Ibn Maxhe nën autoritetin e Abdullah Ibn Abbasit. E saktësoi Albani. Një version i këtij hadithi u transmetua edhe nga Abdullah Ibn Omeri me shtesën: “Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk donte që as edhe një fjalë e vetme t’i shtohet a hiqet.”



## KAPITULLI 24

# Përlllogaritja e përfitimeve dhe humbjeve

Keni mbërthyer ndonjëherë, pas mbarimit të ndonjërit prej pesë namazeve të përditshme, lapsin dhe një copë letre, për ta regjistruar numrin e çasteve kur keni ndjerë se po flisni me Allahun, kur dukej se po zhvillohej komunikimi i vërtetë, kur zemra ju dridhej përbrenda, madje qoftë vetëm një herë ose për një sekondë të vetme apo pjesë të sekondës? Me fjalë të tjera, keni provuar ndonjëherë ta vlerësoni, madje qoftë vetëm në mënyrën më të përafërt, sa keni përfituar nga koha juaj në namaz?

Ammar ibn Jasiri [radijallahu anhu] transmeton se i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] njëherë kishte thënë:

*Disa njerëz dalin nga namazi me vetëm një të dhjetën, një të nëntën, një të tetën, një të shtatën, një të gjashtën, një të pestën, një të katërtën, një të tretën, ose një të dytën e asaj që është regjistruar në favor të tyre.<sup>45</sup>*

---

45 Transmetojnë Ebu Davudi dhe Nesa'iu nën autoritetin e Ammar Ibn Jasirit. E saktësoi Albani.

Mundohuni të mos e përfundoni as edhe një namaz të vetëm, pa e përjetuar një ndjenjë të vërtetë të komunikimit me Allahun, sado e shkurtër qoftë ajo. Nëse dështoni në rekatën e parë, provoni përsëri në të dytin, pastaj në të tretin, pastaj të katërtin e kështu me radhë. Nëse dështoni gjatë të detyrueshmeve (*farzeve*), provoni në rekatet e bazuar në Sunet. Nëse dështoni në namazin e sabahut, provoni gjatë namazit të drekës, namazit të ikindisë, namazit të akshamit dhe namazit të jacisë. Mos lejoni që madje qoftë një ditë të kalojë, pa qarë së paku gjatë njërit prej namazeve që falni, ose pa u dridhur qoftë edhe për një sekondë ose një pjesë të sekondës, ose pa e përjetuar gëzimin e kontaktimit me Zotin e Plotfuqishëm. Kjo është më e pakta që një besimtar mund të shpresojë ta përjetojë. Dhe, nëse arrini të përjetoni më shumë se kaq, gëzohuni me atë që keni shtuar në magazinën tuaj të thesarit qiellor.

Supermarketet shpesh shpallin lojë shpërblyese me çmime të vlefshme, si një alternativë për t'i inkurajuar konsumatorët që t'i blejnë produktet e tyre. E gjitha që konsumatorët duhet të bëjnë është ta plotësojnë një tiketë, përpara se të dalin nga marketi, me adresën e saktë dhe numrin e telefonit, në mënyrë që, në rast se fitojnë ndonjë çmim, të mund të kontaktohen. Kur i qaseni namazit, dini se jeni duke hyrë në një depo hyjnore në të cilën keni mundësinë të plotësoni numra të pallogaritshëm të “tiketa-ve”, secila prej të cilave ju kualifikon për një çmim të ndryshëm. Një nga dallimet e shumta midis çmimeve të dhëna nga institucionet tregtare dhe ato të dhëna nga depoja hyjnore është se kur bëhet fjalë për këtë të fundit, thjesht nuk jeni subjekt i një shansi për të fituar; në fakt, jeni të garantuar për të fituar jo vetëm një çmim, por të gjitha çmimet në dispozicion - në qoftë se, keni sukses në plotësimin e tiketave në mënyrën e duhur.

Kur faleni, në fakt zbarkoni në një ndërmarrje investimi që ju garanton më shumë përfitim se kushdo tjetër në fytyrën e tokës, madje me koston më të ulët të mundshme. Kjo sipërmarrje e vockël kërkon kapital. Kur e shpërndani zekatin, në fakt paguani të paktën

2.5 për qind të aseteve tuaja likuide. Për ta bërë pelegrinazhin, duhet të ndani mënjane një buxhet të konsiderueshëm, duke përfshirë koston e udhëtimit, strehimit dhe shpenzimeve tjera. Kur agjëroni muajin e Ramazanit, jeni të detyruar të abstenoni nga ushqimi, pija dhe kënaqësitë e shumta të tjera gjatë orëve të ditës dhe ta dhuroni bamirësinë-agjëruese (*sadakat el-fitrin*) në fund të muajit, në emër të çdo familjari. Sa i përket namazit, e gjitha që shpenzoni janë uji që konsumoni në marrjen e abdesit ritual dhe koha që ia kushtoni faljes së namazit. Kaq: asnjë tarifë, asnjë taksë! Dhe në këmbim, korrni përfitime të mëdha, të cilat depozitohen menjëherë në llogarinë tuaj shpirtërore. Në fakt, i korrni disa prej tyre drejtpërdrejt edhe para mbarimit të namazit. Këto përfitime të menjëhershme përfshijnë: paqen e mendjes, përmirësimin e shëndetit, qetësinë, qartësinë e mendimit dhe ndjenjën e rinovimit. Disa prej tyre, përkundrazi, paketohen dhe dërgohen në paketa elegante ose në adresën tuaj në këtë botë (siç janë: sukcesi, bekimi, mirëqenia, përgjigjja në lutje) ose në adresën tuaj në jetën e ardhshme (siç janë: shlyerja e mëkateve dhe pasurimi me vepra të panumërta të shtuara në llogarinë tuaj).

A nuk është një ndërmarrje e tillë jashtëzakonisht e rëndësishme për ta merituar përgatitjen e një libri-llogaritar përfitim-humbje? Humbjet për të cilat flas këtu nuk janë, sigurisht, lloji me të cilin normalisht mendojmë. Ato nuk përfshijnë zvogëlimin e kapitalit. Përkundrazi, përfshijnë një ulje në përfitimet, të cilat mund të keni qenë në gjendje t'i shtoni në kapitalin tuaj ekzistues. Sa i përket "kapitalit" që e posedoni tashmë, ai do të ngelet i paprekur nëse, Zoti mos e dhëntë, namazet tuaja bëhen në një frymë hipokrizie; duke syfaqësuar dhe mashtruar.

Duke pasur parasysh këtë kuptim të bazuar në investime të disiplinave shpirtërore, mbase mund të filloni ta bëni një vlerësim të përfitimeve që keni bërë në fund të çdo namazi, si dhe përfitimeve që keni humbur duke i lejuar preokupimet që t'ju shpërquendrojnë nga adhurimi.



## MARGARITARËT QË KENI MBLEDHUR PËRMES NAMAZIT

Mos harroni, ndërsa e shqyrtoni librin tuaj llogaritar të namazit, kthehuni te pesë “linjat” e përmbledhura në një diskutim të mëhershëm: linja e kohës, linja e gjuhës, linja e trupit, linja e zemrës dhe linja e veprimit. Mos harroni gjithashtu ta bëni rishikimin tuaj, bazuar në numrin e minutave që keni kaluar në namaz. Nëse i keni mbaruar dy rekate në vetëm dy ose tre minuta, atëherë dijeni se nuk jeni falur vërtet, prandaj duhet të ktheheni dhe të provoni edhe një herë tjetër, pasi mezi i keni kënduar fjalët e namazit, dhe për më tepër, nuk ia keni dhënë vetes mundësinë për t’i nxënë kuptimet e tyre, rrjedhimisht, për ta përkthyer këtë kuptim në përgjigje konkrete.

Çdo musliman duhet të krijojë një shkallë të thjeshtë, përmes së cilës do ta masë numrin e përafërt të “pikave” që ai ose ajo shënoi në çdo namaz të caktuar. Në fund të fundit, adhuresi individual është i vetmi person i aftë të dijë se si ishte namazi i tij/saj. Duhet ta mbani mend, sigurisht, se fruti aktual i mbartur nga një namaz i falur, asnjëherë nuk mund të njihet saktësisht nga askush, përveç Atij që i njeht të gjitha gjërat dhe Atij që i jemi drejtuar në namazin në fjalë.

Pas çdo namazi, parashtrojeni vetes pyetjet e mëposhtme:

1. Kur i ngrita duart dhe shpreha hapjen *Allahu Ekber*, a ndjeva sikur lashë gjithçka mbrapa dhe u futa në një botë tjetër të lartësuar mbi mbretërinë tokësore?
2. Sa herë shprehja ime “*Allahu Ekber - Allahu është më i madh...*” më rrëmbeu nga një gjendje shpërqendrimi dhe më rivendosi në botën e namazit, duke më ngritur në lartësitë e ekstazës, larg nga trivialitetet dhe shpërqendrimet e botës tokësore e në praninë e Atij që është “më i madh”?
3. Sa herë emri Hyjnor *Er-Rahman* më shpërlau me dritë nga lart, duke bërë të mundur që ta ndiej mëshirën dhe

mirësinë e freskët që derdhen mbi mua? Dhe sa herë emri hyjnor *Er-Rahim* më shpërlau me dritë nga lart, duke më zgjuar me mëshirën dhe dhembshurinë që shtrihen nga kohëra të lashta e deri në kohët e lashta, dhe ma pastroi trupin dhe shpirtin?

4. Sa shprehje kur'anore kam kënduar nga kaptina *Fatiha* (si: *el-hamdu lil-lahi, rabbi el-alemin, Maliki jevmi din, ija-ke na'budu*) në mënyrë të atillë sa ndjeva që madhështia e Allahut u shfaqë para meje, duke ndryshuar diçka brenda meje derisa po këndoja?
5. Sa herë, pas leximit të ajeteve nga *Fatiha* ose ndonjë sure tjetër, i kam lënë kohë të mjaftueshme vetes që t'i marrë ato, të reflektoj mbi to dhe të kuptoj rëndësinë e tyre?
6. E kam sjellë në mendje familjen time të ngushtë, të afërmit dhe miqtë, muslimanët dhe jo-muslimanët dhe armiqtë e mi muslimanë dhe jo-muslimanë, ndërsa u luta: "*Na udhëzo në rrugën e drejtë...*", duke i përqaftuar të gjithë ata në këtë lutje të hirshme? Dhe a e kam përjetuar ëmbëlsinë e shpërblimit për thirrjen e udhëzimeve dhe urtësisë hyjnore tek ta?
7. Sa herë gjatë rukuve dhe sexhdeve u përpoqa ta mbush "hapësirën virtuale" pas çdo thirrjeje *Allahu Ekber* dhe çdo *tesbihu*? Sa sekonda mora në dispozicion për ta mbushur këtë hapësirë?
8. Sa nga "butonat e kuq" vijues i kam shtypur gjatë namazit tim? Dhe sa herë kam ndjerë një rrymë shpirtërore që arrinte thellë brenda meje, duke më lëkundur në palcë dhe duke shkaktuar që zemra ime të dridhej apo të më zhvendoste në lot?
  - Pullën: "*Vetëm prej Teje (ne) ndihmë kërkojmë - Ija-keneste'in*": Sa sekonda ia kushtova kësaj fraze, ashtu që ta kujtoj veten mbi natyrën e kërkesës që po bëj dhe llojin e ndihmës që po kërkoj; që t'i sjell

në mendje imazhet e vetes sime dhe të gjithë njerëzve tjerë të përfshirë në përemrin vetor “ne”?

- Pullën: “Përshëndetjet i takojnë Allahut - *Et-tehijatu lilah*”: Sa kohë më mori kjo frazë në kontekstin e zgjatjes së duhur të tingujve zanorë dhe një pauze më pas, si dhe frazave që e pasojnë atë: “*Es-salavatu ve et-tajibate* – Si dhe lutjet dhe fjalët e mira?” A i dhashë kohë të mjaftueshme vetes sime për ta përjetuar gëzimin dhe mrekullinë e qasjes në praninë e Perëndisë, duke e përshëndetur Atë me fjalët që Ai Vetë m’i ka mësuar dhe duke u përshëndetur prej Tij në këmbim?
- Pullën: “Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ty, o Lajmëtar - *Es-selamu alejke ejuhe nebiju ve rahmetu Allahi ve bereketuhu*”: Sa kohë më mori ta shprehja këtë përshëndetje, veçanërisht zanoret e zgjatura në fjalët “*es-selamu*” (paqja), “*Allahu*” (Zoti) dhe “*bereketuhu*” (bekimet)? Duke i pasur parasysch periudhat kohore të ofruara nga këto prolongime dhe hapësirat e hapura të përkohshme pas përshëndetjes, a e kam përjetuar eksitimin e dyfishtë të thirrjes së bekimeve dhe paqes mbi Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe marrjen e përgjigjes së tij?
- Pulla: “Paqja qoftë mbi të gjithë ne dhe robërit e mirë të Allahut - *Es-selamu alejna ve ala ibadilahi salihin*”: Ndërsa thirra paqen mbi veten time, ata për të cilët unë kujdesem dhe brezat e vazhdueshëm të robërve të drejtë të Allahut, kudo që ndodhen ata, në çfarëdo moshe që kanë jetuar, a ndjeva një pui të butë të paqes së shenjtë e të pacenuar që derdhej mbi mua dhe mbi ta, duke më pastruar mua dhe ata nga çdo gjë që mund të na dëmtonte? A e ndieja veten duke u mbuluar me mirësi derisa pranoja shpërblimin bujar për çdo përshëndetje

që kisha ofruar? A u ndjeva i lehtësuar nga çdo lloj dhimbje koke, sëmundje, lodhje, barre apo ankthi?

9. A isha në gjendje, në namazet vullnetare të bazuara në Sunet, ta kompensoja atë që nuk arrita në ciklet e namazeve të detyrueshme? Ose anasjelltas?
10. Dhe së fundmi, a kam pasur sukses në këtë stërvitje të re të durimit dhe këmbënguljes? A e ndjeva energjinë e re shpirtërore që po emitohej nëpërmjet meje? A e ndjeva se disa ndryshime, sado të vogla, kishin ndodhur në mua në nivelin e mirëqenies fizike dhe mendore, forcës morale, këmbënguljes dhe mençurisë?

## MARGARITARËT QË KENI HUMBUR PËRMES NAMAZIT

Pas namazit, parashtrojani vetes pyetjet e mëposhtme:

1. Sa shprehje të: “*Allahu Ekber* - Allahu është më i madh,” kaluan pa më ndihmuar në përqendrimin e asaj që po thosha?
2. Sa vargje të Kur’anit i kam kënduar pa qenë i vëmendshëm ndaj kuptimeve të tyre?
3. Në sa nga shprehjet e glorifikimit: “*Subhane rabbije el-adhim; Subhane rabbije el-a’la*” gjatë rukuve dhe sexhdeve, thjesht kam papagalluar, pa e shijuar ëmbëlsinë e tyre ose pasurinë e kuptimit të tyre dhe pa i përdorur mirë hapësirat e hapura pas tyre?
4. Sa herë i kam lejuar vetes t’i rregulloj rrobat dhe flokët derisa bie në sexhde? Sa herë i kam lëvizur duart apo ndonjë pjesë tjetër të trupit pa nevojë fare?
5. Sa herë jam shpërqendruar në namaz nga dizajnet, format apo ngjyrat në sexhaden e namazit, apo diku gjetiu në rrethin tim të afërt?

6. Sa herë kam munguar në namaz për shkak të këtij apo atij shqetësimi mbi këtë botë?
7. Sa herë u shpërqendrova nga adhurimi prej një bisede anësore afër meje, prej tingujve të një televizori ose radioje, prej një zileje telefonike, një zile dere apo një trokitjeje në të?
8. Cilën nga pesë “linjat” e namazit nuk e bëra siç duhet në namazin tim: kohën, gjuhën, trupin, zemrën dhe më vonë veprimin?
9. A ndjej se namazi më dha forcë të shtuar për t’i rezistuar angazhimit në veprime që nuk do të ishin në përputhje me fjalët që ia adresova Allahut në namaz?
10. A ndjej se e kam kaluar “kursin” e namazit në vendosmëri, këmbëngulje dhe durim? Apo dola nga namazi, jo më ndryshe se që hyra në të?

\*\*\*

Së fundmi, kur ta vendosni kokën në jastëk gjatë natës dhe t’i keni kënduar lutjet tradicionale të transmetuara nën autoritetin e Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], përpikuni ta bëni një rishikim të shpejtë të të gjitha “pikave të namazit”, të cilat i keni regjistruar për veten gjatë rrjedhës së ditës, sidomos ato që lidhen me “pullat e kuqe”. Pastaj krahasoni këto me tërësore që e keni arritur ditën e kaluar, ashtu që ta kuptoni nëse keni bërë ndonjë përparim në rezultatin tuaj të përditshëm. Nëse keni regresuar, punoni në korrigjimin e vetes të nesërmen, në mënyrë që tendenca e përgjithshme të jetë më lart, e jo në rënie. Në fund të çdo jave, jepni një vlerësim përfundimtar për tërë javën dhe krahasoni këtë vlerësim me atë që keni marrë javën e kaluar. Kështu, mund të siguroheni që investimet tuaja të sjellin dividendë në rritje të qëndrueshme.



## KAPITULLI 25

### Le të jetë e gjithë jeta juaj namaz

Sipas tregimit mbi Profetin Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në *Lejlet el-Miraxh*, Natën kur u mor në Mbretërinë Qiellore dhe mori udhëzime nga lart për ta ligjësuar namazin mbi komunitetin musliman, urdhri fillestar qe falja e pesëdhjetë namazeve ditore. Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] iu lut Zotit të tij për ulje të numrit të namazeve, derisa ulja vajti në vetëm pesë. Dhe vrisja mendjen, siç mund ta keni bërë dhe ju: Do ishim në gjendje t'i falnim pesëdhjetë namaze në ditë? A do të kishim kohë për të bërë ndonjë gjë tjetër? Do të gjenim vallë kohë për të ngrënë, për të pirë, për të fjetur gjumë, për të lexuar dhe për të shkruar, për të biseduar me njëri-tjetrin, për të punuar, për të shkruar në vizita dhe shumë gjëra tjera?

Më vonë, megjithatë, kur arrita ta kuptoja natyrën e namazit dhe ndikimin që ai ka tek praktikuesit e saj, mund të shihja se namazi është jetë dhe se jeta, në të gjitha detajet dhe hollësitë e saj, përbëhet nga lloje të ndryshme namazeve:

- Kur zgjoheni nga gjumi dhe shprehimisht tregoni mirënjohje për kthim në jetë pas “vdekjes” së përkohshme në gjumë, jeni në namaz.

- Kur vështroni fytyrat e fëmijëve dhe mrekulloheni se si ata rriten dhe zhvillohen, si fizikisht ashtu edhe mentalisht, me aftësi të reja, fjalë të reja dhe mënyra të reja të shprehurit çdo ditë, jeni në namaz.
- Kur i mësoni fëmijët që të tregojnë mirësi dhe i ftoni në besim në Zot *“me urtësi dhe këshillë të mirë”* (En-Nahl: 125), edhe nëse e pasojnë këshillën tuaj ose jo, në fakt jeni në namaz.
- Kur e falni vëllain, motrën, kolegun ose fqinjin për zemërsisht për ndonjë padrejtësi që ua ka bërë, dhe nëse tutje i kërkoni ndjesë atij ose asaj edhe pse ju ishit pala e ofenduar dhe dëmtuar, jeni në namaz.
- Kur dikush ju mallkon ose ofendon, ndërsa ju nuk ja ktheni, duke e llogaritur këtë si sprovë që duhet përballuar me shpresë për shpërblim te Allahu, jeni në namaz.
- Kur largoheni nga një tubim - në të cilin njerëzit janë të angazhuar në përgojim - sepse e gjeni veten të paaftë për ta ndryshuar rrjedhën e bisedës ose për ta mbrojtur personin që është shpifur, jeni në namaz.
- Kur i luteni Zotit për udhëzim të një jomuslimani në rrugën e drejtë, jeni në namaz.
- Kur tregoni mëshirë, dashuri, mirësi, butësi për një jo-musliman duke e trajtuar atë në një mënyrë të civilizuar, të mirësjellshme dhe kordiale, jeni në namaz.
- Kur i respekton ligjet në vendin ku jetoni, edhe nëse ai nuk është vend musliman, duke demonstruar një qëndrim mirënjohës dhe duke i përmbushur detyrimet financiare, sociale dhe morale ndaj tij, jeni në namaz.
- Kur jeni të rrethuar nga çoroditja prej të gjitha anëve dhe e denonconi atë në zemrat tuaja, edhe pse nuk gjeni dot asnjë rrugëdalje për ta ndryshuar atë qoftë nëpërmjet fjalëve ose veprimeve tuaja, jeni në namaz.

- Kur bëni çmos për ta kënaqur familjen dhe të tjerët rreth jush, pavarësisht nëse përpjekjet tuaja janë të suksesshme ose jo, jeni në namaz.
- Kur besoni për zemërsisht se Allahu ua donë të mirën dhe rrjedhimisht mendoni mirë për Të, pavarësisht ç'dyshime dhe ç'cytje ngjallin demonët tuaj të brendshëm, ju në të vërtetë jeni në namaz.
- Kur e falënderoni Allahun si për begati ashtu edhe për fatkeqësi, jeni në namaz.
- Kur e ulni shikimin nga joshjet tokësore që ju rrethojnë, jeni në namaz.
- Kur vendosmërisht e duroni sëmundjen, skamjen, tragjedinë, ose rrethanat e tjera të vështira jetësore, jeni në namaz.
- Kur e shpëtoni një jetë ose ndihmoni të shpëtohet një jetë, jeni në namaz.
- Kur e ndani brengën, shqetësimin, hallin, vuajtjen dhe pikëllimin me muslimanët dhe jomuslimanët në një vend të huaj, qoftë edhe nëse thjesht duke ngritur zërin në protestim ose duke bërë lutje për ta, jeni në namaz.
- Kur e vizitoni dikë që është i sëmurë, jeni në namaz. Pas së gjithash, a nuk na udhëzoi Profeti jonë i dashur, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] që të marrim abdes para se ta vizitojmë të sëmurin.
- Kur shkoni në shtrat dhe e pushoni trupin nga stresi i një dite të gjatë e të mundimshme, në përgatitje për një ditë të re të aktivitetit të frytshëm e konstruktiv, jeni në namaz. Para së gjithash, a nuk na mësoi Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] që të marrim abdes para se të flemë gjumë, sikur gjumi të ishte një lloj namazi në vete?
- Dhe së fundmi, kur bëni një përlllogaritje personale të ditës suaj para gjumit, duke vënë në dukje gjërat që i



keni mirëvepruar dhe rrugët përmes të cilave keni dështuar, jeni në namaz.

Në pak fjalë, kur e shikoni botën përmes syrit të një adhuruesi, e shihni se jeta juaj tërësore është një namaz. Pra, mos e humbisni asnjë mundësi të jetës për të adhuruar, mundësi që paraqiten në çdo hap e çdo vend. Veçoritë e pafundme të jetës janë “fjalë” që tregojnë madhështinë e Krijuesit: madhërimin e Fuqisë së Tij, lavdërimi e glorifikimin e dhuntive dhe mirësive të Tij, njohjen e begatave të Tij dhe rikujtimin robërve të Tij që t’i drejtohen vazhdimisht Atij dhe të mos e harrojnë asnjëherë faktin se gjithmonë dhe çdo herë, duhet të jenë të angazhuar në ndonjë formë të adhurimit.

Nëse dikush ju fyen, mos u zemëroni, mos u hidhëroni. Përkundrazi, le të jetë ajo një mundësi për lavdërim dhe adhurim. Thoni vetes tuaj: “Edhe ai edhe unë jemi krijesa të Perëndisë. Ç’pikurë shkëlqyese është ajo, të cilës mund t’i jepet një personalitet i tillë i dallueshëm, një pamje dhe një temperament në mesin miliarda shpirtave në Tokë!”

Le të jetë gjithçka që hasni, çdo gjë që dëgjoni, çdo gjë që shihni rreth jush, shans për ta falënderuar Allahun. Kush jam unë që të them diçka të shëmtuar kur gjithçka dhe gjithkush është nga krijimet e Zotit? Edhe rrufeja që verbon shikimin, edhe bubullima që më bën të dridhem nga frika dhe terrori, po edhe tmerrri që mund t’i frymëzojë kataklizmat e natyrës, ngrenë brenda meje një thirrje lavdërimi që më sjellin më pranë Allahut.

O jeni o s’jeni në lëvizje, ulur ose në këmbë, duke ngrënë ose pirë, duke fituar ose shpenzuar, duke dëgjuar ose duke folur - shkurtimisht, në çfarëdo situatë në të cilën ndodheni - jini pjesë e këtij Universi të gjerë, i cili është vazhdimisht, pa pushim i përfshirë në përkujtim, lavdërim, glorifikim, falënderim dhe adhurim. Për sa kohë që jeni gjallë, jeni në namaz. Pra, le të jenë këto rregulla të arta udhërrëfyese juaj në jetë:

- Mos ndërmerrni asnjë hap jashtë për ta “rregulluar” botën rreth jush, pa e ndërmarrë fillimisht një hap brenda vetes tuaj për ta “rregulluar” marrëdhënien tuaj me botën që vjen.
- Mos e çoni asnjë orë nga koha e çmuar, pa i thirr mendjes se keni më pak se kjo orë kohë për të jetuar.
- Mos i pastroni anëtarët truporë përmes abdesit, pa u munduar që ta pastroni veten së brendshmi.
- Mos shqiptoni asnjë fjalë në namaz, pa e mbledh mendjen që t’i lini veprat ta dëshmojnë të vërtetën e tyre.
- Mos e përkulni kokën me nderim në namaz, pa e përkulur vullnetin tuaj përulesisht në jetën e përditshme.
- Mos dilni nga xhamia duke qenë të njëjtët sikur kur brenda saj u futët fillimisht.
- Mos ja jepni lamtumirën Ramazanit, pa ia dhënë lamtumirën disa formave të mosbindjes dhe pa ia dhënë mirëseardhjen disa formave të reja të bindjes.
- Mos e kryeni një vepër të mirë me dorën e djathtë pa i mënjanuar disa ligësi me të majtën.
- Mos e thorni një kafshë sakrifikimi (*kurban*) në shpresë për afri me Xhenetin, pa e “ther” një vepër të mosbindjes, e cila mund t’ju shpjerë më pranë Xhehenemit.
- Mos shpenzoni asnjë qindarkë pa nevojë, pa i kujtuar ata që kanë ndërruar jetë në kërkim të mundësisë për t’ia mbathur nga të ftohtit, sëmundja ose uria.
- Mos e tejmbushni gotën me ujë, nëse e dini se do e konsumoni vetëm gjysmën e saj.
- Mos e çoni dëm asnjë pikë uji, pa i kujtuar ata që vdesin në baza ditore si pasojë e etjes.
- Mos e futni asnjë kafshatë ushqimi në gojë, pa i kujtuar ata që kanë ikur nga kjo botë si pasojë e mungesës së ushqimit.

- Mos e shpërdorni ushqimin, derisa harroni se Zoti mund t'ju ketë privuar nga çdo gjë në sofër.
- Mos i shijoni frutat e kësaj bote, pa dëshiruar t'i gëzoni frutat e të Përtejmes.
- Mos u gëzoni shumë me atë që e keni fituar, pastaj ta shpenzoni në vendet ku nuk duhet.
- Në vend se të irritoheni për mungesë atletesh të brendeve të njohura, qani për ata që s'kanë këmbë ku do t'i mbathnin ato.
- Mos murmuritni kur një orendi u thyhet në dhomë, pa i kujtuar ata që s'kanë shtëpi fare.
- Mos hidhni kripë në ushqimin tuaj, pa hedhur sheqer në fjalët e juaja.
- Mos thoni gjë negative për askënd, pa e ngulitur në mendje se dikush mund t'ua thotë të njëjtat juve.
- Mos ju adresoni asnjërit nga prindërit me mosrespekt, duke e ditur se do të dëgjoni fjalë të njëjta të mosrespektit nga fëmijët e juaj nesër.
- Mos e përçmoni askënd, duke e ditur se Allahu ka shumë më shumë arsye juve për t'ju përçmuar, se që ju keni për t'i përçmuar krijesat.
- Mos i kërkoni Zotit të ju falë për ofendim ndaj Tij, nëse fillimisht nuk i keni falur ata që ju kanë ofenduar.
- Mos lejoni as sa një pikël urrejtje t'ua vjedh zemrat, pa lejuar një pjesë të madhe të dashurisë të hyjë brenda tyre.
- Para se të luteni për ata që i doni, lutuni për ata që nuk jeni të sigurt se i doni, ose dashuria e të cilëve për ju mbase nuk është e sigurt.
- Mos u tmerroni nga sprovat që thërrasin për durim këmbëngulës, por jini të sigurt për shpërblimin që të pret dhe lehtësimin që sigurisht do të vijë në kohën e duhur.

Dhe së fundmi, mos harroni të veproni sipas urdhrit të Profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: që ta adhuron Allahun sikur ta keni parë Atë dhe ta llogarisni veten midis të vdekurve. Kujtoni Allahun në çdo gur dhe në çdo pemë; në rast se keni kryer një vepër të keqe, pasojeni me një të mirë: për një shkelje të fshehtë, një vepër të fshehtë të mirë dhe për një shkelje publike, një vepër të mirë publike.



## Përfundim

Me çdo frymëmarrje, mbani mend se e tërë jeta është një namaz. Në të gjitha rrethanat dhe kudo që shkoni, jini të pastër në shpirt ashtu siç jeni në trup pas përgatitjes për namaz. Jini sa më mirë-njohës ndaj Zotit, ashtu siç është çdo qelizë në trupin tuaj, çdo muskul i përbashkët dhe çdo pore, ndonëse pa vetëdijen tuaj.

Dijeni se mënyra se si e menaxhoni namazin, pasqyron dhe do të pasqyrohet në mënyrën se si e menaxhoni jetën. Shtylla e parë e Islamit, dëshmia e besimit (*shehadeti*), është një mjet për të siguruar mirëqenie në jetën e ardhshme, ndërsa namazi, shtylla e tij e dytë, është një mjet për të siguruar mirëqenie në jetën e ardhshme dhe në jetën e kësaj bote. Ky libër ka për qëllim t'ju ofrojë një sërë çelësash me të cilët mund t'i hapni magazinat e mendjes dhe zemrës, të fluturoni nëpër botën e imagjinatës tuaj me Perëndinë dhe të lundroni në detet e zbulimit.

O Zot, kërkoj faljen Tënde për çfarëdo mëkati për të cilin jam penduar, vetëm sa t'i kthehem sërish atij. Kërkoj faljen Tënde për kohën që ta kam kushtuar, mbase me pa dashje, vetëm për ta harxhuar atë. Kërkoj faljen Tënde për përdorimin e forcës me të cilën më ke begatuar, vetë sa për të kryer veprime të mosbindjes. Kërkoj faljen Tënde për lejjimin e gjërave të mira përmes të cilave të kërkoja të më largosh nga çdo gjë që më shpjerë larg Teje.

*Pse i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e identifikoi namazin si faktor determinues e dallues mes besimtarit dhe jobesimtarit? Pse ishte namazi një veçori për të cilën Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përkujtoi komunitetin e tij madje edhe në shtratin e vdekjes, duke thënë: “Për Zotin, mos e braktisni namazin!”?*

*Vallë, qe detyruar namazi në jetën e muslimanëve si dënim apo si shpërblim? Cilat aspekte të tij janë të vështira dhe cilat janë të këndshme, nëse ne, në fakt, gjejmë kënaqësi në të? Pse urdhërohe mi të falim namaz në kohë të veçanta, me lëvizje të veçanta dhe me numër të veçantë rekatesh e përlujesh? Pse duhet të shprehim fjalë të veçanta dhe të bëjmë këndime të veçanta? Pse namazi gjendet në të gjitha fetë?*

*Me çdo frymëmarrje, mbani mend se e tërë jeta është një namaz. Në të gjitha rrethanat dhe kudo që shkoni, jini të pastër në shpirt ashtu siç jeni në trup pas përgatitjes për namaz. Jini sa më mirënjohës ndaj Zotit, ashtu siç është çdo qelizë në trupin tuaj, çdo muskul i përbashkët dhe çdo pore, ndonëse pa vetëdijen tuaj.*

*Ky libër ka për qëllim t’ju ofrojë një sërë çelësash me të cilët mund t’i hapni magazinat e mendjes dhe zemrës, të fluturoni nëpër botën e imagjinatës tuaj me Perëndinë dhe të lundroni në detet e zbulimit.*



ISBN 978-608-216-179-2

